Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti

# TEORITË KRIMINOLOGJIKE NË RRUGËN E ZHVILLIMIT HISTORIK

MONOGRAFI

**Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti**

# Teoritë kriminologjike në rrugën e zhvillimit historik

**MONOGRAFI**

Tiranë, 2024

© Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose botohet, me kusht që të njihet autorësia e tij. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin tregtar apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të autorit.

Autor: Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti
Recensues: Prof. Dr. Altin Shegani
Prof. Dr. Segio Seminara

Drejtuese e Projektit: Alba Jorganxhi

ISBN: 9789928395290

Ky botim u mundësua nga:

OSCE
Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
**Prezenca në Shqipëri**

Ky projekt mbështetet financiarisht nga:

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, apo të Byrosë së Qeverisë së SHBA-së për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

# PARATHËNIE

Ky botim është mbështetur nga projekti “Për krijimin e programit ‘Master në Kriminologji’” (2018-2024), i cili zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, me mbështetjen financiare të Byrosë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri falënderon autorin për punën e tij dhe shpreh përkushtimin e saj të vijueshëm për promovimin e hulumtimit shkencor dhe debatit akademik në fushën e kriminologjisë.

## PËRMBAJTJA


Abstrakt ……………………………………………………………………… faqe 5
Hyrje ……………………………………………………………………… 7
Metodologjia ……………………………………………………………… 11
Vlerësim i përmbajtjes së punimit shkencor Prof. Altin Shegani ............. 12
Vlerësim i përmbajtjes së punimit shkencor Prof. Sergio Seminara ......... 16


### KREU I

TEORITË KRIMINOLOGJIKE DHE KLASIFIKIMI I TYRE


1. Kriminologjia teorike dhe roli i kriminologut në shpjegimin e kriminalitetit » 19
2. Kontributi i Cesare Beccaria në zhvillimin e mendimit kriminologjik.. » 23
3. Klasifikimi i teorive të shpjegimit të kriminalitetit ……………….…...... » 26


### KREU II

TEORITË BIOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT


1. Teoria e kriminelit të lindur ..............................………..……….... » 30
2. Teoria e Enrico Ferrit dhe parimet e shkollës positive ……………….. » 33
3. Trashëgimia dhe kriminaliteti ....................…………………………… » 36
4. Raca dhe kriminaliteti .........................………………………………… » 39


### KREU III

TEORITË PSIKOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT


1. Kriminologjia klinike dhe personaliteti kriminal …………………… » 41
2. Analiza kriminologjike e sjelljes kriminale …………………………. » 51
3. Kriminel për shkak të ndjenjës së fajit ............................................. » 57
4. Shpjegimi i veprimtarisë kriminale të vrasësit serial ……………….. » 59
5. Teoria e inferioritetit …………………………………………………… » 64

**KREU IV**

SHPJEGIMI I SJELLJES KRIMINALE BAZUAR NË ÇRREGULLIMET MENDORE


1. Shëndeti mendor dhe çrregullimet mendore...………………………… » 66
2. Studime mbi çrregullimet mendore dhe sjelljen kriminale …………... » 70
3. Klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor ………… » 76
4. Institucionet për personat me çrregullime të shëndetit mendor ………. » 79
5. Trajtimi i personave të burgosur me probleme të shëndetit mendor …. » 82
6. Përdorimi i substancave narkotike dhe çrregullimet mendore ……….. » 85


**KREU V**

TEORITË SOCIOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT


1. Klasifikimi i teorive me bazë sociologjike …..………… » 88
2. Teoria e ç'organizimit social…………………………………. » 90
3. Teoria e zonave kriminale …………….…. » 92
4. Teoria e anomisë ………………………………………………… » 95
5. Teoria e neutralizimit …...…………………………………………….. » 98
6. Teoria e etiketimit ………………………………………………….. » 99


**KREU VI**

TEORIA EKONOMIKE E SJELLJES KRIMINALE


1. Shpjegimi i sjelljes kriminale në bazë të teorisë ekonomike.………… » 102
2. Aktivitetet e jashtëligjshme dhe ndikimi i tyre në ekonomi.. » 108
3. Efektet ekonomike të aktiviteteve të jashtëligjshme kriminale …… » 110
4. Motivet që e vështirësojnë luftën kundër kriminalitetit …..………… » 114


**KREU VII**

TEORITË NË LIDHJE ME DËNIMIN DHE NDIKIMI I TYRE NE NIVELIN E KRIMINALITETIT


1. Domosdoshmëria e ekzistencës së dënimit penal ................................ » 117
2. Teoria e "riparimit" të dëmit ............................................................ » 120
3. Dënimi dhe teoria e parandalimit të përgjithshëm ............................ » 122
4. Teoria e parandalimit të posaçëm ....................................................... » 125
5. Riedukimi dhe recidivizmi ................................................................. » 127

**Bibliografia** ……...……………………………………… » 130

# ABSTRAKT

Përse njerëzit janë të prirur për të thyer rregullat e sjelljes në shoqëri? Një pyetje e tillë e lidhur me kryerjen e sjelljeve të jashtëligjshme e ka shoqëruar njeriun që në themelimin e shoqërisë si një strukturë e bashkuar dhe e organizuar. Ky problem është shtruar shumë më herët, por u bë një pyetje e zakonshme vetëm në shekullin e XVIII, mbi të gjitha falë filozofëve, juristëve dhe shtetarëve të rëndësishëm. Pyetjet për fenomenin e deviancës dhe të kriminalitetit, për shkaqet dhe zhvillimin e tyre, për ligjet penale kanë qenë gjithmonë një temë me interes për shkencëtarët.

Ky punim do të fokusohet në përshkrimin historik të teorive kriminologjike dhe ka për qëllim ta ekspozojë lexuesin ndaj hulumtimeve dhe diskutimeve, të zhvilluara në periudha të ndryshme, të teorive të shpjegimit të kriminalitetit dhe deviancës. Nëpërmjet këtij punimi ne synojmë të ndihmojmë lexuesin të njihet me teoritë që e shpjegojnë kriminalitetin nga këndvështrime të ndryshme disiplinore. Një tjetër objektiv është krijimi përpara lexuesit i një panorame multidisiplinore për vlerësimin kritik të zhvillimit të kriminalitetit.

Për realizimin e këtij qëllimi, do të trajtojmë disa nga teoritë e shpjegimit të kriminalitetit si: teoritë që theksojnë faktorët individualë në shpjegimin e kriminalitetit nëpërmjet teorive biologjike dhe psikologjike, teoritë ekonomike të zgjedhjes racionale; teoritë sociologjike që theksojnë rëndësinë e faktorëve të grupit në shpjegimin e krimit duke përfshirë teoritë e ç’organizimit social, përkatësinë kulturore dhe nënkulturore, etiketimin, demografinë dhe anominë; teoritë mbi dënimin dhe rolin e dënimit në parandalimin e kriminalitetit. Analiza e teorive të ndryshme i lejon lexuesve jo vetëm që të nxjerrin në pah veçoritë e çdo mendimi kriminologjik dhe interpretimin e ndryshëm që secila prej tyre i jep sjelljes së jashtëligjshme por, gjithashtu, u mundëson atyre edhe të kuptojnë përdorimin e metodave të ndryshme të kërkimit të theksuara nga autorët. Diskutimi në lidhje me teoritë kriminologjike do të bëhet duke filluar nga zhvillimi i teorive bio-

antropologjike dhe duke përfunduar me shqyrtimin e qasjes së sjelljes kriminale përmes teorive psikologjike dhe sociologjike.

Një pjesë e këtij punimi, gjithashtu, do i kushtohet edhe rolit që kanë teoritë në hartimin e politikave penale në fushën e parandalimit të kriminalitetit duke u ndalur pak më tepër tek dënimi dhe teoritë mbi dënimin. Me anë të këtij punimi synohet që lexuesi të njohë konceptet themelore të kriminologjisë duke iu referuar teorive kryesore.

# Hyrje

Sipas mendimit tonë, kriminologjia është shkenca që studion kriminalitetin, personalitetin e kriminelit dhe sjelljen kriminale. Ndërsa sipas një përkufizimi më të zgjeruar, kriminologjia mund të përkufizohet si shkenca që studion veprat penale (veprat penale të përcaktuara në kodin penal), autorët e tyre dhe viktimat përkatëse, si dhe format e kontrollit dhe parandalimit të kriminalitetit. Në mënyrë të veçantë kriminologët studiojnë natyrën dhe përhapjen e krimit, llojet e ndryshme të kriminalitetit, mundohen të gjejnë dhe të shpjegojnë shkaqet e krimit dhe të sjelljeve antishoqërore. Kriminologjia studion edhe reagimin social ndaj krimit duke propozuar edhe masa parandaluese të kriminalitetit. Në ditët e sotme kriminologjia ka natyrën e një shkence autonome të lidhur ngushtë me një grup shkencash të tjera si: sociologjia, psikologjia, psikiatria, biologjia, penologjia, kriminalistika, e drejta penale, politika penale apo filozofia, historia dhe e drejta administrative[1].

Shpjegimet për sjelljen kriminale janë po aq të vjetra sa vetë llojet e sjelljes. Debati dhe diskutimi rreth asaj se përse njerëzit thyejnë rregullat kanë nxitur interes të përgjithshëm dhe kanë promovuar studime të rëndësishme përgjatë historisë. Sipas mendimit tonë, shumica e studiuesve kanë pikëpamjet e tyre se cilat janë shkaqet më të mundshme të një sjelljeje të tillë dhe të gjitha këto pikëpamje ka të ngjarë të përmbajnë disa elemente të "të vërtetës" por pa qenë shpjegime të plota për të gjitha llojet e kriminalitetit.

Një periudhë interesante në zhvillimin e kërkimit të shkaqeve të sjelljeve antishoqërore është periudha mesjetare, periudhë në të cilën konceptimi i origjinës së "të keqes" mbështetej mbi themelet e shpjegimeve dhe shkrimeve fetare për të cilat "e keqja" personifikohej me djallin. Kjo mënyrë e të arsyetuarit ka treguar rrugën e zhvillimit të kërkimeve mbi gjenezën e sjelljeve deviante dhe të krimit për disa qindra vjet[2].

---

[1] S. Kurti, *Kriminologji dhe penologji: cikël leksionesh,* Kolegji Universitar "Wisdom", Tiranë, 2022, fq. 11.

[2] Pavarësisht faktit se mendimi në lidhje me shkaqet e kryerjes së sjelljes kriminale ka evoluar dhe nuk mbështetet më në faktin se burimi i të keqes është djalli, në ditët e sotme ka autorë të ndryshëm të cilët e vënë theksin në studimet e tyre pikërisht tek ekzistenca e djallit dhe ndikimi që ai ka në jetën e përditshme. Në lidhje

Në shekullin e XVIII, që njihet si shekulli i reformave, vihet re një distancim nga ideja mesjetare e individit si "një qenie e korruptuar nga mëkati" dhe që ka aftësi të kufizuara njohëse. Mendja njerëzore është në gjendje të depërtojë në sekretet e natyrës, ta njohi atë dhe të përfitojë prej saj. Shpjegimet teologjike i lënë vendin pohimit të studiuesve laikë, të cilët nuk janë të prirur të ndalojnë dëshirën për kërkime përballë dogmave të besimit[3]. Institucionet dhe vendet e kulturës fillojnë të pasqyrojnë këtë ndryshim dhe Evropa e manastireve zëvendësohet nga ajo e akademive, qarqeve intelektuale, kabineteve shkencore dhe revistave[4]. Vetëm në epokën e rilindjes dhe më pas në atë të iluminizmit u bënë përpjekje për të përshkruar shkaqet e kriminalitetit duke mbajtur parasysh faktorët mjedisorë dhe biologjikë. Sipas autorëve të kohës, këta elementë kishin një vlerë të madhe njohëse pasi ndikuan në mënyrë të ndjeshme mënyrën e të menduarit për autorët e veprave penale dhe kriminalitetin që për pasojë solli edhe ndryshimin e zhvillimit të së drejtës penale në shekujt në vijim. Në epokën e iluminizmit, zhvillimi i mendimit kriminologjik, që në thelb ndikoi në mënyrën e kuptimit të së drejtës penale, të zbatimit të dënimit dhe braktisjen e modeleve të përbashkëta në kërkimin e shkaqeve të kriminalitetit, është arritur për shkak të mendimeve filozofike të shekullit të

---

me këtë argument shih, S. Siviero, *Un'analisi socio – criminologica del satanismo tra percezione sociale e realtà*, në Revistën "Rivista di Criminologia, Vittimologia e Sicurezza", Volume XII, N.2, Bologna, 2018.

[3] Shih, F. Di Chiara, *Ombre tra i Lumi? Il complesso rapporto tra ecclesiastici e giuristi nell'Illuminismo siciliano*, në Revistën "Historia et ius" - Rivista di storia giuridica dell'età medievale e moderna, 23/2023 - paper 24. Për të kuptuar më mirë iluminizmin, mund të jetë e dobishme të analizohet aspekti specifik i lidhjes së tij me kishën, meqënëse kjo e fundit dhe njohuritë teologjike morën pjesë në formimin e parimeve politike, sociale, juridike dhe ekonomike që përshkuan epokën e iluminizmit. Kisha dhe iluminizmi, janë përshkruar nga historiografia tradicionale si dy entitete të papajtueshme. E para, në fakt, ka përfaqësuar gjithmonë një forcë konservatore që synon mbrojtjen e mendimit tradicional; Iluminizmi, nga ana tjetër, e vendosi idenë e progresit në qendër të mendimit racional, për arritjen e të cilit shpresonte në rinovimin kulturor dhe reforma rrënjësore që do të modifikonin shoqërinë, ligjin dhe ekonominë. Në pjesën më të madhe të Evropës, këto ide gjetën shprehje konkrete në veprimet e disa sovranëve, të cilët, në përpjekje për të modernizuar shtetet e tyre, zbatuan politika sekularizimi që çuan në konflikt të drejtpërdrejtë me kishën.

[4] Shih, F. Simon, *Illuminismo giuridico e idee economiche nelle opere di Cesare Beccaria e di Gaetano Filangieri*, në Jesús Astigarraga Goenaga e Javier Usoz Otal, *L'Économie politique et la sphère publique dans le débat des lumières*, Casa de Velázquez, Madrid, 2013, fq. 141-163.

XVIII[5]. Autorë dhe studiues të ndryshëm si Monteschie, Beccarria dhe më vonë Lombroso, Ferri dhe Garofolo patën një ndikim të veçantë në zhvillimin e mendimit kriminologjik në këtë periudhë. Kështu, për shembull, sipas Monteschie, *sistemi i ndëshkimeve i bazuar në mizorinë e tejskajshme shkaktoi, në vend të frikës, egërsimin e tepërt të shoqërisë*. Një qëndrim të ngjashëm ka mbajtur edhe Beccaria, duke fajësuar sistemin e ndëshkimeve fizike tepër mizore, duke theksuar nevojën për të luftuar kundër shkaqeve të kriminalitetit dhe jo kundër rezultateve të tij, nëpërmjet formulimit të dispozitave ligjore të qarta dhe të pranueshme, që në të njëjtën kohë prezantojnë dhe shprehin një paralajmërim të fortë në lidhje me shkeljen e tyre.

Sipas doktrinës, epoka e iluminizmit paraqet një nga fazat më të çmuara historike në zhvillimin e reflektimit mbi fenomenin e sjelljes kriminale[6]. Në epokën e iluminizmit u krijuan themelet e mendimit modern mbi të cilin u krijuan rregullat bazë për zhvillimin e së drejtës penale. Për këtë arsye, iluminizmi paraqet epokën e ndritur në të cilën filloi formimi i "shkollave" dhe "rrymave" të ndryshme që përfaqësojnë fillimin e reflektimeve për shkaqet e kriminalitetit. Megjithatë, ne mendojmë se llojet e pyetjeve në lidhje me shkaqet e një fenomeni specifik mund të lindin vetëm pasi të vëzhgohen pasojat e tij. Problemi dhe çështjet që fenomeni i kriminalitetit nënkupton janë shumë të gjera dhe nuk është e mundur të formulohen përgjigje unike, pasi përgjigje të tilla duhet të marrin në konsideratë të gjitha qëndrimet, të gjitha aspektet që lidhen me sjelljen kriminale: pyetjet që mund të shtrohen në këtë rast kanë të bëjnë jo vetëm me aspekte sociologjike, psikologjike apo kulturore, por mbi të gjitha penale dhe juridike, kriminologjike, viktimologjike dhe aktualisht, falë arritjeve të njohurive moderne mbi trupin e njeriut, edhe ato mjekësore dhe biologjiko-kimike.

[5] Projekti i reformës penale i menduar për tu zbatuar në pragun e shekullit të XIX përmban domosdoshmërinë e përmirësimit të masave të lidhura me mënyrën e ndëshkimit. Vizioni i reformatorëve, i paraqitur në mënyrë të qartë jo vetëm nga teoricienët e pastër si Beccaria por edhe nga ligjvënësit, mbështetet tek ndëshkimi i bazuar mbi elemente objektivë duke nxitur reflektimin mbi natyrën e krimit dhe autorit të veprës penale. Njësia matëse që duhet të përdoret për të ndëshkuar është ajo që teoricienët e së drejtës penale por edhe vetë gjyqtarët e quajnë interesi ose shkaku i krimit. Shih, R. Alibrandi, *La questione criminale nell'Illuminismo giuridico. Il grande sogno della giustizia*, në Revistën "Heliopolis": culture, civiltà, politica (Rivista di filosofia e simbolica politica), Anno XIII, Numero 2, 2015.

[6] Perspektiva iluministe i hapi rrugën mendimit se krimineli është një subjekt normal, i cili, ashtu sikurse të tjerët, zgjedh veprimet e tij mbi bazën e një llogaritjeje kostosh dhe përfitimesh. Shih, P. Massaro, *Dall'homo sociologicus all'homo oeconomicus? Teorie razionali, libero arbitrio e politiche criminali*, Dipartimento Jonico in Sistemi Giuridici ed Economici del Mediterraneo: Società, Ambiente, Culture, Università degli studi di Bari "Aldo Moro", Annali 2016, Anno IV, fq. 257.

Për sa u tha më sipër, vlen të theksohet se reflektimet në lidhje me sjelljen kriminale, të bazuara mbi parimet e shkencave penale (kriminologjisë) dhe shkencave shoqërore (sociologjisë, psikologjisë apo filozofisë) kanë një traditë relativisht të re. Duke nisur nga fillimi i shekullit të XVIII, reflektimet e këtij lloji do të ishin pjesë përbërëse e shkencës së të drejtës penale; megjithatë edhe sot situata paraqitet në mënyrë të ngjashme. Kështu mund të themi se në ditët e sotme, e drejta penale trajton problemin e kërkimit të origjinës së të keqes, apo e thënë ndryshe analizon ngjarjen kriminale me qëllim që të bëjë cilësimin e saktë juridiko penal të veprës penale dhe ti japi autorit të veprës penale një dënim të drejtë dhe të merituar me synimin për të kufizuar dhe parandaluar totalisht procesin e zhvillimit të aktivitetit kriminal. Pavarësisht këtij fakti, e drejta penale moderne nuk mund të konceptohet pa kërkimet shkencore të cilat ndërmerren, për shembull, në nivelin e kriminologjisë, sociologjisë apo psikologjisë dhe shkencave të tjera shoqërore.

Në këtë punim, nëpërmjet analizës së zhvillimit historik, ne do të mundohemi ti japim përgjigje një sërë pyetjesh: A duhet ti shohim shkaqet e sjelljes kriminale te vetë “kriminelët”, pra e thënë ndryshe, shkaqet e sjelljes kriminale varen nga karakteristikat e tyre ekskluzive individuale dhe nuk janë rezultat i pasaktësisë së normave që rregullojnë mirëfunksionimin e jetës shoqërore? Apo duhet ti shikojmë shkaqet e sjelljes kriminale si pasojë e një zhvillimi shoqëror jo të rregullt duke reflektuar problemet e shumta që ekzistojnë në shoqëri? Ndërsa një pyetje tjetër që lind vetvetiu është e lidhur me faktin nëse mund të konsiderohen normat penale si hapi i parë në kuadër të parandalimit të sjelljes kriminale? A konsistojnë shkaqet e sjelljeve kriminale në ndërtimin e gabuar, papërshtatshmërinë dhe pasaktësinë e tyre, të cilat e vështirësojnë dhe e bëjnë jo të lehtë bashkëjetesën shoqërore?

Përgjigjen e këtyre pyetjeve do të mundohemi ta japim duke analizuar teoritë e ndryshme të shpjegimit të kriminalitetit. Pa dyshim, deri më sot, gjeneza e teorive kriminologjike të shpjegimit të kriminalitetit e gjen zanafillën në konceptimet e shekujve XVIII dhe XIX, të cilat fokusohen në dy burime themelore: i pari ka të bëjë me konceptimin bio-psikik dhe i dyti është konceptimi sociologjik. Megjithatë, te një pjesë e madhe e kriminologëve që merren me shpjegimin e fenomenit të

sjelljes kriminale, mbizotëron mendimi se njeriu si qenie shoqërore përbën një përzierje të elementeve socialë, biologjikë dhe psikologjikë.

## Metodologjia

Ky punim do të mbështetet mbi metodën hulumtuese, përshkruese, interpretuese dhe krahasimore. Në fazën e parë të këtij punimi synohet të përdoret metoda hulumtuese dhe përzgjedhja e literaturës. Kjo metodë përfshin procesin e gjatë të mbledhjes së materialeve, në format të shkruar dhe elektronik. Ky kërkim do të përfshijë identifikimin, mbledhjen dhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me Teoritë kriminologjike. Zgjedhja e literaturës duhet të përfshijë një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh të huaj dhe vendas. Hulumtimi si proces do të shoqërojë gjithashtu fazën e sistemimit dhe renditjes së zërave bibliografikë, në funksion të realizimit të këtij punimi.

Realizimi i këtij punimi do të përfshijë më tej metodën përshkruese e cila është një mjet i domosdoshëm për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme, aspekteve ligjore dhe atyre praktike, duke realizuar njohjen me pjesën teorike dhe përqasjen me realitetin. Po ashtu, një rol të rëndësishëm në shkrimin e këtij punimi do të ketë edhe metoda interpretuese e cila shpie drejt origjinalitetit që duhet të paraqesë punimi, çka konsiston në interpretimin, mendimet dhe sugjerimet e autorit, i cili ka marrë përsipër të evidentojë, përshkruajë dhe analizojë këto teori. Krahasimi ndërmjet teorive të ndryshme të shpjegimit të kriminalitetit do të jetë pjesë e rëndësishme e këtij punimi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I DREJTESISE

Rruga "Milto TUTULANI ", Tirana , ALBANIATel/Fax. + 355 4 222 537, http: //www.fd-ut.edu.al

# Vlerësim i përmbajtjes së punimit shkencor Prof. Altin Shegani

## Reçencë për punimin me titull: "Teoritë kriminologjike në rrugën e zhvillimit historik, paraqitur nga Prof. Asoc. dr. Skerdian Kurti

Vlerat morale, juridike dhe shoqërore të kriminologjisë janë tashmë të evidentuara botërisht. Dëshira dhe interesi shkencor gjer në përkushtim ndaj dijes kriminologjike ka orientuar kërkimin e autorit Skerdian Kurti drejt një udhëtimi sfidues ndaj dinamikave të zhvillimit të koncepteve bashkëkohore të kriminologjisë. Trajtesat juridike me pistë refleksioni kriminologjinë, në përgjithësi, ofrohen të vlefshme në rrafshin doktrinal të shkencave juridike-penale. Nga ana tjetër, punimi në fjalë dëshmon qartë për koherencën e sensit të autorit në identifikimin e trajtesave "kurajoze" shkencore e profesionale shumë të vlefshme për rrethet juridike në përgjithësi dhe për auditorin universitar në veçanti. Punimi me temë "Teoritë kriminologjike në rrugën e zhvillimit historik", i paraqitur nga Prof. Asoc. dr. Skerdian Kurti synon të trajtojë një tematikë të komplikuar dhe në përgjithësi jo të njohur si duhet në vendin tonë. Këto teori shfaqen jo rrallëherë të komplikuara nga pikëpamja e thelbit të tyre. Angazhimi në auditorët universitarë ka bërë që materiali të ofrohet në trajtën e një reflektimi serioz në funksion të interesit të shkencës së kriminologjisë për të dëshmuar në mënyrë dinamike, konceptet, karakteristikat, rolin dhe funksionet e teorive kriminologjike. Punimi hedh dritë mbi të kaluarën me synimin për të evidentuar rëndësinë por dhe diskutimet e pranishme mbi lindjen e shkencës së kriminologjisë dhe rolin e saj në studimin e shkaqeve të kriminalitetit nga këndvështrime të ndryshme teorike. Nëpërmjet evidentimit dhe analizës së

shkaqeve të kriminalitetit sugjerohet integrimi në sistemin e metodave të përshtatshme për të studiuar dhe luftuar kriminalitetin edhe në kontekstin shqiptar. Trajtimi kriminologjiko-historik i shkaqeve të kriminalitetit, studimi i lidhjes mes tyre dhe i gjithë këndvështrimi që i është dhënë punimit, përbëjnë një vlerë të shtuar në lëmin e studimeve në këtë fushë në Shqipëri. Produkti i argumentit dëshmon shkallën e impenjimit profesional dhe këmbënguljen në kohë për ta sjellë sa më të plotë trajtën e punimit. Punimi karakterizohet nga një bllokskemë dinamike e cila përshkallëzon aspekte të problematikave të ndryshme në teoritë kriminologjike si edhe nga një organizim racional i përmbajtjes së materialit. Autori është orientuar me kompetencë të thellë profesionale në përzgjedhjen dhe në adresimin e literaturës korente juridike. Punimi është rezultat i drejtëpërdrejtë i produkteve të përfituara nga përdorimi i një metodologjie juridike ndërdisiplinare, ku kombinohen metodat cilësore dhe sasiore në funksion të një përgjigjeje sa më të plotë ndaj trajtimit të natyrës së ndërlikuar që mbart shpjegimi i shkaqeve të kriminalitetit. Gjatë shqyrtimit të shkaqeve të kriminalitetit sipas teorive kriminologjike objekt trajtese, në aspektin e zhvillimit të tyre historik ka gjetur zbatim, në mënyrë të veçantë metoda historiko – juridike e ajo analitike.

Në kreun e parë trajtohet koncepti i kriminologjisë teorike dhe produkti i saj në shpjegimin e shkaqeve të fenomenologjisë kriminale. Në funksion të themeleve të kriminologjisë, autori, mbështetur në pluralizmin e opinioneve, mundëson një klasifikim të teorive të cilat synojnë të shpjegojnë bazat fenomenologjike kriminale. Autori ndalet tek origjina e disiplinës kriminologjike që është në Itali duke integruar edhe opinionin se pikënisja e saj gjendet në Shkollën Klasike, te përfaqësuar më së miri nga Cesare Beccaria ne vepren e tij “Krimet dhe denimet” ku janë përmbledhur teoritë mbi krimin dhe dënimin si edhe ne në Shkollën Pozitive të gjysmës së dytë të shekullit të XIX-të, përfaqësuar nga eksponentë si: Lombroso, Ferri dhe Garofalo.

Në kreun e dytë, bëhet një paraqitje e platformës kryesore të teorive me bazë biologjike duke u fokusuar më së shumti tek teoria e “kriminelit të lindur” të Lombrozos dhe parimeve të shkollës pozitive, përfaqësuesi më i rëndësishëm i të cilës është Enrico Ferri, i cili e vë theksin tek roli i mbrojtjes sociale në parandalimin

e kriminalitetit. Sipas tij, aktiviteti kriminal përcaktohet nga një sërë faktorësh kriminogjenë, si: faktorët antropologjikë; faktorët e mjedisit social; faktorët e mjedisit fizik. Kjo teori, hodhi bazat e teorisë së parandalimit social të kriminalitetit.

Në kreun e tretë, trajtohen teoritë kriminologjike me bazë psikologjike të cilat perqendrohen tek personaliteti dhe roli i autorit të veprës penale në kryerjen e veprës penale. Me interes shfaqet ketu edhe analiza kriminologjike e sjelljes kriminale dhe analiza e shkaqeve të kryerjes së krimeve seriale.

Kreu i katërt synon të nxjerrë në pah lidhjen midis çrregullimeve mendore dhe kriminalitetit duke evidentuar faktin se shumica e studimeve të bëra nxjerrin si përfundim se probabiliteti më i madh për të kryer krime dhe sidomos krime të dhunshme shfaqet tek personat me çrregullime të rënda mendore dhe më pak kjo dukuri vihet re tek pjesa e popullsisë pa probleme të shëndetit mendor.

Kreu i pestë trajton zhvillimin historik të teorive sociologjike të shpjegimit të kriminalitetit dhe vlerëson kontributin e rëndësishëm të sociologjisë që ndihmoi në një zhvillimin të ri të studimit të fenomenit kriminal. Sipas këtyre teorive, objekt i analizave nuk është më krimineli dhe sjellja e tij por shoqëria dhe niveli i kriminalitetit edhe pse me kalimin e kohës, u vu re një gërshetim i analizave kriminologjike, duke prekur të dyja drejtimet njëkohësisht. Ne thelbin e ketyre teorive, sjellja kriminale nuk është gjë tjetër veçse një sjellje sociale, duke shmangur mendimin se sjellja kriminale është rezultat i shumës mes nivelit bio-psikologjik me nivelin social – mjedisor.

Kreu i gjashtë, i kushtohet teorisë ekonomike të sjelljes kriminale, e cila vendos në qëndër të shkaqeve të kriminalitetit analizën e kostove dhe përfitimeve që ka njeriu racional nga kryerja e veprimeve kriminale. Kjo teori paraqet interes të madh në hartimin e politikave penale në luftën dhe parandalimin e kriminalitetit pavarësisht ekzistencës së disa motiveve që e vështirësojnë së tepërmi këtë luftë. Një aspekt i rëndësishëm dhe që duhet të theksohet lidhet me analizën ekonomike që i bëhet aktivitetit kriminal dhe ndikimit që ky aktivitet ka në ekonominë e një vendi të caktuar.

Kreu i fundit i kushtohet tërësisht teorive mbi dënimin dhe rolit që ato luajnë në ndërtimin e dispozitave penale efikase në kuadër të shfaqjes në mënyrën më të mirë të mundshme të funksioneve të dënimit. Rëndësi i kushtohet riedukimit dhe risocializimit si një nga mënyrat më të mira të mundshme për të frenuar nivelin e recidivizmit.

Karakteristikë kryesore e këtij punimi, është se në të gjithë kapitujt e tij, autori përqendrohet në një trajtim të qartë ndaj situatave që analizon duke i dhënë mundësinë lexuesit të ndërtojë një vizion të qartë lidhur me shkaqet e mundshme të kriminalitetit dhe duke e ftuar të reflektojë me qëllim pasurimin e teorive ekzistuese. Vëllimi dhe cilësia e trajtesës dëshmojnë për një vëmendje e përpjekje shkencore e profesionale domethënëse. Punimi është konceptuar dhe i është prezantuar lexuesit me një stil të qartë lakonik me një argument të rrjedhshëm e funksional çka bën që të lexohet pa vështirësi. Punimi dëshmon qartë angazhim e reflektim serioz e të thelluar në burime bibliografike vendase dhe të huaja. Botimi me siguri do të përbëjë një burim të vlefshëm dhe cilësor shtesë në bibliografinë në gjuhën shqipe për të gjithë juristët që investohen në fushën e shkencave kriminale por edhe tek specialistët e shkencave sociale që aplikojnë dijet e tyre në institucione që lidhen në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me standartet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Sipas mendimit tim, fakti që nga ana e autorit është investuar në fushën e botimeve kriminologjike me nivel të lartë e kulturë profesionale është shumë i rëndësishëm për të zhvilluar teorinë dhe mbajtur gjallë traditën. Për të gjithë faktorët e evidentuar më sipër, personalisht i konsideroj të plota vlerat profesionale të punimit dhe shpreh bindjen se do të jetë një “stacion” i dobishëm reflektimi e reference si edhe një kontribut më shumë në universin e dijes kriminologjike.


Prof. dr. Altin Shegani

Profesor i së Drejtës Penale

Departamenti i të Drejtës Penale

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

UNIVERSITÀ DI PAVIA
Dipartimento di Giurisprudenza

# Vlerësim i përmbajtjes së punimit shkencor Prof. Sergio Seminara

## Recensione a Skerdian Kurti

## Teorie criminologiche nel corso dello sviluppo storico

Il tentativo di racchiudere tutte le più significative teorie criminologiche all'interno di una monografia, tracciando così la storia del pensiero criminologico e descrivendo i vari orientamenti sulle cause della delinquenza, non è certo impresa facile. All'opera in commento va riconosciuto il duplice merito di avere coltivato un obiettivo così ambizioso e di essersi inserita in un percorso metodologicamente corretto che, seppure percorso da tensioni, tende verso una lettura unitaria della criminologia.

Il libro di Skerdian Kurti espone infatti i contenuti della scienza criminologica nella sua evoluzione e nei suoi incessanti sforzi di spiegare l'eziologia delle condotte devianti, così da offrire una solida base cognitiva al diritto penale.

L'assunto di partenza, posto a base della ricerca, si lega all'autonomia scientifica della criminologia, non come branca del diritto penale, ma come scienza assestante, dotata di contenuti propri. Invero, appare oggi innegabile che la criminologia è una disciplina nella quale vengono coordinate e sistemate le conoscenze su quel particolare aspetto della realtà che è il delitto e sul suo autore; a questo fine si rende necessario valorizzare il contenuto di una "costellazione" di altre discipline, quali la sociologia, la psicologia, la psichiatria, l'antropologia, la biologia, la giurisprudenza ed il diritto penale e altre ancora.

Si comprende così che la monografia del prof. Kurti si focalizza sulla nascita della criminologia e, in particolare, sulle teorie che si sono succedute nell'individuare le condizioni determinanti il comportamento criminale ed i fattori psicosociali che

contribuiscono alla sua esistenza. Ciò che rende affascinante l’indagine è il suo intreccio con la storia del diritto penale: dalle istanze illuministiche di Montesquieu alle tesi formulate da Beccaria e Bentham sui delitti e soprattutto sulla pena, dalle prime codificazioni dell’800 alla contrapposizione della fine del secolo tra le concezioni classiche e quelle moderne, che in Italia presero il nome di Scuola Classica e Scuola Positiva.

Si trattò di uno scontro teorico di importanza fondamentale, perché gettò le basi della successiva evoluzione scientifica. In particolare, la contrapposizione verteva sul problema del libero arbitrio, riconosciuto dalla Scuola classica (che annoverava fra i suoi esponenti Carrara, Pessina, Carmignani, Rossi) che lo assumeva dunque come fondamento della responsabilità morale e conferiva alla sanzione una funzione retributiva. Al contrario, la Scuola positiva (che annoverava fra i suoi promotori Lombroso, Ferri, Garofalo) sosteneva che la condotta delittuosa è sempre il prodotto di cause antropologiche, fisiche e sociali, rivendicando un metodo basato sull’osservazione scientifica dei fatti, sulla comparazione e sulla sperimentazione nello studio del comportamento dell’uomo e della società; di conseguenza, si assegnava alla pena lo scopo della difesa sociale.

Il capitolo II ha appunto ad oggetto le teorie biologiche della criminalità, che segnarono l’avvio di nuovi metodi di ricerca sui fattori bio-antropologici nella spiegazione del crimine. Il capitolo III è invece dedicato alle interpretazioni del crimine in chiave psicologica, che hanno enfatizzato l’importanza e il ruolo dell’autore nella criminogenesi e nella criminodinamica. In questo contesto risulta di particolare interesse anche il pensiero di Freud e la nozione di “delinquente per senso di colpa”.

Il capitolo IV si sposta sull’analisi delle teorie fondate sul collegamento tra salute mentale e la criminalità. La malattia mentale è spesso associata a caratteristiche psicopatologiche quali disregolazione o discontrollo di impulsività, rabbia, ostilità o aggressività, e a disordini comportamentali che talvolta possono assumere i connotati di comportamenti violenti più o meno gravi.

Con il capitolo V si apre l’orizzonte più attuale della criminologia, rappresentato dal versante sociologico, che studia l’influenza dei fattori culturali e sociali in generale sul comportamento della persona e, in particolare, sulla sua reazione deviante e anche

delinquenziale. Sono esaminate le teorie che si sono avvicendate soprattutto in America, quali quella della disorganizzazione sociale della Scuola di Chicago, della teoria dell'anomia di Emil Durkheim e Robert Merton e della teoria dell'etichettamento (o della reazione sociale) sostenuta da Edwin Lemert e Howard Becker.

Nel capitolo VI viene spiegata la teoria economica del comportamento criminale, elaborata dall'economista Gary Backer, che punta l'attenzione sull'uomo razionale. Nello stesso capitolo, analizzando le conseguenze economiche delle attività criminali, l'Autore si sofferma sull'ipotesi di una connessione tra crimine organizzato e crimine economico.

Il capitolo VII è dedicato alle teorie della pena e all'impatto della sanzione penale sulla criminalità. Qui l'antico si mescola con il nuovo, dimostrando come le tematiche affrontate nella presente monografia abbiano sempre accompagnato il pensiero umano. In particolare, vengono passate in rassegna le teorie elaborate dalla dottrina, comunemente suddivise in assolute e relative: le prime considerano la sanzione penale come espressione di una necessità intrinseca di giustizia, in termini di retribuzione del male commesso nel rispetto di valori assoluti e trascendenti; le seconde ravvisano nella pena uno strumento per conseguire obiettivi di utilità sociale, consistenti nella prevenzione della commissione di ulteriori reati.

Procedendo a una valutazione complessiva, il testo, corredato di un'ampia bibliografia, appare di valido ausilio tanto per coloro che per la prima volta si avvicinano alla materia, tanto per coloro che intendono approfondirla. In ogni caso, si tratta di un apprezzabile supporto di studio anche per gli studenti universitari che affrontano la criminologia come materia d'esame.

Skerdian Kurti rivela una piena maturità scientifica non solo nell'approfondimento della materia, ma soprattutto nella chiarezza e nel rigore del percorso espositivo.

Prof. dr. Sergio Seminara
Ordinario di Diritto penale
Dipartimento di Giurisprudenza
Università degli Studi di Pavia

# KREU I

## TEORITË KRIMINOLOGJIKE DHE KLASIFIKIMI I TYRE

**PËRMBAJTJA**: 1. Kriminologjia teorike dhe roli i kriminologut në shpjegimin e kriminalitetit. – 2. Kontributi i Cesare Beccaria në zhvillimin e mendimit kriminologjik. – 3. Klasifikimi i teorive të shpjegimit të kriminalitetit.

## 1. Kriminologjia teorike dhe roli i kriminologut në shpjegimin e kriminalitetit

Në ditët e sotme, për kriminologët në mënyrë të veçantë, është shumë e rëndësishme të kuptohet arsyeja se përse njerëzit janë të prirur për të thyer rregullat e sjelljes në shoqëri dhe për më tepër që në disa raste, thyerja e këtyre rregullave transformohet në një sjellje kriminale të ndëshkueshme nga ligji penal. Sipas doktrinës, shkenca e kriminologjisë ka për qëllim të promovojë disa të mira të përbashkëta ndër të cilat më të rëndësishmet janë rritja e nivelit të sigurisë, reduktimi i kriminalitetit dhe mbrojtja e lirive individuale[7]. Shkenca e kriminologjisë, e cila lindi si shkencë duke filluar nga shekulli i XIX, kur për herë të parë u trajtua në mënyrë shkencore (empirike dhe sistematike) studimi i ngjarjeve kriminale, mbart një orientim të trefishtë të përfitimit të njohurive kriminologjike: orientimi i parë ka të bëjë me shpjegimin e dukurisë kriminale, e lidhur kryesisht me mbledhjen e njohurive për të shpjeguar sjelljet kriminale dhe motivet që i shoqërojnë këto sjellje; orientimi i dytë ka të bëjë me dimensionin kritiko-institucional që nënkupton përfshirjen e kriminologut në rolin e specialistit që ndjek dhe mbështet një politikë që synon përmirësimin e parandalimit të krimit; orientimi i fundit ka të

[7] A. Balloni, *Il sapere criminologico tra rischi ed oportunità*, në Revistën "Rivista di Criminologia, Vittimologia e Sicurezza", Volume XVI, numero unico, Bologna, 2022, fq. 4-6.

bëjë me dimensionin normativ që kërkon një reflektim mbi kuptimin e drejtësisë dhe rolit të ligjit[8].

Rregullat e sjelljes orientojnë mënyrën se si duhet të sillen njerëzit në një shoqëri të caktuar. Para shekullit të XVIII, ishte e vështirë të bëje një dallim ndërmjet sjelljeve kriminale dhe sjelljeve morale dhe çdo vepër penale që kryhej, në të shumtën e rasteve, mbarte në vetvete edhe një shkelje të normave morale. Në të kaluarën më të largët të dy konceptet (krim dhe sjellje antimorale) përputheshin dhe, meqenëse morali etik përkonte me moralin fetar, krimi identifikohej me mëkatin[9].

Qysh prej lindjes së saj, është vënë re një degëzim i dyfishtë i shkencës së kriminologjisë: nga njëra anë lidhja e saj e ngushtë me legjislacionin penal dhe gjithçka që ka të bëjë me njohjen e përgjegjësisë së subjektit që kryen sjellje që përbëjnë vepër penale, nga ana tjetër përpjekjet e bëra për kërkimin e shkaqeve të natyrës patologjike që përcaktojnë sjelljen kriminale. Është kjo perspektivë e fundit që në fillimet e zhvillimit të kësaj shkence morri përsipër dhe e çoi shkencën e kriminologjisë të rritet në vazhdën dhe "sugjerimet" e bio-antropologjisë, mjekësisë ligjore dhe psikiatrisë[10].

Përkufizimet që mund të gjejmë për shkencën e kriminologjisë janë të shumta por sipas mendimit tonë, kriminologjia është shkenca që studion kriminalitetin, personalitetin e kriminelit dhe sjelljen kriminale; ndërsa sipas një përkufizimi më të zgjeruar, kriminologjia mund të përkufizohet si shkenca që studion veprat penale

[8] Në lidhje me këtë argument shih, S. Kurti, *Kriminologji dhe penologji,* Kolegji Universitar "Wisdom", Tiranë, 2022, fq. 37. Sipas këtij mendimi, studimi i ngjarjeve kriminale mbart një qëllim të trefishtë: së pari, ka për qëllim të shpjegojë dukurinë kriminale dhe nëpërmjet këtij orientimi kriminologu kërkon ti përgjigjet pyetjes se përse njerëzit kryejnë sjellje të jashtëligjshme (vepra penale dhe sjellje devijante); së dyti, shkenca e kriminologjisë kërkon të shpjegojë faktin se përse duhet të ndëshkojmë të gjithë ata që kryejnë sjellje të jashtëligjshme; së treti, nëpërmjet studimeve kriminologjike, kriminologu mundohet të gjejë përgjigjen e pyetjes se si duhet të ndëshkojmë në rast të kryerjes së sjelljeve të jashtëligjshme.

[9] Kjo është edhe arsyeja që shpjegimet e para të kriminalitetit ishin me përmbajtje filozofike dhe fetare. Për më shumë shih, V. Hysi, *Kriminologjia,* Kristalina-KH, Tiranë, 2010 fq. 82-86.

[10] Degëzimi i dyfishtë kishte për bazë shkollën klasike dhe shkollën pozitive. Sipas shkollës klasike, ndëshkimi i autorit të veprës penale, *malum pasionis quod inflingitur ob malum actionis*, justifikohej si ndëshkim për të keqen e bërë. Sipas shkollës pozitive, koncepte të tilla si "sjellje e fajshme", "përgjegjësi morale" dhe "ndëshkueshmëri" zëvendësohen me konceptin e "rrezikshmërisë shoqërore" që nënkupton mundësinë që individi të përfshihet në kriminalitet. Për pasojë, ndëshkimi vjen si rezultat i kësaj rrezikshmërie dhe nuk mund të kuptohet më si ndëshkim. Shih, S. Giliberti, *Il Sistema del "doppio binario"*, në AA.VV., *Scuola Positiva e sistema penale: quale eredità,* a cura di Paolo Pitaro, Edizioni Università di Trieste, 2012, fq. 12.

(veprat penale të përcaktuara në kodin penal), autorët e tyre dhe viktimat përkatëse, si dhe format e kontrollit dhe parandalimit të kriminalitetit.

Kriminologjia teorike është dega e kriminologjisë që merret me studimin e shkaqeve të kriminalitetit. Të shumta janë teoritë[11] që merren me shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit duke nisur nga teoritë që e vënë theksin tek studimi i kriminelit dhe sjelljes së tij dhe duke përfunduar tek teoritë që marrin në analizë shoqërinë dhe kriminalitetin.

Kriminologjia është një shkencë dhe për të folur për ekzistencën e një shkence duhet që të ekzistojnë disa karakteristika: sistematiciteti ose e thënë ndryshe tërësia e njohurive të marra në mjedise të caktuara të dijes të integruara në një kompleks të strukturuar dhe harmonik; kontrollueshmëria; aftësia teorike; kapaciteti kumulativ ose ndërtimi i teorive të derivuara nga njëra-tjetra; aftësia parashikuese.

Shkencëtari që merret me studimin e kriminologjisë është kriminologu. Kriminologët japin kontributin e tyre në studimin e kriminalitetit nëpërmjet zhvillimit të kërkimeve shkencore nëpërmjet të cilave janë në gjendje të shpjegojnë përhapjen dhe karakteristikat e kriminalitetit[12]. Kriminologu merret me analizën, interpretimin dhe organizimin e informacioneve të nevojshme me qëllim që të ketë një vizion të qartë të fenomenit. Përshkrimi dhe analiza objektive e elementeve sasiore dhe cilësore të sjelljes kriminale apo devijante përbën kushtin e nevojshëm për çfarëdolloj analize shpjeguese të krimit. Kriminologët mundohen të shpjegojnë se cilat janë shkaqet e kriminalitetit edhe pse kjo është detyrë e vështirë për t’u përmbushur. Kriminologu luan një rol të dyfishtë: rolin e teoricienit dhe atë të kërkuesit. Në lidhje me rolin e parë zhvillon teori dhe kërkon të gjejë shkaqet e sjelljes kriminale. Jo pak e rëndësishme është edhe lidhja midis teorisë dhe kërkimit shkencor pasi të gjitha teoritë kanë nevojë të konfirmohen nëpërmjet instrumentave të kërkimit shkencor. Studimet teorike dhe kërkimet empirike japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e politikës sociale dhe kriminale. Ato ndihmojnë në

[11] Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, teoritë janë përgjithësime të përvojës që lindin nga praktika dhe që pasqyrohen dhe vërtetohen në praktikë. Ato janë dije të fituara nga jeta që zbulojnë shkaqet e sendeve dhe të dukurive, si dhe lidhjet dhe marrëdhëniet ligjësore ndërmjet tyre; janë sisteme pikëpamjesh ose mendim i caktuar për diçka.

[12] A. Baiguera Altieri, *I fondamenti concettuali della Criminologia*, në Revistën “Filodiritto”, Bologna, 2023.

krijimin e programeve të trajtimit për autorët e veprave penale por edhe të viktimave të shkaktuara nga veprat penale. Ashtu sikurse e kemi përmendur më sipër, kriminologjia është një shkencë dhe për këtë arsye, para së gjithash, duhet të paraqesi të dhëna objektive dhe për këtë arsye, kriminologu nuk duhet të udhëhiqet nga ndjesitë e tij të brendshme. Ajo çfarë ka rëndësi gjatë kërkimit shkencor është paraqitja reale e fakteve dhe të dhënave me saktësi të madhe në të gjitha fazat nëpër të cilat kalon kërkimi shkencor.

Në ditët e sotme, kjo edhe për fat të keq, kriminaliteti është shtuar ndjeshëm aq sa mund të duket se të kryesh krim është shndërruar në modë (vjedhja, mashtrimi, shpërndarja e lëndëve narkotike, vrasja, krijimi dhe pjesëmarrja në organizatë kriminale, korrupsioni). Për pasojë të gjithë janë të interesuar të dinë për kriminalitetin, shkaqet e tij dhe mënyrat për ta parandaluar apo edhe për ta kuruar. Në mënyrë të veçantë, mund të përmendim këtu gazetarët të cilët janë shumë të interesuar të zhvillojnë emisione mbi kriminalitetin duke u bazuar tek intervistat dhe thëniet e ekspertëve të fushës dhe kryesisht të kriminologëve[13]. Edhe në këto raste është shumë e rëndësishme që kriminologu, pavarësisht rastit të mirë për të patur publicitet mbi aftësitë e tij profesionale, të flasë për atë që ka njohuri. Mund të duket e natyrshme dhe e qartë që kriminologu të flasë për këto dukuri, por nuk është edhe aq e qartë nëse marrim parasysh gjerësinë e njohurive kriminologjike që duhet të zotërojë një kriminolog. Është e vështirë të jesh vërtet ekspert në çdo gjë: korrupsion dhe antropologji, karrierë kriminale dhe vrasje foshnjore, ndërmjetësim dhe satanizëm. Sipas mendimit tonë, nëse tema për të cilën pyet gazetari nuk përfshihet në njohuritë e kriminologut që intervistohet është më mirë që ta adresojë drejt një

[13] Shih, I. Merzagora Betsos, *I criminology e il quarto potere*, në Revistën “Rasegna Italiana di Criminologia”, Volume III, N.3, 2009. Sipas kësaj autore, kriminologët në raport me median ndahen në katër kategori: Në kategorinë e parë renditen ata që quhen “kriminologë të pastër”, ose e thënë ndryshe ata që nuk do të donin asnjë marrëdhënie me median, të cilët ndoshta duhet t'i përkufizojmë si “budallenj të pastër” duke patur parasysh rëndësinë dhe domosdoshmërinë që ka aktualisht komunikimi masiv; Në kategorinë e dytë renditen “pajtuesit” të cilët janë ata kriminologë që besojnë se është e mundur të bëhen disa paraqitje televisive apo pak intervista, duke mos e ekzagjeruar shumë dhe duke zgjedhur tema dhe programe me shumë interes. Një pozicionim i tillë mund të duket i ekuilibruar nëse nuk do të konsiderohej se zgjedhja e temës më me interes do të ishte një gjendje e brendshme subjektive; Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë “të paskrupullit” të cilët janë ata që nuk turpërohen kurrë, që i mbajnë celularët ndezur edhe gjatë orëve të leksioneve, për të cilët kriteri i zgjedhjes është audienca e një programi, që dinë të diskutojnë çdo temë, nga pastrimi i parave e deri tek përdhunuesit serial; Kategoria e fundit përfshin “të ashtuquajturit kriminologë” të cilët janë ata që e përkufizojnë veten si kriminologë por nuk është e qartë se mbi bazën e çfarë studimeve dhe çfarë përgatitjeve e mbrojnë këtë fakt.

kolegu më kompetent sesa të improvizojë diçka me anë të të cilës mund të ndikojë negativisht tek njerëzit që e dëgjojnë: kjo është një mundësi që “të famshmit” nuk duhet ta humbin pasi në rast të kundërt do të humbisnin një mundësi të mirë për të qëndruar në heshtje dhe këtë gjë kriminologët ja kanë borxh edhe publikut.

Roli i kriminologjisë në përgjithësi dhe ai i kriminologut në mënyrë të veçantë kanë një rëndësi tepër të madhe edhe përsa i përket faktit që ne, të gjithë, dëshirojmë të krijojmë një shoqëri të shëndetshme, një shoqëri ku të mbizotërojë rendi dhe qetësia, ku gjithsecili prej anëtarëve të saj të respektojë rregullat mbi të cilat është ndërtuar një shoqëri e tillë. Në një shoqëri të tillë gjen zhvillim edhe jeta ekonomike e një vendi të caktuar. Aty ku respektohet rregulli, aty do të jenë të shumta edhe investimet vendase dhe të huaja të cilat nga ana e tyre do të ndihmonin në përmirësimin e elementëve të tjerë ekonomikë siç janë në mënyrë të veçantë, ulja e papunësisë dhe rritja e konsumit. Për këtë arsye, rol të madh në zhvillimin e kësaj shkence kanë edhe kompanitë e ndryshme tregtare, të cilat janë të afta të investojnë për krijimin e profesionistëve të fushës që do ti ndihmonin jo vetëm shtetit dhe nevojave të shoqërisë por edhe vetë qëllimeve të caktuara të tyre në fushën tregtare.

## 2. Kontributi i Cesare Beccaria në zhvillimin e mendimit kriminologjik

Gjurmët e para të studimit të kriminalitetit lidhen me periudhën iluministe te shekullit XVIII dhe konkretisht me kontributin që ka dhënë juristi i njohur Cesare Beccaria (1738-1794)[14], i cili shërbeu si pikënisje për lindjen e shkollës klasike. Në librin e tij, “Krimet dhe dënimet” (*Dei delitti e delle pene*) (1764), Beccaria paraqet

[14] Cesare Beccaria, ka lindur në Milano në vitin 1738 në një familje të shquar dhe që gëzonte mirëqënie. Studimet e shkollës së mesme i ka kryer në Parma në një kolegj jezuit ku u dallua në matematikë dhe letërsi, duke treguar se ishte në gjendje të shprehte mendimet e tij në një formë të logjikshme. Në vitin 1754 ka studiuar për drejtësi në Pavia ku u diplomua në vitin 1758. Pas kthimit në Milano ai ndoqi “*Accademia dei Trasformati*” dhe zgjeron pikëpamjet e tij duke “përqafuar filozofinë” dhe duke iu afruar në idetë e tij Iluminizmit Francez që kishte krijuar dhe kristalizuar mendimin e tij (*Encyclopédie*) qysh prej vitit 1751 (Montesquieu - *Lettres persanes*, 1721; Helvétius - *De l'esprit*, 1758; Diderot - *De l'interprétation de la nature*, 1753). Shih, F. Manzalin, *Il contributo dell’illuminismo economico e giuridico alla modernità*, Dottorato di Ricerca in Economia, XXV ciclo, Università degli studi di Parma, a.a. 2013-2014, fq. 77-78.

aspektet themelore të botëkuptimit të tij në lidhje me të drejtën penale[15]. Ndër të tjera mund të përmendim: Funksioni i dënimit duhet ti shërbejë nevojave të shoqërisë dhe jo mbrojtjes së parimeve morale; Dënimi duhet të jetë në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore dhe nuk duhet të ketë vetëm qëllim ndëshkues – frikësues; Dënimi duhet të jepet vetëm për atë çfarë ka bërë individi dhe jo për atë që është apo për atë që do të bëhet; Krimineli nuk është mëkatar por një individ me vullnet të lirë, plotësisht i përgjegjshëm, që ka bërë zgjedhje kriminale për të cilat duhet të përgjigjet në përputhje me ligjin. Në krijimin e kësaj vepre, që pati jehonë të madhe në të gjithë kontinentin evropian, Beccaria niset nga mendimi se *njerëzit kanë sakrifikuar disa nga liritë e tyre duke rënë dakord që të jetojnë sipas rregullave të komunitetit dhe në këmbim të kësaj dakordësie kërkojnë më shumë siguri dhe më shumë shërbime. Për rrjedhojë, autoriteti i shtetit dhe forca e ligjeve duhet të konsiderohen të ligjshëm deri në momentin që nuk kapërcejnë limitet e pranuara nga populli në emër të të mirave të përbashkëta*. Me veprën e tij, Beccaria hodhi bazat për shfuqizimin e torturës dhe të dënimit me vdekje. Në lidhje me torturën, Beccaria ishte i mendimit se *tortura është në konflikt me kërkimin e së vërtetës që duhet të jetë katalizatori i zhvillimit të proçesit penal. Përdorimi i torturës mund të shpjerë në zgjidhje të sforcuara dhe aspak të vërteta: në fakt, reagimi ndaj torturës është subjektiv dhe varet nga rezistenca fizike dhe psikologjike e individit në lidhje me dhimbjen. Për rrjedhojë, në shumë raste tortura shndërrohet në mjet të sigurt për të liruar fajtorët e fuqishëm dhe për të dënuar të pafajshmit e dobët.*

Beccaria ka qënë një ndër përfaqësuesit kryesorë të Shkollës Klasike[16]. Parimet themelore mbi të cilat mbështetej mendimi i përfaqësuesve të kësaj shkolle janë:

[15] Në shkrimin e kësaj vepre, Beccaria ishte influencuar së tepërmi edhe nga shkrimet e autorëve të ndryshëm të periudhës iluministe, francezit Jean Jacque Russo dhe të anglezit John Locke. Për më shumë rreth këtij argumenti shih, S. Schiavo, *Cesare Beccaria, la tortura e i "romani legislatori"*, në Revistën "Rivista Internazionale di Scienze Giuridiche e Tradizione Romana", Anno XV – 2016 – Quaderno N.14, Università degli Studi di Sassari, fq. 5-27.

[16] Shkolla klasike paraqet një thellim të natyrshëm të konceptit liberal që frymëzohet nga parimet e iluminizmit dhe që ndikoi në mendimin penal për më shumë se një shekull. Përveç Cesare Beccaria dhe Jeremy Bentham, eksponentë të tjerë të kësaj shkolle mund të përmendim Francesco Carrara (1805-1888), Giovanni Carmignani (1768-1847), Pellegrino Rossi (1787-1848), Enrico Pessina (1828-1916). Sipas kësaj doktrine, krimi konsiston në shkeljen e vetëdijshme dhe vullnetare të ligjit penal nga një person që gëzon vullnet të lirë: me fjalë të tjera, mjafton që autori i krimit të ketë aftësinë për të kuptuar vlerën etiko-sociale të veprimeve të tij të kundërligjshme dhe që në mënyrë të vullnetshme dëshiron të kryejë. Dënimi duhet të jetë në përpjesëtim me krimin e kryer, pra

*Vullneti për të kryer vepra penale*: krimineli është një individ me vullnet të lirë që nuk varet nga origjina kriminale, kushtet sociale apo ambientale. Shkolla Klasike ka patur një vizion racional të krimeve, sipas të cilit individi vinte në peshore përfitimet dhe humbjet që do të kishte nga kryerja e veprës penale; *Papërgjegjshmëria*: për të patur vullnet në kryerjen e veprave penale duhet që fajtori të jetë i aftë të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij: nga kjo rrjedh parimi i aftësisë për të kuptuar dhe për të dashur, si një kërkesë kryesore për t'ju nënshtruar zbatimit të dënimit; *Dhënia e dënimit sipas meritës*: dënimi duhet të jetë në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore dhe duhet të jetë i përcaktuar qartë.

Në këtë kontekst, zhvilloi idetë e tij edhe Jeremy Bentham sipas të cilit, çdo gjë që bëhet në një shoqëri të caktuar duhet të synojë të prodhojë lumturi maksimale për sa më shumë njerëz që janë pjesë e asaj shoqërie. Bentham argumentoi se, në atë kohë, kishte patur një përdorim të tepërt të dënimit dhe se ashpërsia e dënimeve ishte rritur ngadalë: dënimi me vdekje u parashikua për më shumë se dyqind vepra penale në Angli por kjo nuk luante gjithmonë një rol frenues në kryerjen e veprave penale; për shembull, nëse përdhunimi dhe vrasja dënoheshin të dyja me vdekje, atëherë një përdhunues do të kishte më shumë gjasa ta vriste viktimën (heq qafe dëshmitarin) për të zvogëluar rrezikun e arrestimit dhe të dënimit. Sipas Bentham, njeriu është një "kafshë llogaritëse" që do të peshojë përfitimet e mundshme përkundrejt dhimbjes dhe vuajtjeve që mund të prodhojë kryerja e veprimeve të jashtëligjshme. Nëse dhimbja peshon më shumë se përfitimet, personi do të largohet nga ideja për të kryer krim dhe kjo do të prodhojë një dobi më të madhe shoqërore. Prandaj, në një sistem

---

duhet të kuptohet nga autori i veprës penale si kompensim i nevojshëm për të keqen e bërë (teoria e ndëshkimit). Merita e shkollës klasike konsiston në përgatitjen e disa prej parimeve themelore të një sistemi të bazuar në garancitë e lirive personale: parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit mund të dënohet vetëm sjellja e paraparë me ligj si krim; parimi i sigurisë juridike, sipas të cilit duhet të përcaktohet saktësisht dënimi për sjelljen e përcaktuar me ligj si të paligjshme; parimi i garancisë, që përmban rregulla për të mbrojtur të drejtën e mbrojtjes dhe prezumimin e pafajësisë; ndalimi i analogjisë, sipas të cilit, në mungesë të një dispozite të shprehur legjislative, nuk mund të nxirret rregullimi i një rasti të parregulluar nga ai i parashikuar për një rast të ngjashëm. Shih, AA.VV. (grup autorësh), *Compendio di Criminologia*, a cura di Mariarosaria Rumore, Esselibri-Simone, Napoli, 2011, fq. 19.

racional, mënyra e ndëshkimit duhet të jetë proporcionale në mënyrë që dënimi të korrespondojë më afër me rrezikshmërinë shoqërore të krimit[17].

## 3. Klasifikimi i teorive të shpjegimit të kriminalitetit

Në kriminologji, si në çdo shkencë tjetër, teoria paraqet një faktor progresi dhe një stimul për kërkime. Në fakt, një teori duhet të përfshijë domosdoshmërisht kërkime që synojnë ta verifikojnë atë: kështu fillon një proces shkencor, pasi rezultatet e kërkimit duhet të çojnë në zhvillimin e teorive të reja, të cilat, nga ana tjetër, duhet të kontrollohen, e kështu me radhë: e thënë ndryshe, një teori kriminologjike përmbledh një grup faktesh dhe hipotezash dhe përfaqëson vetëm një mjet pune që synon të nxisë kërkime të reja. Çdo teori është e destinuar të zëvendësohet nga një tjetër, më afër realitetit, kur dija të ketë përparuar.

Në kohët më të hershme, mbizotëronte mendimi se përkufizimi i objektit të studimit të kriminologjisë ishte i lidhur vetëm me studimin e sjelljes kriminale: me fjalë të tjera kriminologët mundoheshin që nëpërmjet studimeve të tyre ti përgjigjeshin pyetjes se përse njerëzit përfshiheshin në kriminalitet. Në të shumtën e rasteve, autorë të ndryshëm e vinin theksin tek personaliteti i personit që kryen veprën penale, ndërsa disa të tjerë merrnin në konsideratë edhe kushtet shoqërore që favorizonin kryerjen e veprimeve kriminale apo momentin e kalimit të një personi në një gjendje të tillë që e bënte të gatshëm për të kryer veprën penale.

Në ditët e sotme, kushdo mund të japë mendimin dhe të arsyetojë se përse njerëzit përfshihen në kriminalitet apo përse thyejnë rregullat mbi të cilat mbështetet një shoqëri e caktuar por që, gjithsesi, nuk mund të gjejmë ndonjë shpjegim të plotë ose shkak përfundimtar të sjelljes kriminale. Sipas mendimit tonë, një sjellje e tillë përfshin një sërë aktivitetesh kaq masive saqë një synim i tillë është qartësisht jorealist. Kjo është e vërtetë, pasi një teori që shpjegon se përse disa njerëz që punojnë në punë të paguara mirë përfshihen në korrupsion nuk mund të shpjegojë se

[17] Shih, G. Paolo Demuro, *Ultima Ratio: Alla ricerca di limiti all'espansione del diritto penale*, në Revistën "Rivista Internazionale di Scienze Giuridiche e Tradizione Romana", Anno XII – 2013 – Quaderno N.11, Università degli Studi di Sassari.

përse disa njerëz të tjerë kryejnë akte të dhunës në familje. Për ta thënë ndryshe, a ka mundësi që identiteti kriminal i një mashtruesi të jetë i njëjtë me një grabitës të dhunshëm? Për më tepër, edhe nëse do të mund të vërtetohet një lidhje e ngushtë mes kriminalitetit të të miturve dhe mbikëqyrjes së dobët të prindërve, si mund të shpjegohet fakti që disa të mitur, të mbikqyrur dobët nga prindërit nuk përfshihen në kriminalitet? Po në rastin e të miturve të mbikqyrur dobët nga ana e prindërve a duhet të merret në konsideratë fakti se përse ata prindër nuk ishin në gjendje të siguronin mbikëqyrje të përshtatshme? Kjo është për shkak të kushteve të tyre të jetesës dhe, nëse po, pse jetojnë në kushte kaq të këqija? A është kjo për shkak të politikave të dobëta të qeverisë për strehimin apo për shkak të politikave të dobëta të punësimit? Nisur nga kjo mori pyetjesh, duket qartë se po largohemi gjithnjë e më shumë nga shpjegimi i shkakut të sjelljes kriminale. Kjo nuk do të thotë se nuk është e rëndësishme të kërkohen shpjegime të sjelljes kriminale por, në çdo rast, duhet të jemi të vetëdijshëm se qasjet dhe shpjegimet e ndryshme teorike mund të ndihmojnë në shpjegimin e disa formave të sjelljes kriminale por jo të formave të tjera dhe se nuk ka asnjë "shpjegim përfundimtar" që pret të zbulohet.

Në kriminologji ekzistojnë shumë teori që shpjegojnë, në përputhje me pjesën e studimit që është bërë, shkaqet e kryerjes së veprës penale dhe përfshirjes së individëve në kriminalitet. Autorë dhe studiues të ndryshëm, pavarësisht mospërputhjeve në kriteret e përdorur, janë përpjekur të paraqesin klasifikimet e tyre në lidhje me këtë këndvështrim. Mund të themi se problemi i gjetjes së një kriteri metodik dhe të përshtatshëm për klasifikimin e tyre përbën një problem thelbësor pasi orienton drejtimin e zhvillimit të kërkimit kriminologjik në shpjegimin e sjelljes kriminale.

Kështu, për shembull, Jean Pinatel dalloi katër epoka në historinë e kriminologjisë mbi bazën e të cilave bëri edhe klasifikimin e teorive: Epoka e Lombrosos (1876-1913); Epoka e reagimit anti-Lombroso (1913-1934); Epoka e pajtimit dhe e sintezës (1934-1960); Epoka moderne (që nga viti 1960 e më pas)[18].

[18] Shih, L. Mucchielli, *Sociology of Deviance and Criminology in France: History and Controversies*, në Revistën "The American Sociologist", December 2017.

Sipas Raymond Gassin klasifikimi i teorive të shpjegimit të shkaqeve të kriminalitetit duhet të bëhet mbi bazën e krijimit të shkollave kriminologjike: “Shkollat kryesore” (shkolla antropologjike e Cezare Lombroso; shkolla e orientimit sociologjik (teoria hartografike Quetelet e Guerry, teoritë sociologjike të Marks dhe Engels, teoria e mjedisit social e Lacassagne, teoria ndërpsikologjike e Tarde, teoria sociologjike e Durkheim); shkolla e ndërveprimit të faktorëve (teoria e Ferrit dhe teoria antropologjike-gjermane e F. von Liszt); “Shkollat moderne”, bënë klasifikimin e teorive që shpjegojnë shkaqet e kriminalitetit bazuar në faktorët: biologjiko-psikologjik; psikologjiko-social; psikologjiko-moral; përzierjes së faktorëve; Shkolla e kriminologjisë dinamike të veprimit kriminal (aktive në vitet 1940-1960 dhe konkretisht: teoria e kriminologjisë dinamike të përditësuar dhe teoritë dinamike autonome); Shkolla e reaksioneve sociale që në vitet 1960 - 1970 pati ndikim në zhvillimin e mëtejshëm të kriminologjisë (koncepti i ndërveprimit të faktorëve apo kriminologjia organizative, që merrej me hartimin e ligjit penal dhe funksionalitetin e institucioneve të lidhura me të drejtën penale, policia, gjyqësori, institucionet penale por edhe orientimi radikal); Shpjegimi i shkaqeve bazuar në të dhënat viktimologjike[19].

Një klasifikim tjetër i teorive të shpjegimit të shkaqeve të kriminalitetit përmban: Teoritë demonologjike; Teoritë klasike dhe postklasike të zgjedhjes së vullnetshme; Teoritë individualiste pozitiviste (teoritë biologjike, teoritë psikoanalitike të personalitetit); Teoritë pozitiviste-sociologjike; Teoritë e procesit të të mësuarit social; Teoritë kritike (konfliktuale, anarkiste, marksiste, feministe, postmoderniste)

Pavarësisht ekzistencës së klasifikimeve të ndryshme, ne do të bëjmë klasifikimin e teorive bazuar në shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit, të shpjegimit të kriminalitetit bazuar në shkaqe individuale dhe sociale dhe për këtë arsye do të radhisim këtu: *Teoritë biologjike*, janë teoritë e para të shpjegimit të kriminalitetit. Autori i parë që tentoi të shpjegonte ekzistencën e krimit dhe kriminelit është mjeku psikiatër Cesare Lombroso; *Teoritë psikologjike*, merren me studimin e karakteristikave të personalitetit të cilat mund të shpjegojnë arsyet që

[19] R. Gassin, S. Cimamonti, P. Bonfils, *Criminologie*, Précis Dalloz, 7e éd., Paris, 2011.

fshihen mbas sjelljeve kriminale. Studimet e para që vunë theksin mbi lidhjet e mundshme midis personalitetit dhe krimit i takojnë studiuesit belg Etienne De Greeff; *Teoritë sociologjike,* kanë filluar të lindin në gjysmën e parë të shekullit XX, në SHBA. Këto teori merren me analizën e krimit dhe të kriminalitetit duke e zhvendosur interesin e studimeve nga individi tek shoqëria dhe e konsiderojnë sjelljen kriminale si sjellje sociale; *Teoritë ekonomike,* e lidhin kryerjen e krimeve me zgjedhjet racionale të individit të bazuara mbi një sistem ponderimi të kostove dhe përfitimeve të cilat do të vijnë si pasojë e sjelljes kriminale.

Historia e zhvillimit kriminologjik karakterizohet nga një konkurrencë e pandërprerë midis dy imazheve po aq abstrakte të njerëzimit dhe secila prej tyre mund të bëhet e rëndësishme në shpjegimin e realitetit kriminal: nga njëra anë, idealizmi që e sheh qenien njerëzore të pajisur me vullnet të lirë dhe racionale (*Beccaria*) dhe, nga ana tjetër, një materializëm që e dizenjon kriminelin si totalisht të përcaktuar dhe jo racional (*Lombroso*). Mund të themi se, individi racional dhe me vullnet të fortë kundërshton individin e vendosur dhe të shtyrë për të kryer krimin, siç ka ndodhur që kur klasicizmi dhe pozitivizmi u rreshtuan kundër njëri-tjetrit në shpjegimin e sjelljes kriminale. Në fund të fundit, beteja midis funksionalistëve strukturorë dhe teoricienëve të etiketimit e ka origjinën nga një kontrast i ngjashëm dhe, sigurisht sot, rishfaqja e forcave të reja dhe idealiste të neoklasicizmit dhe format virulente të neopozitivizmit përsërisin të njëjtën betejë. Dhe atëherë lind një pyetje: A mund të flasim për shpërbërjen e një disipline që ka humbur objektin e saj të përbashkët të studimit (sjelljen kriminale)? Konstatimi se kriminaliteti është një kategori shumë heterogjene sjelljesh të ndryshme e bën të vështirë perceptimin e “kriminalitetit” dhe “kriminelit” si të vetmet objekte qendrore të një shkence që studion sjelljen njerëzore. Në fakt, problemi i heshtur, i lindur në fillim të shekullit të kaluar rishfaqet përsëri: nëse duam të studiojmë kriminalitetin, është thelbësore të përfshijmë edhe dinamikën socio-ligjore të përkufizimit dhe të kontrollit të kriminalitetit. Dihet se integrimi i këtij dualiteti në një qasje të vetme është jashtëzakonisht i vështirë duke qënë se përfshihen disiplina të ndryshme shkencore.

# KREU II

## TEORITË BIOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT

**PËRMBAJTJA**: 1. Teoria e kriminelit të lindur. – 2. Teoria e Enrico Ferrit dhe parimet e shkollës pozitive. – 3. Trashëgimia dhe kriminaliteti. – 4. Raca dhe kriminaliteti.

Në mënyrë të vetëdijshme apo edhe të pandërgjegjshme, objektivat kryesore biologjike të qënies njerëzore janë mbijetesa dhe arritja e një niveli të mirë riprodhues. Për pasojë, edhe sjellja jonë, në përgjithësi, do të priret të jetë në shërbim të arritjes së këtyre objektivave: ekzistenca e një numri të madh njerëzish që jetojnë sot në të gjithë botën, është dëshmi e aftësisë tepër të madhe të njeriut për përshtatje dhe nivelit të madh riprodhues që ai gëzon. Mënyra se si njeriu e arriti këtë nivel riprodhimi padyshim që ka implikim edhe në fushën e kriminologjisë[20]. Shpjegimet e para shkencore rreth kriminalitetit kanë pasur karakter antropologjik dhe janë të rëndësishme sepse hodhën bazat për zhvillimin e shkencës së kriminologjisë biologjike sipas së cilës, disa njerëz kanë lindur për të qenë kriminelë si pasojë e trashëgimit të dispozitave gjenetike ose fiziologjike për të kryer krim.

### 1. Teoria e kriminelit të lindur

Kjo teori njihet ndryshe edhe si teoria e Lombrozos[21], sipas të cilit, *krimineli është një qenie ataviste që rishfaq mbi veten e vet instiktet e egra të njeriut primitiv dhe te kafshëve më të ulëta*.

[20] M. Marchetti, F. Baralla, *Ulcune considerazioni su natura umana: Socialit*à *e prevenzione della criminalit*à, në Revistën “Rasegna Italiana di Criminologia”, Volume III, N.1, 2009.
[21] Shih, Enciclopedia online Treccani, Lombroso Cesare, psikiatër dhe antropolog italian ka lindur në Verona më 6 nëntor 1835 dhe ka vdekur në Torino më 19 tetor 1909. Në vitin 1853 fillon studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Pavisë. Pas përfundimit të studimeve fillon karrieren profesionale si mjek psikiatër pranë

Lombroso theksoi se studimi i krimit duhej të fokusohej, në radhë të parë, tek mënyra e ndërtimit të qënies njerëzore: duhej studiuar aspekti fizik, biologjik dhe personaliteti i kriminelit, përbërësit e tij të sëmurë, të cilët ishin përgjegjës për sjelljen kriminale. Ai përdori për herë të parë metodat e kërkimit biologjik për studimin e autorit të veprës penale duke i dhënë një drejtim organik dhe sistematik studimit të kriminalitetit. Përpara Lombrozos shtrohej problemi i shpjegimit të sjelljes kriminale si një sjellje që lidhet me vullnetin e lirë apo si një sjellje që ndikohet nga probleme të zhvillimit njerëzor. Mendimi i tij u influencua së tepërmi nga hetime mbi ndërtimin e strukturës së njeriut e gërshetuar me studime psikiatrike mbi çmendurinë dhe budallallikun duke i dhënë jetë teorisë së njeriut kriminel.

Teoria e "kriminelit të lindur", e shpjeguar në librin "Njeriu kriminel" (1876), përfaqëson teorinë e parë kriminologjike, sipas së cilës një numër shumë i lartë i të dënuarve për krime të rënda kishin anomali anatomike, fiziologjike dhe psikologjike, të cilat kishin ndikuar tek sjelljet kriminale. Çmenduria, epilepsia dhe patologjitë e tjera të përgjithshme ishin gjithashtu të rëndësishme midis shkaqeve të prirjes së lindur për të kryer krim. Midis të çmendurve dhe kriminelëve nuk ka dallim në cilësitë dhe prirjen e tyre për të kryer vepra penale por ka ndryshim vetëm përsa i përket gradës së përfshirjes së tyre në kriminalitet: të dyja këto kategori i përkasin fazës ataviste të racës njerëzore, por krimineli i përket një kategorie që ka zhvillim më tepër arkaik se ai i të çmendurit.

Në krijimin e teorisë së tij, Lombroso u mbështet në një gamë të gjerë referencash, shkencore dhe joshkencore, ndër të cilat përmendim: fizionomia e Della Porta dhe Lavater, frenologjia e Gall, psikiatria e Pinel dhe Esquirol, teoria e degjenerimit e Morel, atavizmi që tashmë ishte i pranishëm në psikiatri dhe antropologji, evolucionizmi i Spencer, teoria e Darvinit. Gjithashtu, sipas një pjese të doktrinës, teoria e Lombrozos përveçse ndihmoi në shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit u përdor nga klasa drejtuese në pushtet edhe për "identifikimin e

Klinikës psikiatrike dhe antropologjike në Pavia. Mësimet e para në lidhje me sëmundjet mendore filloi ti jepte në vitin 1862 në Pavia. Studimet e tij të mëvonshme u përqendruan në antropologji, tek të sëmurët mendore dhe tek kriminelët. Në vitin 1876 ka ngritur Muzeun e Antropologjisë Kriminale, pranë Universitetit të Torinos. Ka krijuar teorinë e parë të shpjegimit të kriminalitetit e cila shënoi edhe lindjen e kriminologjisë si shkencë.

armiqve", banditët, anarkistët, anëtarët e "klasave të rrezikshme" të qyteteve dhe etiketimin e tyre si kriminelë të lindur[22].

Rasti i parë i ekzaminuar nga Lombroso, ishte i një 70 vjeçari kalabrez që vdiq në burg, i dyshuar për vjedhje me dhunë[23]. Nga autopsia që Lombrozo kreu, vuri re, para së gjithash, se në pjesën e poshtme të kafkës ekzistonte një bashkim i lindur i pjesës përkatëse të zverkut me vertebrën e parë cervikale të kolonës vertebrale. Ndërkohë ai vuri re edhe anomali të tjera, të tilla si mungesa e kreshtës së brendshme oksipitale, deformimi i kreshtës mesatare dhe deformime të tjera të kockave të kafkës, të cilat shtynë Lombrozon të arrinte në përfundimin se ato karakteristika të veçanta të kockave kishin patur një farë ndikimi në aktivitetin e trurit të vogël. Sipas Lombrozos këto anomali të kockave vinin si pasojë e një ndalimi në zhvillimin e trurit. Gjithashtu, Lombrozo ishte i mendimit se ekzistenca e gropës së mesme tek disa njerëz (si rregull gropa e mesme ekzistonte tek njerëzit e parë dhe tek gorillat), të çonte tek mendimi se ekzistonte një lidhje mes zhvillimit natyror të qënies njerëzore dhe sjelljes së njeriut brenda kontekstit shoqëror. Rasti i dytë i ekzaminuar kishte të bënte me një vrasës që paraqiste karakteristikat e një njeriu të pazhvilluar (atavizëm – që shfaq ndërtimin e qënieve të para njerëzore), që kanë ndikuar edhe tek sjelljet e tij kriminale që nuk lidheshin me vullnetin e tij të lirë por me difektet e strukturës së tij fizike.

Në librin e tij "Njeriu kriminel", Lombrozo bëri një ndarje të kategorive të kriminelëve[24]: *Krimineli i lindur*, në të cilin kriminaliteti kishte lidhje me personin e tij dhe për rrjedhojë është i parekuperueshëm. Një person i tillë lind me prirje kriminale dhe me karakteristika të veçanta si mungesa e moralit, nuk e bren ndërgjegja, përdorim i shprehjeve të rrugës dhe të tatuazheve. Figurat më të zakonshme të kësaj kategorie janë vrasësit dhe hajdutët. Cinizëm, pandjeshmëri psiko-fizike për vuajtjet dhe dëmet e viktimave, të vetes së vet dhe të

[22] Shih, P. Massaro, *Alla (ri)scoperta della scuola positiva, tra impegno politico e "slancio" sociale*, Dipartimento Jonico in Sistemi Giuridici ed Economici del Mediterraneo: Società, Ambiente, Culture, Università degli studi di Bari "Aldo Moro", Annali 2017, Anno V, fq. 240.
[23] Shih, E. Musumeci, *Il crimine come fenomeno naturale: la "rivoluzione" di Cesare Lombroso*, në Revistën "Suite Française": Rivista di cultura e politica, 4/2021, Pisa.
[24] Shih, C. Lombroso, *L'uomo delinquente: in rapporto all'antropologia, alla giurisprudenza ed alle discipline carcerarie*, Quinta edizione, Volume primo, Fratelli Bocca Editori, Torino, 1896, fq. 136 e në vazhdim.

bashkëpunëtorëve janë karakteritika të tjera. Për këtë kategori Lombrozo shkruan 14 kapituj duke vëzhguar ndjeshmërinë, pasionet, besimin, inteligjencën, emocionet, arsimimin, genjeshtrat, pasaktësinë dhe përtacinë; *Krimineli i rastit,* karakterizohet nga dobësia në moral dhe shkel rregullat i ndikuar nga faktorë të ndryshëm nga ato të kriminelit të lindur. Ndikohet për të kryer vepra penale nga faktorë rrethanorë më shumë se nga faktorë biologjikë; *Pseudo – kriminelët*, janë ata persona që kryejnë vepër penale pa dashje ose të shtyrë nga rrethana të veçanta siç është vetëmbrojtja; *Krimineli epileptik, i sëmuri mendor, i çmenduri apo me shëndet mendor të dobët*, janë të gjithë ata kriminelë që veprojnë pa ndonjë motiv, të shtyrë nga budallallëku ose nga fakti i të qënit i çmendur; *Krimineli pasional*, paraqet një përçmim të ligjeve që vjen nga një errësim momental i sensit moral. Kur kalon ky moment, krimineli tenton pendimin e sinqertë.

Aspektet fizike të marra në konsideratë nga Lombrozo dhe që identifikonin personin kriminel janë: Kafka, kockat e fytyrës, truri, anomali të veshëve, strabizmi, anomali të buzëve, flokët, lëkura, anomali të dhëmbëve, përdorimi i të majtës, belbëzim ose anomali të tjera funksionale, merret në konsderatë edhe shtrati, pesha, forma e duarve, raporti i shtatit me hapjen e krahëve. Sipas Lombrozos, nëse subjekti i ekzaminuar paraqiste një numër të madh të karakteristikave anormale mund të klasifikohej tek kategoria e kriminelëve të lindur.

## 2. Teoria e Enrico Ferri dhe parimet e Shkollës Pozitive

Teoria e Ferrit, edhe pse radhitet mes teorive me bazë biologjike, paraqet zhvillimin e një mendimi të ri që qëndron mes teorisë së Lombrozos dhe shpjegimeve të kriminalitetit të përpunuara nga përfaqësuesit e shkollës klasike. Mes këtij kontrasti mendimesh që mbizotëronte në këtë periudhë në radhët e kriminologëve italianë lidhur me shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit, ishte e natyrshme lindja e një mendimi të ri shkencor që bazohej tek ndikimi i faktorëve socialë në përbërjen kriminale të natyrës njerëzore. Ferri ishte i mendimit se për të kuptuar shkaqet e kriminalitetit duhet të studiohen jo vetëm aspektet individuale të

delinkuentit por edhe faktorët socialë dhe faktorët e mjedisit fizik të cilët ndikojnë sjelljen e tij[25].

Sipas mendimit tonë, teoria e Ferrit është një nga teoritë më të mira të shpjegimit të kriminalitetit jo vetëm për shpjegimin real të shkaqeve të kriminalitetit por edhe për faktin se shërbeu si një urë lidhëse ndërmjet teorive me bazë biologjike dhe atyre me bazë sociale që në vitet e mëpasshme përbëjnë rrymën më të rëndësishme të zhvillimit të shkencës së kriminologjisë.

Megjithëse për disa raste të caktuara, si për shembull kur shpjegonte përfshirjen në krim të ndonjë të mituri[26], Ferri bazohej tek parimet e sanksionuara nga teoria e Lombrozos, mund të themi se ai nuk ishte plotësisht dakord me teorinë e "kriminelit të lindur". Ferri ishte i mendimit se për të shpjeguar kriminalitetin, kriminologu nuk duhet të bazohet tek karakteristikat fiziologjike të individëve por duhet ti kushtojë më tepër rëndësi karakteristikave psikologjike, personalitetit të delinquentit dhe mjedisit në të cilin vepron ky personalitet, për të cilat thoshte se ishin përcaktuese në zhvillimin kriminal të individit. Nga ana tjetër, në kontrast me orientimet e shkollës klasike, ai theksoi faktin se anëtarët e kësaj shkolle ishin përqendruar, pothuajse, ekskluzivisht te autori i krimit, duke harruar një numër të madh njerëzish fatkeq të cilët luftojnë në përditshmërinë e tyre me një jetë të mjerueshme që i shoqëron ngado dhe që gëzon epërsi morale ndaj shkaqeve individuale të kriminalitetit duke e bërë tepër të vështirë dëshirën për të jetuar me ndershmëri[27].

Enrico Ferri, në shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit thekson, në mënyrë të veçantë, rolin e mbrojtjes sociale në parandalimin e kriminalitetit duke hedhur në

---

[25] Shih, E. Ferri, *Sociologia criminale*, quarta edizione, Fratelli Bocca Edittori, Roma, 1900, fq. 2.

[26] Shih, F. Colao, *"L'albero nuovo si piega meglio di quello vecchio". La giustizia "educatrice" per i minori nell'Italia liberale*, në Revistën "Historia et ius" - Rivista di storia giuridica dell'età medievale e moderna, 10/2016 - paper 1. Mbrojtja e shoqërisë është parësore, shkruante Ferri kur tregonte "kriminelin e lindur" në dikë që ende pa mbushur 9 vjeç kishte kryer një vrasje. Kryerja e veprës penale në këtë moshë u vu në dukje si një "simptomë karakteristike" që nuk ishte produkt i mjedisit social por i prirjeve të pamoralshme të lindura. Ferri kujton se gjatë një vizite me studentët e tij në një institucion penitenciar kishte identifikuar një vrasës për shkak të defekteve fiziologjike (ngritjes anësore të buzës, si te macet, të vërejtura më parë edhe nga Darvini). Drejtori kishte deklaruar se në institut strehoheshin vetëm "të burgosur që kishin nevojë për riedukim" por djali - kur u mor në pyetje - u përgjigj se ishte aty transit për të kaluar në një institucion penitenciar tjetër, pasi i kishte shtypur kokën vëllait të tij të vogël me një gur. Ferri e cilësoi riedukimin të pamundur për "vrasësin e lindur" tepër të ri, i karakterizuar edhe nga "zhvillimi jonormal i dhëmbëve të qenit".

[27] Shih, N. Cappolino, *Agli albori della prevenzione situazionale: l'attualità dei sostitutivi penali di Enrico Ferri*, në Revistën "*Rivista di Criminologia, Vittimologia e Sicurezza*", Volume XVI, Bologna, 2022, fq. 198.

këtë mënyrë bazat e teorisë së parandalimit social të kriminalitetit dhe duke kundërshtuar parimet e sanksionuara nga Beccaria në veprën e tij “Krimet dhe dënimet”. Ferri kishte mendimin se një pjesë e kriminelëve ishin të pandreqshëm, ndërsa pjesa më e madhe e tyre mund të përmirësoheshin ose të shpëtoheshin nga kryerja e krimeve, duke propozuar edhe rrugët e përmirësimit për disa nga tipat e autorëve të veprave penale. Për kriminelët e lindur dhe të sëmurë mendërisht, Ferri propozonte individualizimin e tyre dhe neutralizimin, ndërsa për kategoritë e tjera propozonte masa të ndërhyrjes sociale[28].

Një tjetër aspekt pozitiv i teorisë së Ferrit lidhet me faktin se kjo teori ndihmoi në lindjen e një mendimi të ri juridiko-penal dhe kriminologjik, sipas të cilit, të dhënat e vëzhgimeve empirike duhet të përbënin të vetmen pikënisje për të interpretuar faktet kriminale dhe për të propozuar rregullimet e mundshme. Ky mendim u materializua në botimin e një reviste që u quajt Shkolla Pozitive dhe pati një ndikim të rëndësishëm qoftë në kriminologji qoftë në zhvillimin e të drejtës penale. Kjo shkollë i kushtoi më shumë rëndësi personalitetit sesa faktit kriminal duke nxitur kërkimin dhe studimin mbi shkaqet individuale të kriminalitetit[29]. Sipas juristëve (përfaqësues të shkollës klasike), sociologjia, antropologjia, psikologjia, statistika, politika kriminale janë shkenca ndihmëse të shkencës së përgjithshme të së drejtës penale, ndërsa për përfaqësuesit e shkollës positive e drejta penale përfaqësohet nga sociologjia kriminale degë të së cilës janë të gjitha shkencat e përmendura më sipër. Studimi i krimit i bazuar mbi logjikën abstrakte pa bërë paraprakisht vlerësimin e personalitetit të autorit të veprës penale, pa përcaktuar motivet që e kanë shtyrë dhe pa mbajtur parasysh mjedisin në të cilin është kryer

[28] Shih, C. Lattini, *I “segni” della devianza e la criminalità dei poveri. Pena e prevenzione nel pensiero di Enrico Ferri, un socialista fuzzy,* në Revistën “Historia et ius” - Rivista di storia giuridica dell’età medievale e moderna, 11/2017 - paper 10. Ferri është përballur me probleme të ndryshme lidhur me krimin, ndër të cilat mund të përmendim edhe recidivizmin. Në punimet e një konference të mbajtur në Paris me temë “*La criminalité par rapport à la criminologie*”, Ferri kujton se kishte intervistuar disa persona të dënuar për vjedhje dhe i kishte pyetur se çfarë planesh kishin kur të dilnin nga burgu. Përgjigjja ishte se do të fillonin sërish të vjedhin. Me sa duket, sipas tyre, dënimi me burg u shfaq si një “aksident” që mund të ndodhte në çdo lloj pune. Nga këto intervista Ferri nxori joefektivitetin e ndëshkimit penal dhe besonte se të gjitha krimet rrjedhin nga pasioni, zemërimi apo varfëria. Nëse krimet e kryera nga pasioni nuk mund të eliminoheshin, të tjerat, pra krimet e kryera për shkak të varfërisë, mund të kontrolloheshin duke vepruar mbi shkaqet e varfërisë.

[29] Shih, E. De Nicola, *Le due scuole penali: Dissensi teorici e consensi pratici.* Estratto dagli scritti in onore di Enrico Ferri, pubblicati dall’Unione Tipografico-Editrice Torinese, Torino, 1929, fq. 5.

krimi e bën të drejtën penale një “shpërndarëse të recetave” dhe funksionin e gjyqtarit e shndërron në një zbatim automatik dhe mekanik të një neni të caktuar të kodit penal.

Përfaqësues të tjerë të këtij mendimi mund të përmendim: Raffaele Garofalo, Luigi Maino, Adolfo Zerboglio, Agostino Berenini, Gonario Pinna, Sante De Sanctis, Enrico Altavilla, Francesco Gianniti. Parimet mbi të cilat mbështetet Shkolla Pozitive janë: Krimineli është një individ jo normal; Krimi kryhet si pasojë e ndërveprimit të tre faktorëve, antropologjik, psikik dhe social. Për rrjedhoje, kriminaliteti nuk është pasojë e zgjedhjeve individuale, ashtu siç mbrohej nga pjesëtarët e shkollës klasike, por është i kushtëzuar nga ekzistenca e faktorëve të sipërpërmendur; Ndëshkimi penal nuk duhet të ketë qëllime ndëshkuese por duhet të synojë neutralizimin dhe mundësisht riedukimin dhe risocializimin e kriminelit dhe si i tillë duhet të përcaktohet dhe zbatohet në funksion të personalitetit të tij.

Teoritë kriminologjike të shkollës pozitive patën jehonë të madhe edhe midis kriminologëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ndikuan në projektimin e një modeli të ri të drejtësisë penale mes fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Fillimisht antropologjia kriminale e Lombrozos dhe më pas trajtimet sociologjike të Ferrit dhe Garofalos ndikuan në mënyrë të ndjeshme zhvillimin e mendimit kriminologjik në SHBA, saqë edhe sot në pothuajse çdo tekst të kriminologjisë përmenden emrat e këtyre autorëve. Në mënyrë të veçantë, teoria e Ferrit mbahet parasysh në zgjedhjet e politikës kriminale[30].

## 3. Trashëgimia biologjike dhe kriminaliteti

Disa studime janë fokusuar tek lidhja ndërmjet kriminalitetit dhe elementëve të trashëguar nga njëri brez në tjetrin. Sipas këtyre studimeve, nuk mund të diskutohet për ekzistencën e një “gjeni kriminal” që është shkaktar për përfshirjen e personit në

[30] Shih, M. Pifferi, *L’influenza della scuola positiva negli Stati Uniti: Luci ed ombre di un successo culturale*, në Revistën “Diritto penale XXI secolo”, Anno X, Nr.2, Atti del convegno nazionale in ricordo di Giuliano Marini: Scuola positive e Codice Rocco, Cedam, Torino, 2011, fq. 537.

kriminalitet[31]. Prirjet më të mëdha drejt sjelljeve antishoqërore janë rezultat i ndikimeve të disa elementëve të trashëguar që veprojnë reciprokisht dhe në mënyrë shumëplanëshe. Ndikimi i trashëgimisë biologjike në kryerjen e sjelljeve të jashtëligjshme dhe që dëshmon praninë e rreziqeve gjenetike është më i madh tek subjektet që vuajnë nga çrregullime të personalitetit që shoqërohen nga një papërshtatshmëri psikosociale e lidhur me veçim të fortë dhe izolim; personalitete të paaftë për të shprehur emocione dhe për të provuar ndjeshmëri, të cilët priren të kenë një humor negativ edhe për shkak të zhvillimit të një forme armiqësie ndaj individëve të përshtatur me shoqërinë. Këta individë janë shumë impulsivë dhe të prirur për të kryer veprime të dhunshme, janë sadistë në kërkim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe ndjesive të forta.

Studiues tjetër në fushën biologjike mund të përmendim Richard Dugdale i cili ekzaminoi paraardhësit e krimineleve me qëllim që të gjente shenja të trashëgimisë kriminale. Sipas tij kriminaliteti është i lidhur me shkaqe biologjike[32]. Dugdale studioi pemën gjenetike të familjes Juke dhe ky studim e çoi në përfundimin se sjelljet e jashtëligjshme janë të trashëgueshme. Sipas tij, në gjeneratat e kësaj

---

[31] Shih, M. Bochicchio, *L'evoluzione della violenza e dell'aggressività ai giorni d'oggi: analisi integrale della condotta della devianza*, në Revistën "Rivista di Psicopatologia Forense, Medicina Legale, Criminologia", 2020, Volume 25:548, Sapienza Università di Roma. Studim i kryer në Universitetin e Montrealit. Ekspertët kryen një vlerësim psikosocial në 555 çifte binjakësh, nga të cilët 223 ishin monozigotikë dhe 332 heterozigotë. Pasja e të dy llojeve të binjakëve bëri të mundur vlerësimin nëse dallimet individuale të zbuluara ishin të lidhura me faktorë gjenetikë apo mjedisorë. Sjelljet agresive janë regjistruar nga mësuesit, për të patur një këndvështrim neutral jashtë familjes, në moshat 6, 7, 9, 10 dhe 12 vjeç. Studiuesit u fokusuan në sjelljet agresive proaktive dhe reaktive. Agresioni proaktiv nënkupton një formë agresioni të karakterizuar nga sjellje fizike dhe verbale që synon të dominojë ose të marrë një avantazh personal në dëm të të tjerëve. Agresioni reaktiv i referohet atij lloji të agresionit të karakterizuar nga një përgjigje mbrojtëse kur perceptohet një kërcënim. Vlerësimi i rezultateve zbuloi se në fëmijët e moshës 6 vjeçare, të cilët ndajnë pothuajse tërësisht të njëjtët faktorë gjenetikë, vërehen të dy llojet e agresionit, reaktiv dhe proaktiv. Me rritjen vërehet se sjellja agresive tenton të ulet, duke arritur në përfundimin se midis moshës 6 dhe 12 vjeç, faktorët mjedisorë kanë një peshë më të madhe se komponenti gjenetik. Në këtë këndvështrim, agresioni konsiderohet si një element fiziologjik dhe përbërës i zhvillimit psiko-social të fëmijës. Ndërsa fëmija rritet, ai mëson të menaxhojë më mirë emocionet e tij, duke arritur të adoptojë metoda komunikimi që janë më të përshtatshme për një funksionim të mirë shoqëror, një rrugë që duhet të vazhdojë dhe të rafinohet gjithnjë e më shumë në moshën madhore.

[32] Shih, G. Montalenti, *Eredità biologica*, në Enciclopedia Treccani online, https://www.treccani.it/enciclopedia/eredita-biologica_%28Enciclopedia-del-Novecento%29/ Problemi i trashëgimisë ose më mirë të themi i trashëgimisë biologjike, që lidhet me transmetimin tek pasardhësit të karakteristikave morfologjike, fiziologjike, psikike dhe ndoshta patologjike, ka qënë gjithmonë objekt studimi për natyralistët, mjekët dhe filozofët. Në të kaluarën dhe deri në fund të shek. XIX, trashëgimia nënkuptonte transmetimin e karakteristikave nga prindërit te fëmijët, pra i kushtohej vëmendje faktit që fëmijët ngjasojnë me prindërit e tyre. Gjithashtu, mbizotëronte mendimi se ndonjëherë trashëgimia "kalon një brez", ose e thënë ndryshe transmetohet nga gjyshërit te nipërit dhe mbesat. Kur trashëgimia shfaqej në një brez që supozohej se ngjasonin me paraardhës pak a shumë të largët, u krijua koncepti i "atavizmit" ose "trashëgimia ataviste".

familjeje është i pranishëm një numër i madh kriminelësh, prostitutash dhe vagabondësh, të gjithë pasardhës të një babai kriminel[33].

Henry Goddard zhvilloi një studim të ngjashëm me familjen Kallikak. Ky studim ballafaqon historinë e dy degëzimeve familjare që rrjedhin nga i njëjti person me prejardhje nga një familje e mirë gjatë periudhës së luftës së pavarësisë amerikane. Degëzimi i parë vjen nga lidhja e tij me një bariste mendërisht e dobët dhe e paqëndrueshme, ndërsa degëzimi i dytë rrjedh nga lidhja e tij me një grua të pasur. Shumë nga pasardhësit e degëzimit të parë paraqesin sjellje devijuese dhe kriminale. Arriti në konkluzionin se paqëndrueshmëria mendore mund të jetë një shkak i trashëgueshëm i sjelljes kriminale[34].

Earnest Hooton, antropolog amerikan, studioi një numër të konsiderueshëm të burgosurish dhe qytetarësh të lirë. Nga vëzhgimet e tij dolën në pah probleme të intelektit, probleme fizike, probleme të moralit dhe gjenetike tek të burgosurit. Sipas këtij antropologu, ekziston një lidhje ndërmjet natyrës, kushteve mjedisore dhe krimit dhe për pasojë ky i fundit është rezultat i impaktit që ka mjedisi mbi qëniet njerëzore të natyrës inferiore[35].

Lee Robins zhvilloi studime për të shpjeguar lidhjen mes kriminalitetit të prindërve dhe kriminalitetit të fëmijëve. Në vitin 1975 së bashku me Patricia West dhe Barbara Herjanic zbuluan se fëmijët që kishin të dy prindërit kriminelë paraqesnin rrezikshmëri më të lartë për t'u bërë të tillë. Të gjitha studimet mbi familjet e ndryshme nxorrën në dukje si të vetmen lidhje atë të faktorëve ambientalë

[33] R. Dugdale, *The Jukes: A Study of Crime, Pauperism, Disease and Heredity*: Further studies of criminals, The Anicherbocher Press, New York and London, 1891.

[34] Shih, H. Goddard, *The Kallikak Family: A study in the heredity of feeble-mindedness*, The Macmillan Company, New York, 1913: https://ia800905.us.archive.org/17/items/kallikakfamilyst00godduoft/kallikakfamilyst00godduoft.pdf

[35] Shih, A. Bedoya, J. Portnoy, *Biosocial Criminology: History, Theory, Research Evidence, and Policy*, në Revistën "Victims & Offenders": An International Journal of Evidence-based Research, Policy, and Practice, botuar 16.11.2022. Earnest A. Hooton është një antropolog në Harvard dhe që u ndikua në studimet e tij kryesisht nga Lombroso. Studimi antropologjik i Hooton-it mbi të burgosurit ishte metodologjikisht i gabuar. Të dhënat u grumbulluan në mënyrë jokonsistente dhe ajo që u mblodh ishte e kontaminuar me opinionet dhe paragjykimet e stafit kërkimor. Duke përdorur të dhëna të mbledhura nga mbi 17.000 të burgosur, Hooton bëri një shtresëzim të kriminelëve sipas racës, kombësisë dhe përkatësisë etnike dhe zgjeroi idenë e Lombrosos për një "njeri kriminel". Sipas tij kur njerëzit me "gradë të ulët" ndikoheshin negativisht nga mjedisi i tyre, ata kryenin krim (Hooton, 1939). Kështu, mënyra e vetme për të çrrënjosur krimin ishte që këta individë të "gradës së ulët" ose të vdisnin nëpërmjet eutanazisë ose thjesht të mos lindnin nëpërmjet përdorimit të kontraceptivëve dhe sterilizimeve.

të pafavorshëm nën ndikimin e të cilëve ekspozoheshin fëmijët si edukimi dhe shpërbërja familjare[36].

## 4. Raca dhe kriminaliteti

Pa asnjë dyshim, ngjarja nxitëse e të gjitha krimeve kundër njerëzimit është "racizmi", i kuptuar si një refuzim i qëllimshëm për të njohur dinjitetin e të gjithë atyre që i përkasin "shtëpisë së përbashkët" njerëzore[37]. Hapi i parë, pak a shumë i vetëdijshëm, drejt diskriminimit racor konsiston në identifikimin e një nëngrupi etnik që konsiderohet si rrezikshmërisht i ndryshëm[38].

Një ndër autorët e parë që studioi lidhjen ndërmjet racës dhe kriminalitetit ishte Cesare Lombrozo[39]. Sipas tij, në Itali jetonin dy tipe italianësh: veriorët me origjinë ariano-nordike dhe jugorët që kishin prejardhje nga afrikanët me ngjyrë të zezë. Kjo shpjegonte edhe arsyen se pse jugorët ishin më të prirur për të shkelur rregullat.

Në vitin 1851, mjeku Samuel A. Cartwright filloi të studionte individë të ndryshëm afroamerikan, që tentonin të arratiseshin duke mos ju bindur pronarëve të tyre. Studimet treguan se skllevërit që tentonin të arratiseshin vuanin nga çrregullime mendore të përshkruara si sëmundje të "zezakëve" që tentonin të arratiseshin nga shoqëria në favor të ilegalitetit. Sipas këtij autori, pothuajse të gjithë njerëzit me ngjyrë vuanin nga këto sëmundje, përveç atyre që janë rritur dhe edukuar nga të bardhët[40].

---

[36] L. Robins, P. West, B. Herjanic, *Arrests and delinquency in two generations: A studi of black urban families and their children*, në Revistën "Journal of Child Psychology and Psychiatry", Vol. 16, Association for Child and Adolescent Mental Health, 1975, fq. 125-140.

[37] I. Merzagora, G. Travaini, P. Caruso, *Da Lombroso alla biocriminologia nazista, e speriamo a nient'altro*, në Revistën, "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume XII, N. 2, 2018.

[38] A. Baiguera Altieri, *Criminologia e diritti fondamentali dell'uomo,* në Revistën "Filodiritto", Bologna, 2023.

[39] Lombroso i kushtoi rëndësi edhe studimit të popullatës së jugut të Italisë dhe kalabrezëve në veçanti. Lombroso identifikon te kalabrezët tipat e popujve të lashtë, me kafkë të zgjatur, vetulla të bashkuara, hundë të lakuar, sy të zinj, ballë të lartë dhe të gjerë, hundë shqiponjë dhe sy të gjallë; përshkruan zakonet, higjienën dhe patologjitë e popullit kalabrez. Shih, O. Greco, *Matti del sud,* në Revistën "Giornale di storia", 29 (2019), https://www.giornaledistoria.net/.

[40] Christopher D. E. Willoughby, *Running Away from Drapetomania: Samuel A. Cartwright, Medicine, and Race in the Antebellum South,* në Revistën "Journal of Southern History", Volume 84, Nr.3, Southern Historical Association, 2018, fq. 579-614. Bob Eberly Myers II, *"Drapetomania": Rebellion, Defiance and Free Black Insanity in the Antebellum United States*; A dissertation submitted in partial satisfaction of the requirements for the degree Doctor of Philosophy in History University of California, Los Angeles, 2014.

Teoria e konflikteve kulturore është zhvilluar nga Shkolla e Çikagos dhe konkretisht nga Thorsten Sellin, sipas të cilit, përplasja mes sistemeve të ndryshme kulturore përbën shkakun kryesor të sjelljes deviante të emigrantëve, dhe në përgjithësi të të huajve[41]. Sipas Sellin, ky konflikt kulturor është më i dukshëm në zonat kufitare, në vendet e kolonizuara, atje ku ka emigrantë dhe pakica etnike[42]. Konfliktet kulturore ndahen në primar dhe sekondar. Konfliktet primare vijnë si pasojë e parehatisë që një individ jeton brenda vetes së vet si rezultat i konfliktit të vlerave. Konfliktet sekondare vijnë si pasojë e diskriminimit dhe përbuzjes së shoqërisë "mikpritëse" përkundrejt të huajve. Me këtë ndarje, Sellin kishte ndërmend diskriminimin racor që bëhej përkundrejt njerëzve me ngjyrë. Hetimet dhe studimet e tij u shtrinë në lidhjen ndërmjet etnisë dhe kriminalitetit dhe falë një studimi të tij, Sellin radhitet ndër të parët kriminologë që gjeti gjurmë të diskriminimit racor në sistemin e drejtësisë penale.

Këto teori, të shekullit XIX, nuk konsiderohen më nga pothuajse shumica e kriminologëve të sotëm.

[41] Thorsten Sellin, *Culture Conflict and Crime*, në Revistën "American Journal of Sociology", Vol. 44, Nr.1, The University of Chicago Press, 1938, 97-103.

[42] L. Goisis, *Giustizia penale e discriminazione sociale: Il soggetto "altro" dinanzi al diritto penale e alla criminologia - Atto I: Il contributo della criminologia*, Revista "Diritto Penale Contemporaneo", http://www.antoniocasella.eu/nume/Goisis_dpc_2012.pdf.

# KREU III

## TEORITË PSIKOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT

**PËRMBAJTJA**: 1. Kriminologjia klinike dhe personaliteti kriminal. – 2. Analiza kriminologjike e sjelljes kriminale. – 3. Kriminel për shkak të ndjenjës së fajit. – 4. Shpjegimi i veprimtarisë kriminale të vrasësit serial. – 5. Teoria e inferioritetit.

### 1. Kriminologjia klinike dhe analiza e personalitetit kriminal

Qënia njerëzore është një entitet i veçantë dhe i papërsëritshëm dhe për një shpjegim sa më të saktë të kriminalitetit është e rëndësishme të konsiderojmë personalitetin dhe faktorët të cilët ndikojnë në formimin e tij por edhe mjedisin në të cilin vepron ky personalitet[43]. Sjellja kriminale përfshin një sërë veprimesh që individi kryen në funksion të objektivave të tij dhe stimujve që ai merr nga ambienti i jashtëm. Përcaktimi dhe ekzaminimi i karakteristikave të personalitetit kriminal dhe identifikimi i rasteve psikopatologjike të lidhura sistematikisht me sjelljen kriminale rezultojnë të jenë burime të rëndësishme gjatë hetimeve, veçanërisht përballë rasteve të një natyre seriale apo edhe rasteve veçanërisht të dhunshme.

Termi "Personalitet" rrjedh nga fjala person dhe tregonte fillimisht maskën klasike të teatrit që aktori mbante në fytyrë dhe përmes së cilës fliste duke treguar një pamje të caktuar, ndërsa njeriu i vërtetë qëndronte i fshehur. Megjithatë, me kalimin e kohës, termi "personalitet" ka pësuar ndryshime në kuptim[44], duke treguar

---

[43] Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (1992), *personaliteti përbën një model të strukturuar të të menduarit, ndjenjave dhe sjelljes që karakterizon mënyrën e përshtatjes dhe stilin e jetesës së një subjekti, është rezultat i faktorëve të ndryshëm, zhvillimit dhe përvojës sociale*. Personaliteti paraqitet si një model kompleks i karakteristikave psikologjike dhe të sjelljes që shprehen pak a shumë konstante në të gjitha aspektet dhe kontekstet e funksionimit individual.

[44] Koncepti i personalitetit u përcaktua në psikologji vetëm në vitet 1930 por studimet mbi personalitetin janë po aq të vjetra sa reflektimi i njeriut mbi natyrën e tij si në fushën filozofike ashtu edhe në atë mjeko-fiziologjike. Për më tepër, është shumë e rrallë të gjesh teori ekskluzivisht psikologjike të personalitetit në antikitetin klasik greko-romak, si dhe në qytetërimet e mëdha joevropiane. Këto janë pothuajse gjithmonë teori që lidhin personalitetin e njeriut me ndërtimin e tij fizik, dhe kjo në shumicën e rasteve lidhet nga ana tjetër me një teori të

jo më maskën, por vetë aktorin, atë çfarë është një person në të vërtetë pavarësisht nga pamja apo maska që mund të mbajë. Personaliteti është objekt studimi i shkencës së psikologjisë e cila ka filluar të interesohet për këtë nocion duke filluar nga vitet '30 të shekullit të XX. Të përkufizosh personalitetin nuk është aspak e lehtë dhe pavarësisht ekzistencës së një numri të madh të përkufizimeve të personalitetit (psikologjik, filozofik, teologjik, ligjor, moral, biologjik), shumica e autorëve janë dakord të përshijnë në përkufizimin e personalitetit karakteristikat dalluese (njohëse) dhe afektive (të ndjeshme) që e shndërrojnë çdo njeri në një specie unike, të ndryshëm nga çdo njeri tjetër dhe që tregojnë atë që ai është në realitet[45].

Sipas mendimit tonë, personaliteti është një e panjohur e madhe që e shoqëron qënien njerëzore qysh prej krijimit të saj. Njerëzit janë të ndryshëm sepse kanë personalitete të ndryshme dhe në asnjë rast nuk mund të bëhen përgjithësime edhe pse studimet mbi personalitetin kanë prodhuar të dhëna të rëndësishme që hedhin dritë mbi njohjen e llojeve të caktuara të personalitetit. Ne nuk mendojmë se brenda personalitetit të çdo njeriu gjendet një pjesë e fshehur, normalisht e neutralizuar (ana e errët e personalitetit) dhe, që nëse do të lirohej, do të na transformonte në kriminelë, vrasës mizorë dhe keqbërës të rrezikshëm por jemi të mendimit se mënyra se si sillen njerëzit varet nga rrethanat shoqërore dhe gjendja psikologjike (impulse pasionale dhe emocione të forta). Personaliteti vepron i ndikuar nga faktorët e riskut dhe faktorët mbrojtës dhe në rrethana të caktuara kushdo mund të kryejë vepër penale duke shprehur impulset e veta antishoqërore[46]. Sjellja kriminale frenohet nga

---

bazuar mbi elementët primitivë që përbëjnë universin. Kështu, në traditën e Hipokratit ndarja e personalitetit në katër lloje, sanguin, melankolik, kolerik dhe flegmatik, lidhej me katër përbërësit themelorë të trupit: gjaku, lëngu i zi, lëngu i verdhë, sekrecionet dhe këto, nga ana tjetër, korrespondonin me katër elementët përbërës të universit, ajrin, tokën, zjarrin dhe ujin. Mbizotërimi e njërit prej këtyre përbërësve ndaj të tjerëve përcaktonte llojin e personalitetit të cilit i përkiste individi. Shih, R. Luccio, G. Rovera, *Personalità*, në "Enciclopedia online Treccani".

[45] Shih, P. Porcelli, *La valutazione scientifica della personalità: Evidenze empiriche e contesti ambientali*, në Revistën "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume X, Nr.2, 2016.

[46] Kriminaliteti i të miturve është një fenomen shumë kompleks që varet nga një mori faktorësh personalë, socialë, familjarë dhe mjedisorë të cilët kontribuojnë në rritjen ose uljen e mundësisë që një i mitur të thyejë rregullat shoqërore dhe penale dhe më pas të fillojë një karrierë devijuese. Me faktorë të riskut do të kuptojmë atë grup karakteristikash personale, sociale, familjare dhe mjedisore që mund të rrisin probabilitetin e shfaqjes së sjelljes antisociale apo edhe kriminale ndërsa me faktorë mbrojtës do të kuptojmë të gjithë ata elementë që zvogëlojnë probabilitetin që një njeri të kryejë veprime antisociale dhe devijuese. Shih, L. Columbu, A. Vargiu,

zbatimi i rregullave të edukatës familjare, të shkollës apo të besimit fetar dhe në rastet kur kemi të bëjmë me kryerjen e veprave penale mund të themi se arsyet frenuese kapërcehen nga emocionet, pasionet, vuajtjet dhe kënaqësia që provohet me kryerjen e krimit.

Në një rast të hershëm, të analizuar nga kriminologë (psikiatër) të rëndësishëm italian (Aldo Franchini dhe Domenico Macaggi), është arritur në përfundimin se çdo veprim, kriminal ose jokriminal, është rezultat i veprimit dhe i ndërthurjes së personalitetit dhe mjedisit në të cilin gjendet dhe vepron ky personalitet[47]. Në këtë rast bëhet fjalë për analizën e historisë kriminale të Giorgio Vizzardelli (G.V.), lindur në vitin 1922, i cili ishte fëmija i fundit i një familje me reputacion të mirë që kishte gjithsej gjashtë fëmijë. Babai ishte gjithmonë i përkushtuar ndaj punës dhe familjes (Drejtor i Zyrës së Regjistrimit), ndërsa nëna, mësuese e shkollës fillore, kishte vuajtur shumë në shtatzaninë e saj të fundit dhe kishte rrezikuar të vdiste pasi lindi G.V. për shkak të një hemorragjie, për të cilën që nga ajo kohë ajo nuk kishte mundur më të kthehej në punë dhe kishte mbetur e mbyllur në dhimbjet e saj. Vëllezërit e tjerë studionin dhe punonin. G.V. kishte pasur një fëmijëri mjaft të vështirë, për shkak të sëmundjeve të shumta infektive, imunitetit të dobët, vështirësive në rritje dhe paaftësisë së nënës së tij. Kishte një karakter disi të rezervuar dhe të turpshëm, frekuentonte gjithmonë shoqëri të mirë dhe konsiderohej i sjellshëm dhe i respektueshëm. Fatkeqësisht nuk pëlqente të studionte dhe gjithmonë kishte treguar pak interes për shkollën.

Në moshën 8 vjeçare, ndërsa ishte në shkollë në vendlindjen e tij, ai u terrorizua nga një tërmet i fuqishëm që shkaktoi vdekje të shumta. Pas kësaj ngjarje G.V. e kishte shprehur hapur refuzimin për të shkuar në shkollë. Mësuesi kishte filluar ta dhunonte sepse ishte pa dëshirë, i mbyllur në vetvete dhe mungonte shpesh në shkollë, nuk socializonte dhe nuk studionte ndërsa babai i tij ishte gjithmonë dakord

---

S. Redondo, *Comportamenti criminosi e fattori di rischio: un'applicazione del modello del triplo rischio delittuoso in un campione di studenti in Italia*, në Revistën "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume XII, Nr.2, 2018.

[47] T. Bandini, *Criminologia clinica tra passato e futuro*, në Revistën "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume XI, Nr.1, 2017.

me mësuesin dhe dhunës që mësuesi ushtronte në shkollë i shtonte dhunë edhe në shtëpi.

Midis moshës 13 dhe 14 vjeç, në adoleshencë G.V. dukej se u rrit shumë shpejt por ishte gjithnjë e më i shqetësuar dhe i pakënaqur; në shtëpi ishte vazhdimisht i trishtuar, i mbyllur në vetvete, i heshtur; shumë herë ka reaguar dhe ka shfaqur shpërthime zemërimi edhe ndaj të atit; tregohej tepër i ndjeshëm dhe reagues veçanërisht kur përballej me padrejtësi dhe mungesë vlerësimi. Në ato vite, pasi kuptoi se për të mbijetuar ndaj dhunës që përdorej ndaj tij do t'i duhej të mbështetej vetëm tek forcat e veta, filloi të frekuentonte një palestër sportive dhe brenda pak kohe u bë i fortë dhe atletik, mësoi të përdorte armët e zjarrit dhe pinte pije alkoolike për “ti dhënë vetes guximin që i mungonte”. Lexonte libra të Jack London, Tolstoit apo Dostojevskit dhe kishte admirim të madh për protagonistët e romaneve. Ëndërronte udhëtime, pasuri dhe aventura përrallore. Heroi dhe idhulli i tij u bë Al Capone të cilit i njihte shumë mirë historinë e jetës dhe krimet e kryera.

Në moshën 14 vjeçare babai e dërgoi për të studiuar në një shkollë fetare me qëllim që të nxiste tek i biri dëshirën për të studiuar.

Në moshën nga 15 deri në 17 vjeç ai kreu 5 vrasje (në vitet 1937, 1938 dhe 1939). Pasi u zbulua ne vitin 1939 u arrestua dhe pas disa ditësh marrje në pyetje, rezistencë dhe protesta, rrëfeu për të gjitha krimet e kryera dhe i përshkroi veprimet e tij në detajet më të vogla, që nga përgatitja e tyre, zbatimi dhe deri te përdorimi i çdo mjeti për të zhdukur çdo provë të mundshme.

Për krimin e parë të kryer në janar 1937, dy vrasje dhe tre tentativa (vrau Rektorin dhe portierin e shkollës dhe plagosi tre studentë), ai e justifikoi masakrën duke deklaruar se Rektori e kishte goditur para të gjithëve, qëllimisht, për ta poshtëruar dhe për të treguar fuqinë dhe epërsinë e tij. Në momentin e kryerjes së veprës penale ai kishte derdhur mbi të gjithë urrejtjen që kishte akumuluar ndaj shkollës dhe mësuesve, të cilët i konsideronte “vegla të vërteta torture”. Për këtë arsye G.V. kishte vendosur të reagonte në mënyrën më të përshtatshme, kishte llogaritur pasojat e aktit, kishte zgjedhur me kujdes vendin dhe kohën për t'i treguar

vetes se ishte “një njeri i guximshëm dhe i fortë”. Studentët dhe portierin i kishte qëlluar me qëllim që të mundte të largohej.

Pas këtij krimi të parë ai braktisi shkollën dhe për pasojë ndaj tij u përdor përsëri dhunë nga ana e të atit i cili e rrihte vazhdimisht. Nuk u kthye më në shkollë por i pëlqente shumë të fliste me ish-shokët e klasës duke shfaqur njëfarë admirimi për aftësinë e autorit të fakteve duke kërkuar të marrë konfirmim dhe siguri të mëtejshme për aftësitë e tij.

Për krimin e dytë (gusht '38) ai e justifikoi vrasjen e berberit si të vetmen mundësi për të hequr qafe një individ të neveritshëm, një shantazhues i fëlliqur që i kërkoi para për shkak se e kishte parë dhe e kishte njohur atë mbrëmje kur doli nga dera e përparme e shkollës pasi kishte kryer vrasjet. Për këtë arsye, pasi kishte paguar disa herë “gjobën”, e kishte joshur në një pritë, në një luginë të shkretë, dhe e kishte ekzekutuar. Gjithçka ishte përgatitur me detaje, edhe dy pistoletat që kishte sjellë me vete i kishte përdorur të dyja. Shoferin e makinës me qira që e kishte shoqëruar deri në atë vend e konsideronte si një viktimë të “pafajshme” i cili në çdo rast duhej eliminuar “për të përfunduar me sukses aksionin”.

Lidhur me krimin e fundit të dhjetorit 1939 (grabitja e Zyrës së Regjistrimit dhe vrasja e arkëtarit), G.V. raportoi se kishte ndërmarrë atë veprim i shtyrë nga nevoja për të pasur para të mjaftueshme sepse donte të emigronte në Amerikë. Kishte planifikuar paraprakisht çdo gjë në mënyrë të zgjuar dhe të detajuar por nuk kishte qenë në gjendje të parashikonte ardhjen e arkëtarit në mes të natës dhe se “ka qënë i detyruar” ta vrasë sepse është përshëndetur dhe njohur nga viktima. Edhe në këtë rast ai e konsideroi vdekjen e arkëtarit si një “pasojë të pakëndshme” edhe pse të nevojshme për të finalizuar veprimin e tij.

Vlerësimi psikiatrik zgjati disa muaj, intervistat psikodiagnostikuese kishin kohëzgjatje totale 20 orë, u intervistuan edhe prindërit, disa mësues, disa miq dhe të njohur. U kontrolluan shtëpia, papafingo dhe shkolla. Janë administruar katërmbëdhjetë teste ose pyetësorë të ndryshëm psikologjikë. Në veçanti, u përdorën teste të inteligjencës së përgjithshme/aftësive njohëse, vëmendjes/kujdesit, gjykimit moral, shkallës së seriozitetit të krimeve, rregullave dhe detyrave, fjalë të urta dhe

fjalë të lidhura. Janë analizuar ese të shkruara në klasë nga G.V. në shkollën 9 vjeçare dhe në gjimnaz.

Shqyrtimi i gjithë këtij materiali bëri të mundur rindërtimin e historisë së një djali i cili kishte vuajtur shumë në jetë, me një nënë në depresion, pa patur siguri dhe mirëkuptim nga askush, pa një përkëdhelje, pa asnjë shprehje afektive, pa një moment të gëzueshëm familjar, jetonte me një baba tradicional, shumë ndëshkues, shumë i zemëruar dhe shumë qortues; një djalë i cili në fëmijëri ishte shumë i dobët dhe shpesh herë i sëmurë, mjaft i mbyllur në vetvete dhe pa shumë fjalë, që nuk kishte gjetur kurrë njeri që ta dëgjonte; një djalë i cili ishte ndikuar së tepërmi nga tërmeti në moshën tetë vjeçare, që në mendjen e tij shfaqej si një formë dhune gjithnjë e pranishme, e papritur, e padrejtë dhe e ekzagjeruar; që nuk harronte tmerrin dhe ndjenjat e forta të turpit ndaj bashkëmoshatarëve për shkak të reagimeve të pakontrolluara të frikës (ulëritje, të qara, humbje të urinës); një djalë që për shkak të tërmetit urrente gjithnjë e më shumë shkollën dhe mësuesit dhe që nuk mund të duronte më dhunën poshtëruese dhe të pakuptueshme, si në shkollë ashtu edhe në shtëpi.

Gjatë marrjes në pyetje G.V. këmbëngulte se nuk kishte pasur kurrë arsye "vulgare" apo "të përgjakshme" që e shtynin të vepronte; sipas tij, në jetë nuk duhet t'i përkulemi dhunës pa shkak dhe nëse planifikojmë një veprim duhet ta kryejmë atë me guxim dhe racionalitet; G.V. mendonte se ishte bartës i një morali të ndryshëm dhe më të lartë se ai i dhunuesve të tij.

Lidhur me gabimet e bëra në krimin e fundit, gabime që kishin bërë të mundur identifikimin e tij, ai në një letër drejtuar ekspertit kriminolog shprehej: *"Edhe sikur të mos kisha kryer këtë krim të fundit, për të cilin u zbulova, nuk do të kisha jetuar si një qytetar normal... Nuk mendoj se do të kisha rezistuar gjatë duke punuar kamarier apo ndonjë punë tjetër të ndershme... do të më vinte lehtësisht një tjetër ide e parezistueshme për të kryer veprime të jashtëligjshme... më vinin si dallgë dhe nuk do të mundesha të përmbaja veten..."* ... *"Babai im më thoshte se të gjithë fëmijët që bëjnë krime të tmerrshme janë të çmendur... gjëra absurde bëhen nga njerëz të çmendur... madje mendoja se gjyqtarët do të më konsideronin të çmendur ...*

*ndonjëherë kam patur frikë se mos isha i çmendur, por çdo gjë më dukej racionale dhe asnjëherë nuk kam patur frikë nga dënimi, as në këtë jetë e as në një tjetër jetë*".

Këto akte ekspertimi e nxorrën plotësisht të përgjegjshëm dhe në përfundim të gjykimit dënohet me burgim të përjetshëm.

Në vitin 1948, në moshën 26 vjeçare, G.V. i nënshtrohet ekzaminimeve të reja, për qëllime kërkimore shkencore, përgjatë të cilave shfaqet krejtësisht i qetë, fillimisht pak i mbyllur, por i sjellshëm dhe gjithnjë e më bashkëpunues kur intervistohej. Në këtë fazë të jetës në burg ishte ndërgjegjësuar për vështirësitë që kishte kaluar dhe gabimet që kishte bërë dhe për pasojë mendonte vetëm për lirinë, si të çlirohej, si të jetonte një jetë aktive dhe të pavarur. Kur ishte minoren, ai i konsideronte krimet e tij si "vepra të përsosura", ndërsa tani në moshën 26-vjeçare kupton se veprimet e tij kishin qenë "të pamatura dhe plot gabime".

Në burg studionte me pasion, pikërisht ai që e urrente shkollën kur ishte i vogël. Kishte mësuar shumë mirë gjuhën angleze dhe lexonte Shekspirin në gjuhën origjinale. Duke lexuar ai përpiqej të kuptonte personalitetin e tij edhe pse kjo dukej shumë e vështirë; me kulturë dhe qetësi u përpoq të konkurronte me të burgosurit e tjerë, të cilët ishin më ekspertë se ai në çështjet e jetës, seksit, dashurisë; vazhdonte të tërhiqej nga jeta e heronjve, gjenive, njerëzve të jashtëzakonshëm që do të donte ti imitonte. Vetëm krimet e kishin lejuar të ndihej i aftë, i fortë, i frikshëm, i respektuar; vetëm me krime kishte arritur të shpëtonte nga jeta e mëparshme, monotone dhe melankolike, tepër e kufizuar dhe pa asnjë horizont të pranueshëm.

Në këtë fazë të dytë u analizuan edhe 172 letrat që ai u shkruante familjarëve dhe që merrte prej tyre. Nga kjo analizë u vu re një ndryshim në sferën e emocioneve dhe afekteve dhe kjo dukej në mënyrën e të shkruarit të letrave, pasi, nëse në fillim G.V. tregohej i ftohtë me familjarët e tij, vitet e fundit ishte më i dashur, më i hapur, tepër komunikues dhe i respektueshëm.

Sipas ekspertëve, pasioni për studimin dhe leximin ishte faktori kryesor për këtë ndryshim të rëndësishëm të mendimeve dhe veprimeve të G.V. Ata vunë re se si një djalë i mbyllur, i heshtur, emocionalisht i brishtë, mjaft i izoluar kishte ndryshuar ndjeshëm në emocionet dhe afektet e tij.

Në vitin 1957, Drejtori i burgut bëri kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë për faljen e dënimit dhe për këtë arsye ndaj G.V. u ndërmorën një sërë ekspertizash të reja për të vlerësuar gjendjen dhe rrezikshmërinë shoqërore të tij. Për këtë arsye, G.V. u transferua në një spital psikiatrik dhe qëndroi në pritje të vendimit deri në vitin 1968, kur në moshën 46 vjeçare përfitoi nga falja e dënimit. U lirua nga burgu dhe u vendos në "provë" për 5 vjet.

Kur u kthye në shtëpi e priste një motër të cilës i kishte vdekur bashkëshorti dhe filloi të jetonte me të. Në atë kohë, teksa shkonte në polici për të firmosur prezencën e tij, u pikas dhe u njoh në rrugë nga disa qytetarë. Dikush protestoi për lirimin e tij dhe shtypi vendas u rebelua: "*është kthyer përbindëshi... jemi të gjithë në rrezik*". Pasi mësoi për gjendjen e frikës dhe pakënaqësinë e qytetarëve, G.V. qëndroi i mbyllur në shtëpi pesë vitet e fundit të "provës".

Motra me të cilën ai ishte kthyer për të jetuar i shkruante ekspertit kriminolog që e mbikqyrte: "*ditët kur shtypi përhapi lajmin e daljes së tij nga burgu dhe rikthimit në liri ishin të tmerrshme dhe fatkeqësisht shkaktuan te Giorgio gjendje ankthi, mosbesimi dhe pasigurie që e bënë atë të tërhiqej dhe mbyllej përsëri në vetvete… shqetësimi i tij i vetëm është të izolohet për të mos qenë barrë… Kam shumë frikë, i dashur profesor, se falja ka ardhur shumë vonë*".

Në moshën 51-vjeçare, në vitin 1973, ditën që i thanë se më në fund ishte një njeri plotësisht i lirë, se kishte përfunduar vuajtjen e dënimit, se mund të dilte kur të donte nga ajo shtëpi, vrau veten, duke i prerë damarët e kyçeve dhe gushën, pa shqetësuar askënd, duke lënë gjithçka të pastër dhe të rregullt, duke i kërkuar sërish falje në një shënim motrës së tij për atë shqetësim të fundit.

Në një letër të fundit drejtuar ekspertit kriminolog, pak ditë pas vetëvrasjes së G.V., motra e tij shkruante: "*Ende nuk mund ta besoj atë që ndodhi, edhe pse e kuptoj se një tragjedi e këtyre përmasave nuk mund të kishte tjetër përfundim… Giorgio ma la mua vuajtjen e tij të cilën e përballoi me dinjitet dhe në heshtje. Përsa të jem gjallë do të kem para meje vizionin e vdekjes së tij mizore shoqëruar me dhimbjen e thellë se nuk munda të bëja asgjë për ta ndihmuar. Ditën që vdiq, dhoma e tij ishte përsosmërisht e rregullt dhe librat e tij, të ruajtur më së miri, ishin*

*pastruar dhe vendosur në raft. Rrobat e tij të pakta ishin të lara dhe të vendosura me rregull. Madje, ai kishte menduar të lajmëronte edhe shitësen e qumështit që të mos sillte qumësht, ushqimin e tij të përditshëm, për të nesërmen. Nuk bëri as zhurmën më të vogël aq sa unë, në një distancë që një mur i hollë na ndante, nuk vura re asgjë, nuk dëgjova asgjë. Ai erdhi në heshtje, pesë vjet më parë, dhe u largua në heshtje, pa shqetësuar askënd. Ai nuk la asnjë gjurmë nga shkrimet e tij të shumta të kohëve të fundit. Kjo është e gjitha*".

Edhe nga analiza e këtij rasti vëmë re se midis personalitetit dhe mjedisit në të cilin vepron ky personalitet ekziston një proces ndërveprimi. E rëndësishme është të studiohet se cili nga këto elemente ka ndikimin më të madh dhe si kombinohen ato me njëri-tjerin duke çuar në kryerjen e veprës penale. Kur flasim për profilizimin e një personi, i referohemi teknikave psikologjike që përpiqen të identifikojnë personin që ka kryer krimin bazuar në natyrën e vetë autorit dhe mënyrën se si ai e ka kryer krimin[48]. Në fakt, çdo zgjedhje e bërë nga një kriminel mund të jetë në përputhje me personalitetin e tij. Prandaj, është e mundur, edhe në mungesë të elementëve, nëpërmjet të ashtuquajturit profilizim, të njohim personalitetin e autorit të veprës penale, për shembull, përmes analizës së vendit të ngjarjes, deklaratave të dëshmitarëve dhe shumë elementëve të tjerë[49]. Kriminologjia është e interesuar të studiojë personalitetin e personit, autor i veprës penale, në çastin e marrjes së vendimit (kriminogjeneza) dhe të kryerjes së veprës penale (kalimi në veprim/

---

[48] Profilizimi kriminal është regjistrimi dhe analiza e karakteristikave psikologjike dhe të sjelljes së një personi, në mënyrë që të vlerësohen ose parashikohen aftësitë e tij në një sferë të caktuar ose për të ndihmuar në identifikimin e një nëngrupi të caktuar njerëzish. Ky lloj profilizimi, zakonisht, përdoret në rastin e krimeve ku identiteti i autorit është i panjohur apo edhe në rastet e krimeve të rënda si vrasja ose përdhunimi. Shih, F. Itulua-Abumere, *How effective is criminal profiling*?, Roehampton University, London, 2014.

[49] Sidomos në gjykimet për çështjet penitenciare, prania e ekspertëve ofron një specializim më të madh të trupit gjykues për të qenë në gjendje të bëjë gjykimet e nevojshme teknike dhe shkencore mbi personalitetin e personit të dënuar dhe për vlerësimin e rrezikshmërisë shoqërore që janë janë të rëndësishme për të realizuar trajtimin riedukues dhe për rrjedhojë zbatimin e masave alternative dhe përfitime të tjera. Kriminologjia dhe shkencat e tjera humane i vënë në dispozicion gjykatës aftësitë dhe njohuritë e tyre për ta lejuar atë të identifikojë të gjithë elementët e dobishëm për qëllimet e vlerësimit, të kuptojë më mirë disa informacione të marra dhe të japë vendime që marrin parasysh jo vetëm aspektet juridike të çështjes konkrete por edhe aspekte që kanë të bëjnë me personalitetin dhe evolucionin e tij gjatë ekzekutimit të vendimit (edhe pse gjithmonë duke u nisur nga fakti i krimit të kryer). Shih, E. Mariani, *Idoneità trattamentale e valutazione della pericolosità sociale: l'Esperto componente presso il Tribunale di Sorveglianza*, në Revistën "Diritto Penale Contemporaneo", 2014, Il contributo della criminologia al sistema penale: Alla ricerca del nuovo "volto" della pena. Atti dell'incontro di studio in ricordo del Prof. Ernesto Calvanese, a cura di Raffaele Bianchetti, Evento organizzato e promosso dal Dipartimento di Scienze giuridiche "Cesare Beccaria", Università degli Studi di Milano.

kriminodinamika) dhe të studiojë faktorët që ndikojnë në formimin e personalitetit të autorit të veprës penale.

Sipas Samuel Yochelson dhe Stanton E. Samenow, tiparet e personalitetit kriminal, në realitet, janë prezente edhe pse në forma të zbutura, tek pothuajse të gjitha qëniet njerëzore. Truri i kriminelit posedon në përgjithësi një energji të madhe dhe paraqet këto karakteristika: lehtësi në eksitim; fantazi të dominimit të pushtetit dhe të triunfit; frikë e madhe dhe e vazhdueshme; dyshim. Një kusht tjetër tipik i mendimit kriminal është i lidhur me ekzistencën e "gjendjes zero", përgjatë së cilës tek individi vërehet një vetëvlerësim i dobët dhe një gjendje dëshpërimi të lidhura me ndjenjën e mëndjemadhësisë dhe të kërkimit të ethshem të pushtetit. Bashkimi i këtyre faktorëve do të ishte në gjendje të shtynte disa kriminelë drejt kërkimit të dominimit dhe të ilegjitimitetit[50].

Marc Le Blanc dhe Marcel Frechette kanë përcaktuar një sindromë të personalitetit kriminal, që përfaqësohet nga një strukturë psikologjike specifike, e cila tek disa individë mbivendoset me struktura të tjera të personalitetit duke favorizuar veprimin e jashtëm (*acting out*). Kjo sindromë përfshin tre tipare: iperaktivitetin kriminal, mos-shoqërimin dhe një egocentrizëm të theksuar. Këta autorë pohojnë se tek individët me profilit të lartë kriminal, faktorët socialë dhe mjedisorë e ndikojnë sjelljen kriminale, por duke qenë gjithmonë të varur nga tiparet e sindromës së personalitetit kriminal[51].

Sipas mendimit tonë, përballë kompleksitetit të njohjes së personalitetit, është iluzore të mendohet se mund të ketë një mënyrë të pagabueshme që mund të vlerësojë ndërveprimin e faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në formimin e personalitetit. Për më tepër, përveç kompleksitetit të përcaktimit dhe njohjes së personalitetit, është thelbësore përzgjedhja e profesionistit që do të realizojë njohjen dhe vlerësimin e personalitetit. Pavarësisht nga përmbajtja dhe fusha specifike në të cilën zbatohet, njohja e personalitetit (diagnoza psikologjike) ka nevojë për

[50] S. Yochelson, S. Samenow, *The criminal personality: A profile for change*, Volume I, A Jason Aronson Book, Lanham, 1976.

[51] S. Mattiello, *Analisi teorica del concetto di personalità criminale*, në Revistën "Rivista di Psicodinamica Criminale", Anno II – n.1, Gea Mater Padova Onlus, Padova, 2009.

ekzistencën e tre elementëve të lidhur ngushtë njëri me tjetrin: gjendja klinike, aftësia e profesionistit që do të merret me njohjen e personalitetit dhe mënyra e formimit të personalitetit.

## 2. Analiza kriminologjike e sjelljes kriminale

Analiza e sjelljes kriminale ndihmon jo vetëm gjyqtarin për të kuptuar rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit por ndihmon më së shumti edhe kriminologun për arsye të studimeve shkencore dhe të marrjes së masave të nevojshme për të kuptuar dhe parandaluar sjellje të caktuara kriminale.

Etienne De Greeff është një nga studiuesit e parë që vuri në dukje lidhjen ndërmjet personalitetit dhe krimit: pas një vëzhgimi klinik të kujdesshëm mbi disa të burgosur, arriti të zhvillonte disa faza të veçanta që karakterizojnë sjelljen kriminale: Faza e parë është kriminogjeneza ose lindja e idesë për të kryer krimin: sipas tij kriminogjeneza ndryshon nga “heshtja emocionale” që vjen nga bindja e keqbërësit se ndaj tij është kryer një padrejtësi; Faza e dytë është kriminodinamika ose mënyra e kryerjes së krimit, që shpjegon sjelljen kriminale duke paraqitur konceptin “gjendje e rrezikshme”, fazë e ekuilibrit mendor të paqëndrueshëm që paraprin ekzekutimin e një krimi: De Greeff sqaron edhe konceptin e “kalimit ne akt”, fazë në të cilën situata rëndohet dhe vjen si pasojë ekzekutimi i krimit[52]. Duke analizuar kriminodinamikën e krimit të vrasjes, De Greeff identifikon tre faza që paraprijnë kryerjen e krimit: pëlqim i zbutur, në këtë fazë mund të vihen re disa sinjale që paraprijnë sjelljen kriminale; pëlqim i përcaktuar, në këtë fazë vihen re sjellje të jashtëligjshme, sulme verbale ose mosveprime; periudha e krizave, në këtë fazë individi ndërgjegjësohet për nevojën e kalimit në kryerjen e aktit dhe hyn në “gjendjen e rrezikshme” që do ta shpjeri në kriminalitet. Sipas De Greeff, kalimi në aktin kriminal bëhet i mundur nga një proces i shkëputjes emocionale që e distancon autorin nga të tjerët dhe, në veçanti, nga lidhja emocionale me viktimat e tij. Ai

[52] D. Casoni, L. Brunet, *La Psychocriminologie: Apports psychanalytiques et applications cliniques*, Presses de l’Université de Montréal, Montréal, 2003.

vëren se ky proces i shkëputjes emocionale është zakonisht kronik dhe i qëndrueshëm. Megjithatë, ndodh që procesi i shkëputjes të mos ekzistojë më dhe gjendja emocionale që i hapi rrugën veprës kriminale zbehet[53]. De Greeff jep shembullin e një burri që vuri re, rreth shtatë vjet pas vrasjes gjakftohtë të gruas së tij, se ai ishte larguar gradualisht nga personaliteti i tij i mëparshëm, domethënë nga ai që e karakterizonte përpara se të fillonte të mendonte për të kryer vrasjen. Ai e dëshmon kështu: "*Tani e kuptoj se pak nga pak isha bërë indiferent ndaj çdo gjëje, se fyerjet më të mëdha më lanë të ftohtë, se lumturia apo fatkeqësia ishin të huaja për mua dhe se jeta nuk më thoshte më asgjë. E them këtë tani sepse e rigjeta veten por derisa u bëra përsëri vetvetja, nuk e kuptova se isha ndryshuar*"

Arsyetimi i mësipërm reflektohet edhe në mendimet e autorëve të veprave penale të intervistuar nga studiuesit e mëvonshëm me qëllim që të zbardhin gjendjen emocionale dhe të hedhin dritë mbi arsyet e kryerjes së krimit të vrasjes[54].

Një i ri 27-vjeçar qëllon me thikë për vdekje shokun që i "vodhi" të dashurën dhe më pas vret me çifte ish-të dashurën e cila e braktisi. Në lidhje me vrasjen e shokut të tij, ai shprehet shumë i ngarkuar emocionalisht dhe duke shoqëruar rrëfimin e tij me gjeste të ndryshme thotë: "*nuk duhej të më kishte vjedhur gruan, si e bëri... dhe pastaj duhej të më paralajmëronte, nuk më tha asgjë... kam dëgjuar për këtë gjë nga thashethemet në qytet... ai tradhtoi besimin tim, ai tradhtoi miqësinë*

---

[53] G. Tănăsescu, *Criminological and Philosophical Explanations for the Formation of Homicidal Ideation and the Role of Serotonin (5-HT) in Controlling Aggressive Behavior*, në RAIS - Research Association for Interdisciplinary Studies, 2020. Idetë vrasëse përkufizohen nga prania e mendimeve për kryerjen e një akti të dhunshëm vdekjeprurës kundër objektivave specifike (të identifikueshme) ose jo specifike (me karakter të përgjithshëm), pavarësisht nëse vrasja është kryer (përfunduar me vdekjen e viktimës), ka mbetur në tentativë ose është në fazën përgatitore. Etienne De Greeff në Librin "Hyrje në Kriminologji" prezantoi procesin kriminogjen (fazat me të cilat kryhet vepra penale) dhe deklaroi se personaliteti i njeriut nuk mund të njihet kurrë plotësisht nga përfundimi i veprës penale që ka kryer por vetëm një pjesë e personalitetit të tij mund të përshkruhet nga ngjarja kriminale (De Greeff 1946). Qëndrimi i brendshëm që drejton këto akte absolute nuk është në përputhje të plotë me manifestimin e tyre të jashtëm. Qëndrimi përshkruan psikikën nga e cila buron (De Greeff 1946).

[54] Shih, G. Nivoli, L. Lorettu, A. Nivoli, F. Nivoli, *Le reazioni emotive al colloquio con l'omicida*, në Revistën "Rasegna Italiana di Criminologia", Volume I, n.1, 2007. Kur një vrasës rrëfen krimin e tij, veçanërisht nëse jep detaje reale dhe specifike, dëgjuesi mund të ketë përshtypjen se po përjeton mizoritë e kryera ndaj viktimës, duke dëgjuar thirrjet e tij të dëshpëruara për ndihmë, për mëshirë, duke parë masakrimin e trupit të tij. Është sikur dëgjuesi zbret së bashku me vrasësin në një botë skëterrë, të dominuar ekskluzivisht nga dhuna. Në këtë kuptim, dëgjuesit i tregohen dhe mbi të gjitha i ilustrohen në detaje, mizori që nuk do t'i kishte imagjinuar, që nuk do të gjente fjalët për t'i përshkruar, që nuk do të kishte dashur t'i dinte dhe aq më pak që do të kishte dashur t'i përjetonte. Përballë një dhune të tillë "të përplasur në fytyrë me forcën e të vërtetës", bashkëbiseduesi mund të zbatojë një sërë mekanizmash mbrojtës psikologjikë për të shmangur ankthet dhe konfliktet e dhimbshme personale, duke u munduar "të ndryshojë të vërtetat e rastit klinik".

*time*”. Për vrasjen e të dashurës ai shprehet gjithmonë me emocione të forta dhe shprehje fytyre që e tregojnë të acaruar: “*edhe ajo më tradhtoi besimin, shpresat i kisha mbështetur tek ajo grua dhe as ajo nuk më tha asgjë... doli fshehurazi me shokun tim... u tall me mua... më poshtëroi... më përçmoi para të gjithëve, më çmendi...*”. I pyetur për të shprehur mendimet e tij për pasojat e vdekjes së shokut të tij, vrasësi i habitur sikur nuk e priste pyetjen thotë me qetësi: “*sigurisht që nuk duhet të vrasim njerëz, më vjen keq që e kam bërë…*”. I pyetur se çfarë mendonte për familjen e të dashurës, vrasësi edhe në këtë rast pas një mimike që tregonte befasi, sikur të ishte një pyetje e papritur, e paparashikuar dhe mbi të gjitha e panevojshme, shprehet me një qetësi absolute: “*edhe për familjen e saj më vjen keq…*”. Në bisedat e shumta që vijojnë, vrasësi nuk shfaq asnjë ndjenjë pendese apo dëshirë për të riparuar pasojat negative të kësaj vrasjeje të dyfishtë.

Në një rast tjetër, vrasësi 31-vjeçar, në përshkrimin e motiveve që e çuan në krim, është tepër i paqartë përse e kreu sjelljen kriminale dhe alternativa sjelljesh shumë të ndryshme kanë të njëjtën vlerë emocionale për të: kështu për shembull për këtë vrasës, vrasja e të dashurës së tij ose vetëvrasja e tij konsiderohen zgjidhje ekuivalente: “*…nuk e di pse e vrava gruan time…, ajo më tha se donte të më linte… dhe pastaj mendova, tani ulem në gjunjë dhe e lus të mos më lërë; pastaj mendova, je njeri jo i mirë që më mashtrove dhe unë jam i lumtur që po më lë sepse do jetoj i lumtur..., pastaj mendova edhe se fajin për këtë e kisha unë... në fund të fundit, unë kam qenë gjithmonë në burg, nuk kam bërë asnjëherë asgjë të mirë, siç thoshte edhe nëna ime, më në fund mendova se të gjithë më lënë, të gjithë më braktisin se kanë të drejtë, s'kam vlerë, jam i kotë, jam një dështim dhe kështu do të jetë përgjithmonë... ndoshta është më mirë nëse ajo më vret, kështu që unë ndaloj së vuajturi vetë dhe ndaloj së bëri të tjerët të vuajnë. Pas gjithë këtyre mendimeve, megjithatë, mora thikën dhe i preva fytin..., nuk e di pse ia preva fytin..., në atë moment shumë gjëra po më kalonin në kokë dhe nuk e di pse. I preva fytin. Mund t'i kërkoja falje, mund të filloja të qaja, mund t'i lutesha të kthehej të jetonte me mua, mund të vrisja veten..., në atë moment të gjitha ato zgjidhje më dukeshin e njëjta gjë*”.

Rasti i mëposhtëm tregon historinë e një vrasësi 27-vjeçar që vrau një vajzë 16-vjeçare, i cili gjatë tregimit të aktit barbar insiston veçanërisht në detajet e tmerrshme të mekanikës së ekzekutimit: "*unë u përpoqa ta vrisja duke ia shtrënguar fytin me duar… ndërkohë ajo më shikonte e frikësuar… i përplasa kokën pas murit dhe ndjeva se kockat e kafkës së saj thyheshin nga përplasja me tullat e murit, por ajo nuk donte të vdiste..., ajo vazhdonte të merrte frymë... e hodha në tokë, e shkela dhe me gju, ia shtypa fytin me gjithë peshën e trupit, më shumë se 85 kilogramë, gjurin e kisha në fytin e saj... truri dhe gjaku i saj ishin përhapur gjithandej nëpër dysheme, nëpër shishe, në këmishën, pantallonat dhe në duart e mia... dukej se ai gjak nuk do të pushonte asnjëherë së rrjedhuri... mbaj mend se në fytyrën e saj mbizotërronte një frikë e madhe... ose më mirë në sytë e saj...*".

Analiza kriminologjike e sjelljes kriminale synon të realizojë "prognozën e krimit", njohjen e personalitetit të autorit të veprës penale dhe përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të tij; me fjalë të tjera, përcaktohen mundësitë që ka personi për të kryer krime në të ardhmen. Për realizimin e këtij qëllimi, kriminologu duhet të veprojë duke përdorur kriteret e objektivitetit dhe neutralitetit etik[55]. Objektiviteti do të thotë që përfundimet e arritura si rezultat i hetimit dhe kërkimit janë të pavarura nga raca, besimi, profesioni, kombësia, feja, preferencat morale dhe prirjet politike të studiuesit, edhe nëse ky lloj objektiviteti është i vështirë të arrihet në mënyrë të përsosur sepse studiuesi duhet të bëjë llogaritë jo vetëm me paragjykimet shoqërore por edhe me paragjykimet e personalitetit të tij. Neutraliteti etik do të thotë që shkencëtari në rolin e tij profesional nuk mban anën e askujt në çështje me rëndësi morale apo etike. Shkencëtari si i tillë nuk ka parapëlqime etike, fetare, politike, letrare, filozofike, morale; nëse ai ka preferenca si qytetar nuk duhet ti mbajë parasysh nëse vepron si shkencëtar. Si i tillë, ai nuk interesohet për atë që është e drejtë apo e gabuar, e mirë apo e keqe, por vetëm për atë që është e vërtetë apo e rreme.

---

[55] Në përdorimin e metodave kriminologjike është e nevojshme të mbahen parasysh dy parime bazë: objektiviteti i studimit dhe respektimi i etikës nga ana e studiuesit … Ndryshe nga shkencat natyrore, kriminologjia studion sjelljen kriminale, personin që kryen krimin, viktimën e krimit, sistemin e drejtësisë penale dhe raportet e këtij të fundit me njerëzit. Shih, V. Hysi, *Kriminologjia*, Kristalina-KH, Tiranë, 2010, fq. 39.

Në vëzhgimin shkencor të personaliteteve kriminologu duhet të bëjë dallimin ndërmjet: shkelësit të rregullave shoqërore (devijanti) nga shkelësi i rregullave penale (krimineli); shkelësit (devijant apo kriminel) të rastit nga ai patologjik; të paraburgosurit (në pritje të gjykimit ose jo) nga autori i përcaktuar i veprës penale (i dënuari). Analiza kriminologjike e sjelljes kriminale duhet të fokusohet, fillimisht, në përcaktimin e çështjeve diagnostikuese (të kriminogjenezës dhe kriminodinamikës) duke parashikuar sjelljen e ardhshme të të mbikqyrurit dhe në fund duhet të përcaktojë trajtimin e tij kriminologjik duke synuar risocializimin: e thënë me fjalë të tjera, të ringjallë tek një shkelës i rregullave (i burgosur apo edhe devijant) dëshirën për të qenë pjesë e shoqërisë dhe, dalëngadalë, ta bëjë atë të pranojë ose tolerojë këndvështrimin e një personi tjetër[56]. Në përcaktimin e qëllimit të risocializimit, kriminologu ndryshon nga psikologu apo psikiatri ose profesionistët e tjerë që studiojnë psikikën. Detyra sociale – profesionale e psikiatrit është të merret me parandalimin dhe trajtimin e patologjisë, ai i psikologut është parandalimi, ndërsa psikoterapeuti për trajtimin e të sëmurëve shpirtërorë, të gjitha të rëndësishme por të pamjaftueshme për të kuptuar krimin[57]. Kjo nuk do të thotë të mohohet rëndësia e rolit të psikoanalistit, psikoterapeutit apo psikiatrit, të cilët mund dhe duhet të bashkëpunojnë së bashku me kriminologun por duhet pasur gjithmonë parasysh se natyra e intervistës kriminologjike është e ndryshme nga ajo terapeutike apo psikiatrike pasi në këtë rast të fundit nuk kemi një pacient që kërkon të mjekohet apo ndihmohet por është Shteti që i kërkon kriminologut klinik të vëzhgojë në mënyrë shkencore personalitetin e të burgosurit. Për më tepër, terapia (psikologjike) ose trajtimi (psikiatrik) synon gjithmonë “shërimin” e pacientit kur është e mundur

---

[56] Analiza e sjelljes kriminale synon të kuptojë ndryshimet e mundshme në sjelljen kriminale. Ajo zbaton teoritë e përgjithshme psikologjike të sjelljes njerëzore në sjelljen kriminale dhe përshkruan mënyrën se si njerëzit që angazhohen në veprime të paligjshme dallohen nga ata që nuk angazhohen në to. Identifikimi i këtyre korrelacioneve në nivel individual të sjelljes kriminale mund të përdoret më pas për të parashikuar se kush do të ketë më shumë gjasë të jetë përsëritës i veprimeve kriminale në të ardhmen dhe kush do të ketë më pak gjasë. Shih, P. Smith, *Psikologjia e sjelljes kriminale*, në AA. VV. (grup autorësh), Teoritë në kriminologji, redaktuar nga Francis T. Cullen dhe Pamela Wilcox, Oxford University Press 2013, Botimi në gjuhën shqipe nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2023, fq. 75.

[57] F. Baldoni, B. Baldaro, C. Ravasini, *Il colloquio clinico*, në *Introduzione alla clinica psicologica*, a cura di Trombini G., Zanichelli, Bologna, 1994, fq. 103-126; R. Berrini, *La collaborazione psichiatra/psicologo sulla gestione integrata dei casi in psicoterapia individuale*, në Revistën “Rivista semestrale di psicologia e psicoterapia individuale sistemica al tempo della complessità”, Nr. 03, Anno II, 2021.

të bëhet një gjë e tillë por, duhet mbajtur parasysh se, gjatë terapisë ose trajtimit është pacienti ai që spontanisht i nënshtrohet dhe pret rezultate duke u angazhuar ai vetë në radhë të parë për të ndjekur terapinë: nga ana tjetër, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, i burgosuri nuk kërkon asnjë terapi ose trajtim dhe intervista kriminologjike, për qëllime trajtimi, ose imponohet ose sugjerohet por nuk zgjidhet me iniciativën e tij, (siç ndodh kur i drejtohet psikologut ose psikiatrit) [58].

Gjithashtu, duhet të mbajmë parasysh se hetimi (diagnoza dhe prognoza) i kriminologut është i natyrës kriminologjike dhe intervista që zhvillohet në këtë aspekt është për qëllime vlerësimi dhe kjo është e ndryshme nga akti i ekspertimit i urdhëruar nga gjykata, pasi ky akt ka rëndësi për të përcaktuar shkallën e përgjegjshmërisë, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale dhe zbatimin apo jo ndaj tij të masave të caktuara penale; llojin e masës që preferohet të merret; përcaktimin e sigurisë në të cilën do të vuhet dënimi; dhe, në përgjithësi, gjatë këtij akti ekspertimi bëhen pyetje të ndryshme që gjykata i konsideron të dobishme dhe të mundshme për t'u bërë[59]. Sipas një mendimi doktrinar, intervista kriminologjike është një teknikë komunikimi që zhvillohet në një situatë institucionale dhe ka si paraardhës faktin që i intervistuari ka kryer një krim. Kjo intervistë ka për qëllim të informojë personat përgjegjës mbi personalitetin e të intervistuarit në lidhje me gjenezën dhe dinamikën e krimit, të tregojë të dhëna të rëndësishme për trajtimin e tij dhe parashikimin e sjelljes së ardhshme[60].

Sipas mendimit tonë, analiza kriminologjike e sjelljes kriminale duhet të merret me: hetimin se përse subjekti kriminal është dorëzuar ndaj shkaqeve (faktorëve) që kanë vepruar mbi të; përcaktimin se përse arsye të tjera (sociale, individuale, morale, fetare, juridike, etj.) nuk e kanë penguar; kërkimin se përse subjekti arriti të kuptojë se kryerja e sjelljes së jashtëligjshme do ti sillte si përfitim përmbushjen e interesave të tij; me njohjen se si ka qenë përgatitja dhe ekzekutimi i krimit; studimin e sjelljes

---

[58] G. Nivoli, L. Lorettu, P. Milia, A. Nivoli, L. F. Nivoli, *Il colloquio con il detenuto: aspetti antropologici*, në Revistën "Psichiatria e Carcere", N. 1, 2006, fq. 97-110.
[59] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Nenet 178-186, Seksioni VI, Ekspertimi.
[60] I. Merzagora, *Il colloquio criminologico*, Unicopli, Milano, 1987, në Concetta Macri, Criminologia applicata, https://www.estudiocriminal.eu/wp-content/uploads/2017/03/Criminologia-Applicata-di-Concetta-Macri.pdf.

për të përcaktuar se si personaliteti i njeriut reagon ndaj stimujve të ndryshëm dhe në kushte të ndryshme[61].

## 3. Kriminel për shkak të ndjenjës së fajit

Sipas Freud, sjellja kriminale mund të jetë rezultat i punës së ndërgjegjes së lartë, e cila shkakton një ndjenjë faji të fuqishme. Mund të ndodhë që ndjenja e fajit të ekzistojë përpara kryerjes së krimit: në këtë rast ky i fundit nuk është rezultat i ndjenjës së fajit por është motivi që ka shkaktuar këtë ndjenjë. Sipas teorisë psikoanalitike[62], delikuenti duhet kuptuar si një individ me probleme nervore tek i cili në ndryshim nga "njeriu moral", "mbizotëron faktori i pandërgjegjshëm" që për

[61] Të dhënat që mund të merren nga analiza kriminologjike e sjelljes kriminale mund të jenë: Data dhe vendi i lindjes (lindja dhe shkëputja e fëmijës); Normaliteti, parakohshmëria ose vonesa në zhvillim, fazat e hershme të jetës fiziologjike (e folura, ecja); Lajmet për familjen e origjinës, niveli arsimor, gjendja ekonomike dhe sociale, profesionet, interesat, ekzistenca e vëllezërve dhe motrave, mosha dhe karakteristikat, marrëdhëniet me ta, ndjenjat ose pakënaqësitë, konfliktet, ndjenja e epërsisë ose inferioritetit, admirimi dhe identifikimi; Atmosfera familjare, kujtimet e prindërve në vitet e para të jetës, marrëdhëniet e prindërve me njëri-tjetrin dhe prindërit me subjektin, lidhja me familjen, preferenca për njërin prind ose një tjetër, gjykimi për prindërit, disiplina familjare, familja si burim rehatie dhe sigurie; Qëndrimi në lojëra me fëmijët e tjerë (bashkëpunues, agresiv, ndërhyrës, i turpshëm, pasiv, etj.). Karriera shkollore, mosha në fillim dhe në fund të shkollës, arsyet e ndërprerjes së mësimit, orët e përsëritura, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe mësuesit e tjerë, qëndrimi ndaj studimit; Qëndrimi ndaj grupit të bashkëmoshatarëve, figura identifikuese; Ambiciet dhe idealet adoleshente dhe rinore; Shërbimi ushtarak: Disiplina, frustrimet, etj.; Përvojat sentimentale dhe seksuale, lidhjet emocionale, martesa, atmosfera martesore, vështirësitë, marrëveshjet apo mosmarrëveshjet, ndarja apo divorci; Fëmijët dhe marrëdhëniet me ta; Sëmundjet, lëndimet, precedentët psikopatologjikë, rëndësia e tyre në marrëdhënie dhe në jetën e punës; Karriera e punës, qëndrueshmëria ose mungesa e punës, interesa ekstra-profesionale; Përdorimi i alkoolit ose drogës; Vështirësia e përshtatjes; Qëllimet dhe aspiratat për të ardhmen, ideale dhe personale.

[62] Sipas Sigmund Freud, mund të dallojmë në personalitet tre përbërës kryesor, të cilët paraqesin tre nivele të ndryshme të aktivitetit psikik: Pjesa e pandërgjegjshme (ES), përbëhet nga faktorë psikologjik të trashëguar dhe që janë prezent qysh me lindjen e personit dhe përfshin instiktet, ngacmimet, pasionet, idetë dhe ndjenjat. Nuk ka ndjesinë e kohës, të rregullit dhe të moralit dhe është gjithmonë në kërkimin konstant të kënaqësisë; Pjesa e natyrës së ndërgjegjshme dhe racionale (UNI), zhvillohet si pasojë e lindjes së nevojave të individit dhe përshtatjes së tyre me botën objektive dhe realitetin. Nuk është gjë tjetër vetëm se një ekzekutor pasiv i kërkesave që për të janë të panjohura dhe ndaj të cilave gëzon shumë pak autonomi. Liria e të vepruarit dhe përgjegjësia zhduken në momentin që një individ vepron i shtyrë nga forca të cilat nuk mund ti kontrollojë; Përfaqësuesi i brendshëm i vlerave etike dhe i rregullave shoqërore (SUPERUNI), strukturohet përgjatë fëmijërisë, duke bërë të vetat, nëpërmjet mekanizmit të identifikimit, përmbajtjen etike dhe rregullat e sjelljes të prindërve dhe më pas të personave të tjerë me të cilët krijohet kontakt. Është gjithmonë në konflikt me pjesën e pandërgjegjshme dhe kontrollon ngacmimet që vijnë prej saj. Personaliteti normal krijon një lidhje harmonike ndërmjet këtyre përbërësve kryesorë. Shumë nga klientët e tij, duke qenë se ndiheshin fajtorë, kryenin akte anti-shoqërore me qëllim që të arrestoheshin dhe të ndëshkoheshin. Në këtë mënyrë shpresonin të liroheshin nga ndjenja e fajit nëpërmjet ndëshkimit. Shih, P. Martucci, *Criminologia e psicoanalisi nell'Italia fra le due guerre: testimonianze di un rapporto dimenticato*, në Revistën "Rasegna Italiana di Criminologia", Volume XVI, N.1, 2022. Në këtë punim autori ka për qëllim të rindërtojë, përmes një qasjeje historike, marrëdhëniet midis kriminologëve dhe përkrahësve të psikanalizës në Itali në periudhën midis luftërave botërore, kur Lombroso ishte zhdukur prej kohësh dhe Freud, tashmë i moshuar, kishte arritur famë botërore.

nga natyra është antisocial dhe krijon probleme në shoqëri. Kriminaliteti që vjen për shkak të problemeve nervore, nuk varet nga një defekt i lindur por është produkt i një edukimi me probleme. Neurotiku i justifikon veprimet e tij duke menduar se do shlyejë gabimet duke vuajtur nëpërmjet vetëndëshkimit; E thënë ndryshe, krimineli neurotik gjen tek dënimi justifikimin për kryerjen e krimit të tij, që për të do të jetë një proces vetëdënimi. Freud shprehet se në këtë mënyrë vetëdija është një mënyrë reagimi në përgjigje të së keqes, e cila gjendet në pjesën e pandërgjegjshme. Për rrjedhojë mund të themi se brenda nesh është jo vetëm krimineli por edhe gjykatësi i brendshëm. Ekzekutimi i krimit mund të shpjerë tek dënimi dhe tek çlirimi psikik vetëm nëse krimi do të zbulohet. Kjo shpjegon edhe faktin, se përse të tillë kriminelë i kryejnë krimet e tyre në mënyrë që të zbulohen por edhe përse ata tregojnë një dëshirë të papërmbajtshme për t'u rrëfyer, dhe ndonjëherë edhe duke gënjyer.

Theodor Reik ndan të njëjtin mendim me Freud përsa i përket kriminelëve për shkak të ndjenjës së fajit dhe në veprën e tij që ka të bëjë me shtrëngimin për të rrëfyer rithekson rëndësinë e psikoanalizës në zgjidhjen e problemeve kriminologjike[63]. Sipas tij, shtysa për të rrëfyer mund të fshihet mbrapa rasteve "të harresës" dhe "neglizhencës". Krimi është një ngjarje traumatike, e cila mund të kapërcehet vetëm me kalimin e kohës dhe me përpjekje të mëdha. Periudha midis momentit të kryerjes së një krimi dhe rrëfimit të vërtetë mbizotërohet nga konflikti midis përpjekjes për të fshehur ngjarjen kriminale nga ndërgjegjja personale dhe tendencës së kundërt për ta pranuar atë. Ndonjëherë, në fakt, kriminelit i duhen disa vjet për të kuptuar se çfarë ka bërë dhe cili është kuptimi i gjestit të tij. Krimineli që rrëfen shpreh vullnetin për të çliruar ndërgjegjen e tij nga një ndjenjë dërrmuese e fajit. Në këtë rast kemi të bëjmë me një rrëfim në të cilin shkelësi demonstron qëllimin e tij për t'u kthyer në komunitet, nga i cili ai vetë ishte larguar me kryerjen e aktit të tij, duke e deklaruar veten të denjë për ndeshkim. Reik analizon shtrëngimin për të rrëfyer, sipas të cilit keqbërësi nëpërmjet lapsusit deshiron në të vërtetë që të zbulohet për t'u ndëshkuar më pas dhe për të lehtësuar në këtë mënyrë ndjenjën e tij

[63] Shih, L. Rossana, *Il concetto di delinquente per senso di colpa. L'apporto della psicoanalisi*, në Revistën "Rivista di Psicodinamica Criminale", Anno II – n.1, Gea Mater Padova Onlus, Padova, 2009.

të fajit. Kjo analizë përfshin dy drejtime kryesore: Krimet seriale: krimineli gjatë kryerjes së krimit me vetëdije lë gjurmë por jo deri në atë pikë sa të bëhet i mundur identifikimi i tij me qëllim që me kalimin e kohës të zbusë ankthin që e shoqëron derisa të rishfaqet përsëri në krimin e radhës; Krimineli, në të vërtetë nuk dëshiron të lirohet nga ndjenja e fajit që bëhet tërheqëse për të për shkak të ndjesive të tij mazokiste. Për këtë arsye, dënimi shndërrohet në inkurajim për kryerjen e veprës penale.

## 4. Shpjegimi i veprimtarisë kriminale të vrasësit serial

Përcaktimi i vrasjes seriale është kompleks dhe për këtë arsye është shumë e vështirë të përkufizohet saktë se çdo të kuptojmë me një vrasës serial. Megjithatë, edhe pse përkufizimet e ndryshme mund të tregojnë ngjashmëri, ato ndryshojnë në disa aspekte, si për shembull numri i viktimave[64], aspektet kohore të vrasjeve dhe lloji i motivimit të përfshirë[65]. Sipas studiuesve, periudha e ftohjes emocionale tregon për gjendjen e vrasësit i cili kthehet në stilin e tij të zakonshëm të jetës midis vrasjeve dhe ndryshon në kohëzgjatje (ditë, javë, muaj apo edhe vite) për çdo shkelës individual. Në momentin e parë, krimet e kryera nga vrasësit serial duken të rastësishme. Megjithatë, pas analizave të kujdesshme të rasteve kriminale, realizohet një ndërlidhje e rëndësishme midis tyre. Vendi ku kryhet krimi është shumë i rëndësishëm për vrasësin serial. Probabiliteti i realizimit të aktit kriminal në vende jo të njohura për të është i ulët pasi veprimet e tij janë krime të kontrolluara dhe për këtë arsye ky lloj vrasësi nuk do të ndihej i sigurt në këto vende. Për më tepër, nëse

[64] Shumica e studiuesve janë të mendimit se kemi të bëjmë me një vrasës serial në ato raste kur dikush kryhen tre ose më shumë vrasje që konsiderohen të ndara, për shkak të një "periudhe ftohjeje". Ky përkufizim ndihmon për të dalluar vrasjet seriale nga llojet e tjera të vrasjeve, si terrorizmi ose vrasjet masive. Shih, Booth, Hannah E., *A Criminological Analysis of Notorious Serial Killers in the United States*, 2021, Honors Thesis, 156. https://red.library.usd.edu/honors-thesis/156.

[65] Motivimi për kryerjen e krimeve është aspekti më i rëndësishëm për të diferencuar këto profile kriminale. Shih, R. W. Charlton, J. Barkhuizen, *Serial Murder*, në Revistën "The Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice", First Edition, 2014.

krimet ndodhen brenda një shtrirjeje të caktuar gjeografike, ekziston një probabilitet i madh që vrasësi serial të jetojë ose të punojë në këtë zonë[66].

Sipas Holmes dhe DeBurger, bazuar në motivimin e vrasësit, ekzistojnë pesë kategori të vrasësve serialë: Vrasësi vizionar është një njeri i shqetësuar që shpesh ka halucinacione, vuan nga një shkëputje me realitetin, sheh vizione ose dëgjon zëra nga demonët apo engjëjt që i thonë të vrasë disa njerëz; Vrasësi misionar detyrohet të vrasë për të hequr qafe një grup njerëzish që ai i ka gjykuar si të padenjë ose të padëshirueshëm dhe përgjithësisht prostituta, homoseksualë, gra ose fëmijë; Vrasësi i epshit, për të cilin seksi është motivi kryesor i vrasjes, kërkon të përfitojë kënaqësinë seksuale nga vuajtjet dhe torturat e viktimave të tij. Kjo kategori përfshin torturuesit, të cilët u shkaktojnë dhimbje fizike ose psikologjike të tjerëve; kanibalët, të cilët hanë individë të llojit të tyre; dhe nekrofilët, të cilët praktikojnë akte seksuale me trupa të pajetë; Vrasësi emocional merr kënaqësi dhe eksitim nga vrasja, që shpesh përfshin akte të zgjatura torture. Pasi viktima ka vdekur, ai humbet interesin; Vrasësi i fuqisë dhe kontrollit kërkon të ketë kontroll mbi viktimën e tij dhe të jetë "mjeshtër" në atë që bën. Motivi i tij është nevoja për pushtet dhe dominim mbi qeniet e tjera njerëzore[67].

Vrasësi serial është qenie e vetmuar sepse mendon se është i plotfuqishëm ndaj të tjerëve, ku askush nuk është mjaftueshëm i mirë për të. Ai planifikon me kujdes krimet, i kushton vëmendje detajeve dhe kërkon të kryejë krime të përsosura, pa lënë asnjë provë. Shpesh kthehet në vendin ku ka kryer krimin, duke synuar të ndjekë hetimet ose t'i marrë viktimës diçka të konsideruar si trofe. Ed Kemper, për shembull, ishte vrasësi serial më i suksesshëm në histori, i cili u arrestua vetëm kur u dorëzua në polici pasi vrau nënën e saj[68].

Sipas një orientimi doktrinar, në shumë raste vrasjet seriale shoqërohen me krime seksuale por kjo nuk do të thotë se elementi kryesor për të përzgjedhur

---

[66] César Augusto Trinta Weber., et al., *Serial Killers: Behavioral and Psychological Characteristics*, në Revistën "EC Psychology and Psychiatry", Volume 11, Issue 4, 2022.
[67] Shih, K. Abe, *What is a Serial Killer? What is a Mass Murderer? How do they Differ?* në Revistën, "European Journal of Academic Essays", 4(4): 187-198, 2017.
[68] J. Rogers, *Factors That Influence Violence and Homicidal Ideation Among Serial Offenders,* Dissertation Submitted in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy, Forensic Psychology, Walden University, November 2020.

viktimat është tërheqja seksuale dhe shtysa erotike: vrasjet seriale janë rezultat i konflikteve të brendshme që ndikohen nga faktorë personalë dhe mjedisorë, nga ekzistenca e marrëdhënieve ndërmjet autorit dhe viktimës, nga eksperiencat e kaluara dhe jeta e mëparshme e vrasësit që në përgjithësi është një person i dhunuar, i pasigurt, narcizist dhe që vuan nga çrregullime të personalitetit[69].

Në të shumtën e rasteve, *modus operandi* i një vrasësi serial mund të identifikohet nga fazat nëpër të cilat kalojnë veprimet e tyre: faza e artë kur nocioni i realitetit fillon të humbasë; faza e përzgjedhjes së viktimave; faza e rënies në kurth të viktimave; faza e vrasjes kur ndodh edhe kulmi i kënaqësisë së vrasësit; faza kur vrasësi bie në depresion dhe kthehet në fillim të ciklit. Nga studimi i *modus operandi* të një vrasësi serial në Afrikën e Jugut (Sithole)[70], rezulton, pikë së pari, se ai jetonte në një familje të çorganizuar dhe jofunksionale. Në moshë tepër të vogël u braktis nga nëna e tij dhe ky fakt ndikoi në mënyrë thelbësore në krijimin e një ndjenje zemërimi, urrejtje dhe hakmarrje ndaj grave të cilat filloi ti shihte si armike që nuk duhen besuar. Epshi për pushtet dhe kontroll mbi gratë u konsolidua në personalitetin e tij. Sithole u rrit si një fëmijë i dëmtuar psikologjikisht, të cilin shërbimet sociale, gjithashtu, nuk arritën ta ndihmonin. Megjithatë, ishte inteligjent, simpatik dhe bindës. Arriti të krijonte një agjenci punësimi imagjinare për të joshur dhe për ta përdorur si karrem për gratë. Aftësia e tij për të kryer 38 vrasje të pandalshme brenda një viti tregon qëndrueshmërinë e tij ndaj të qënit i keq. Besonte së tepërmi në aftësitë e tij, ishte mëndjemadh dhe arrogant, trim dhe i pathyeshëm. Në momentin e arrestimit kërcënoi me sëpatë oficerët e policisë duke treguar se ishte një njeri shumë i dhunshëm dhe i gatshëm të bënte çdo gjë nga dëshpërimi për të mos humbur lirinë personale. Këto karakteristika të tij tregojnë edhe për nivelin e dhunës që duhet të kenë përjetuar të gjitha viktimat e tij gjatë aktit të vrasjes.

Sipas studiuesve, vrasësit seralë vuajnë nga çrregullime të personalitetit dhe janë jashtëzakonisht të rrezikshëm, përdorin strategji të mirë menduara për të fituar

[69] V. Mastronardi, G. Neri, *Serial murders: criminological profiles*, në Revistën "Rivista di Psicopatologia Forense, Medicina Legale, Criminologia", volume 22, 2017.
[70] Sh. Yesufu, *An insight into the socio-psycho contexts and modus operandi of South Africa's worst serial killers over time*, në revistën "EUREKA: Social and Humanities, N.4, 2022.

besimin e viktimave të përzgjedhura të cilat i vrasin pa mëshirë vetëm për të kënaqur epshin e tyre të sëmurë. Një nga karakteristikat më të “shquara” të një vrasësi serial është “pafajësia”[71]. Vrasësi serial i afrohet viktimave në mënyrë miqësore, duke synuar të fitojë besimin e tyre. Këta vrasës e kryejnë krimin dhe nuk pendohen pasi krimet e tyre rrisin pa pushim dëshirën për të vrarë. Ata e kërkojnë pandërprerë kënaqësinë përmes mënyrave perverse, duke vepruar me vetëdije dhe janë të motivuar nga mizoria. Në shumë raste, ata nxiten nga kënaqësia e impulseve erotike. Fantazia bëhet diçka jashtëzakonisht e pranishme në jetën e tyre, duke e ngatërruar atë me realitetin. Përsëritja dhe rishfaqja e krimeve të tyre kontribuon në rritjen e fantazisë së tyre. Krimet e tyre janë përjetuar në mendjen e tyre disa herë, para dhe pas përfundimit të tyre. Për këtë arsye, ata ndjekin të njëjtin *modus operandi*, duke e ndryshuar atë vetëm kur ndihen të kërcënuar[72].

Modeli i sjelljes dhe karakteristikat psikologjike të një vrasësi serial nuk shfaqen vetvetiu, sa hap e mbyll sytë por i nënshtrohen një procesi që zhvillohet me kalimin e viteve. Disa sjellje në fëmijëri mund të tregojnë për tendencën për të kryer vrasje seriale në të ardhmen, të tilla si keqtrajtimi i kafshëve ose zjarrvënia e qëllimshme për të cilën ndonjëherë janë përgjegjës fëmijët deri në pesë ose gjashtë vjeç. Një zjarrvënës i ri “i paorganizuar” ka të ngjarë të shkaktojë zjarre më pak të dëmshme dhe dëme ekonomike më pak të rëndësishme sesa një zjarrvënës i “organizuar”, domethënë një zjarrvënës që planifikon gjithçka me përpikëri dhe që nga fillimi u vë flakën ndërtesave të banuara: qëllimi i tij është i dyfishtë, edhe për të lënduar njerëzit edhe për të shkaktuar dëmin maksimal të mundshëm ekonomik. Megjithatë, studiuesit janë të mendimit se sjellja që tregon më qartë tendencën për të kryer vrasje seriale është mizoria ndaj kafshëve që më pas shndërrohet në mizori ndaj

[71] Në një rast, një vrasës serial, përgjatë gjykimit të çështjes së tij në gjykatë, për të shpjeguar “pafajësinë” e tij u bazua tek Teoria e kriminelit të lindur të Lombrozos dhe u mundua t’i paraqiste veprimet e tij kriminale si të pavetëdijshme, pasojë e problemeve në ndërtimin e organizmit të tij. Megjithatë, gjykata e dënoi me vdekje. Shih, P. Martucci, *Delitti nuovi: La criminalitá non convenzionale nelle intuizioni dei lombrosiani*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume XII, N.1, 2018.

[72] L. De Fazio, F. B. Baracchi, C. Sgarbi, *Psicopatia e violenza: rassegna criminologia*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume X, Nr.1, 2016. Sipas mendimit të këtyre autorëve, nga studimi i skenave të krimit do të mund të zbuloheshin tiparet psikopatike të personalitetit të vrasësit serial, si kërkimi i ndjesive, mungesa e pendimit apo ndjenjës së fajit, impulsiviteti, nevoja për kontroll dhe pushtet, vetëkënaqësia apo sjellja grabitqare.

njerëzve: Nuk bëhet fjalë për goditjen e një qeni por për hedhjen e këlyshëve në zjarr ose për të lidhur në trupin e tyre fishekzjarreve, ndërsa në një rast tjetër, një vrasës serial fantazoi të lidhte një fitil në putrën e një maceje, ta ndezte atë dhe t'i shpërthente putrën[73].

Vrasësit serial kanë aspekte të përbashkëta psikologjike, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të kaluarën. Karakteristikat e zakonshme të fëmijërisë të një vrasësi serial janë masturbimi kompulsiv, problemet me gjumin, gënjeshtra, izolimi, posesiviteti, imoraliteti, abuzimi fizik, emocional apo edhe seksual, si edhe mungesa e dashurisë së nënës[74].

Shumica e vrasësve serialë kanë probleme në sferën seksuale dhe ky mendim është i vlefshëm edhe për ato subjekte, krimet e të cilëve nuk kanë një motiv kryesisht seksual[75].

Terapitë tradicionale nuk kanë asnjë efekt mbi një vrasës serial i cili, përkundrazi, e përjeton marrëdhënien terapeutike si një lojë pushteti dhe një ushtrim intelektual për të pohuar epërsinë e tij ndaj të tjerëve[76].

Një formë e perspektivës biologjike për vrasësit serial fokusohet në keqformimet e trurit[77]. Sipas një mendimi, nivelet e mosfunksionimit të trurit janë më të larta te kriminelët kronikë në krahasim me jo-kriminelët. Ai përshkroi më tej një gjendje të quajtur “Disfunksioni Minimal i Trurit”, ku një individ në mënyrë të papritur por episodike angazhohet në sjellje jo të përshtatshme siç është zemërimi i paqëndrueshëm si pasojë e të cilit prodhohet vrasje pa motiv, agresivitet, abuzim apo edhe vetëvrasje: kjo gjendje përfshin, gjithashtu, situata normale dhe sjellje të mira midis episodeve. Në studimin e tyre me 165 vrasës pa motiv nga e gjithë bota, Lange dhe DeWitt (1990) zbuluan se shumë vrasës serialë kishin një formë të lëndimit të

---

[73] S. Astolfi, *I serial killer italiani. Disturbo della personalità e del comportamento antisociale di alcuni serial killer italiani*, në revistën “Rivista di Psicodinamica Criminale”, Anno I, N.3, 2008.

[74] Marrëdhënia nënë-fëmijë është e rëndësishme në formimin e personalitetit dhe në zhvillimin e agresivitetit tek fëmijët: mënyra se si sillet nëna me fëmijën është tepër i rëndësishëm për një fëmijë. Shih, S. Polo, *Carenze affettive precoci nei serial killer*, në revistën “Rivista di Psicodinamica Criminale”, Anno I, N.3, 2008.

[75] W. Favaro, *La ricostruzione del profilo psicologico-comportamentale del serial killer. “I Mostri” di Firenze*, në revistën “Rivista di Psicodinamica Criminale”, Anno I, N.3, 2008.

[76] M. G. Sanguin, *Trattamento terapeutico di un serial killer: l’esperienza del dottor Martin Obler*, në revistën “Rivista di Psicodinamica Criminale”, Anno I, N. 3, 2008.

[77] Shih, M. Sharma, *The Development of Serial Killers: A Grounded Theory Study*, (2018), Masters Theses, 3720. https://thekeep.eiu.edu/theses/3720.

kokës ose anomali organike të trurit. Ata përfunduan duke deklaruar se për shkak të mosfunksionimeve neurologjike që shkaktojnë kriza, vrasësit serial veprojnë gjatë periudhave të aktivitetit të pakontrollueshëm të valëve të trurit, duke shkaktuar më tej sjellje kompulsive.

## 5. Teoria e inferioritetit

Sipas një mendimi doktrinal, mundësinë për të arritur një vlerë dominuese nuk e kanë elementët normal, të shëndetshëm dhe të fortë por vetëm elementët e dobët dhe me një zhvillim të vonuar. Nisur nga ky këndvështrim dhe duke hedhur vështrimin në jetën shoqërore mund të thuhet se probabilitet më të madh për të arritur një pozicion dominues nuk e kanë individët e lindur të fortë dhe të shëndetshëm po rata që kanë lindur të dobët dhe varfër[78]. Sipas Alfred Adler, ndjenja e dobësisë dhe e pamjaftueshmërisë është forca e parë dhe e vetme, me nxitje aktive për të synuar dhe për t'u ngritur në jetë dhe, sa më e gjallë të jetë kjo ndjenjë, aq më shumë intensifikohet tendenca për ta kapërcyer dhe për ta kompensuar atë gjendje. "Plani i jetës" së një individi është një sintezë e këtyre forcave, një marrëveshje midis këtyre dy motiveve, sinteza e të gjitha atyre proceseve biologjike dhe psikike të evolucionit që priren të fitojnë, për të kompensuar mangësitë dhe inferioritetet e lindura.

Çdo prirje superiore lind dhe jeton vetëm nën impulsin e një ndjenje inferioriteti. Kur një histerik të rrëfen ndjenjën e tij të inferioritetit ose poshtërsinë që ka bërë si pasojë e kësaj ndjenje, të jesh i sigurt se, pikërisht në rrëfimin e kësaj dobësie, do të përjetojë një ndjenjë krenarie: poshtërsia që ka bërë nuk do të jetë e fundit por do të jetë vazhdim i nënshtrimit ndaj kësaj ndjenje. Mikromania e tij është një megalomani më e ndërlikuar. Ndihet i vogël, e deklaron veten të dobët dhe këtë e bën për të arritur qëllimin e dominimit.

---

[78] O. Kaus, *L'individuo e il suo "piano di vita" secondo Alfred Adler,* në Revistën "Rivista di Psicologia Individuale", N.38: 5-10 (1995). Alfred Adler e përqendroi vëmendjen e tij në marrëdhëniet midis organeve të sëmura, funksioneve organike jonormale dhe fenomeneve psikike.

Freud e sheh jetën e njeriut në funksion të së kaluarës, ndërsa Adler e lexon atë në funksion të së ardhmes së tij, dhe kjo sepse individi udhëhiqet nga dëshira për të qenë superior, nga kërkimi i ngjashmërisë hyjnore, nga besimi në fuqinë e tij psikike[79]. Adler e konsideron thelbësore "vullnetin e pushtetit" dhe vetë-afirmimin që i lejon individit të lërë mënjanë ndjenjat e inferioritetit që i vijnë nga faktorë individualë ose nga faktorë ambientalë. Në disa raste, ndjenja e inferioritetit që, në një farë mënyre është prezente pothuajse në të gjitha qëniet njerëzore, përkeqësohet, kristalizohet dhe përcakton "kompleksin e inferioritetit" duke vënë në lëvizje mekanizma reagues dhe kompensues[80]. Kompleksi i inferioritetit mund të shpjerë në kryerjen e një krimi, duke qenë se kjo është mënyra më e mirë për të tërhequr mbi vete vëmendjen, për të qenë qendra e interesit dhe për të kompensuar në këtë mënyrë inferioritetin që posedon. Për shumë individë, kjo gjë mund të përbëjë rastin e vetëm për të qenë në konsideratë të vëmendjes publike, të cilën ata e dëshirojnë me shumë mall me qëllim që të ruajnë vlerësimin që kanë për veten.

[79] P. L. Pagani, *Discorso sulla Psicologia Individuale e sull'eclettismo*, në Revistën "Rivista di Psicologia Individuale", N.48: 21-39 (2000). Alfred Adler është i pari ndër radhët e psikologëve që kishte vëne re në mendjen e njeriut praninë e një faktori nxitës, të ndryshme dhe të pavarur nga *libido*, nxitja e konsideruar nga Freud si nëna e të gjitha shtysave, të drejtuara drejt qëllimeve të vetëafirmimit, të sulmit ose të mbrojtjes. Doktrina adleriane e agresionit na jep shenjat e para të shkëputjes konceptuale midis Freud dhe Adler, edhe pse bashkëjetesa e tyre në Shoqërinë Psikoanalitike vazhdoi deri në vitin 1911. Sipas Adler, tek fëmija i vogël, agresioni nuk është gjë tjetër veçse një energji primordial (fillestare), ende jo e disiplinuar dhe e drejtuar mirë, por tashmë e aftë për të garantuar plotësimin e nevojave më elementare. Gjatë rrugës, megjithatë, lindin pengesat e para, vuajtjet e para, rreziqet e para për t'i treguar fëmijës kufijtë brenda të cilëve ai do të jetë në gjendje të shprehë forcën e tij, duke modifikuar intensitetin e saj, në varësi të nevojave përkatëse. Më vonë, kur të jetë më i rritur, do t'i duhet domosdoshmërisht të merret me rregullat e bashkëjetesës, të mësuara fillimisht nga nëna dhe, më pas, të propozuara nga familja dhe rrjedhimisht nga shoqëria. Shumë nga këto rregulla kanë të bëjnë pikërisht me kontrollin e agresionit, i cili në këtë mënyrë do të drejtohet drejt sektorëve të lejuar, të përcaktuar apo edhe të imponuar.

[80] C. Canzano, *Analisi adleriana de "L'allievo modello" di Joseph Roth*, në Revistën "Rivista di Psicologia Individuale", N.38: 29-41 (1995).

# KREU IV

## SHPJEGIMI I SJELLJES KRIMINALE BAZUAR NË ÇRREGULLIMET MENDORE

**PËRMBAJTJA**: 1. Shëndeti mendor dhe çrregullimet mendore. – 2. Studime mbi çrregullimet mendore dhe sjelljen kriminale. – 3. Klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor. – 4. Institucionet për personat me çrregullime të shëndetit mendor. – 5. Trajtimi i personave të burgosur me probleme të shëndetit mendor. – 6. Përdorimi i substancave narkotike dhe çrregullimet mendore.

### 1. Shëndeti mendor dhe çrregullimet mendore

Shëndeti mendor është po aq i rëndësishëm sa edhe shëndeti fizik për siguruar mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë të individëve që jetojnë në atë shoqëri. Sipas studiuesve, termi shëndet mendor është përcaktuar në mënyra të ndryshme, në përputhje me dinamikat kulturore, që luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimit dhe konceptualizimit të tij[81]. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH 2001), konceptet që përdoren për të përkufizuar shëndetin mendor përfshijnë: mirëqenien subjektive, vetë-efikasitetin e perceptuar, autonominë, kompetencën, varësinë ndër breza dhe vetëaktualizimin e potencialit intelektual dhe emocional të dikujt. Një kuptim i përgjithshëm i shëndetit mendor dhe, në veçanti, i funksionimit mendor është i rëndësishëm sepse ofron bazën themelore për një kuptim më të plotë të zhvillimit të çrregullimeve mendore dhe të sjelljes së individit të ndikuar nga këto çrregullime. Shëndeti mendor i referohet mirëqenies emocionale, psikologjike dhe sociale të njerëzve. Ndikon në

[81] Shih, K. Reising, *Criminal Offending and Mental Disorders: Long-term bidirectional and intergenerational effects between mental health problems and offending behaviour*, Thesis submitted for the degree of Doctor of Philosophy, Institute of Criminology, University of Cambridge, September 2020.

mënyrën se si njerëzit mendojnë, ndihen, veprojnë dhe formon mënyrën se si ata e trajtojnë stresin, lidhen me të tjerët dhe bëjnë zgjedhje. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH 2018) e përkufizon shëndetin mendor si *një gjendje mirëqenieje në të cilën çdo individ realizon potencialin e tij, mund të përballet me streset normale të jetës, mund të punojë në mënyrë produktive dhe të frytshme dhe është në gjendje të kontribuojë për komunitetin në të cilin jeton*.

Të dhënat e para për sëmundjet mendore datojnë që në shekullin e IV para erës së re dhe, bazuar në këto të dhëna, në këtë periudhë besohej se njerëzit me sëmundje mendore të kenë qënë të pushtuar nga demonët, një ndëshkim fetar për kryerjen e mëkatit dhe për pasojë stigmatizoheshin nga shoqëria. Strategjitë drastike dhe çnjerëzore të trajtimit, si për shembull shpimi i vrimave në kafkë për të çliruar shpirtrat e këqij, janë përdorur si një mënyrë për të shëruar njerëzit me probleme të shëndetit mendor. Në periudhën e Mesjetës kanë ekzistuar disa teori që përdoreshin për të shpjeguar shkaqet e sëmundjeve mendore: sipas një teorie, sëmundja mendore ishte pasojë e pushtimit të njeriut nga shpirtrat djallëzorë, perënditë e zemëruara, mëkatet, ngjarjet astronomike si eklipset dhe energjia gravitacionale; sipas një teorie tjetër, sëmundja mendore buronte nga ndërprerjet në funksionimin fiziologjik të shkaktuar nga sëmundja, faktorët biologjikë ose trauma e trurit; ndërsa, një grup tjetër teorish eksploruan ndikimet që kishin në shëndetin mendor të njerëzve përvojat traumatike dhe njohjet jonormale. Secila nga teoritë e lartpërmendura përdorte teknika të ndryshme trajtimi sepse simptomatologjia e lidhur me secilën ishte e ndryshme[82].

Përgjatë viteve 1700 dhe 1800, personat me çrregullime të shëndetit mendor filluan të privoheshin nga liria personale dhe u vendosën në institucione, që njiheshin si "azile të të çmendurve". Në këtë periudhë, njerëzit besonin se kujdesi i institucionalizuar ishte metoda më efektive e trajtimit. Sipas studiuesve, "azilet e të çmendurve" nuk ishin të orientuara për të ndihmuar pacientët të mësonin se si të jetonin me sëmundjet e tyre mendore por, në vend të kësaj, ato ishin thjesht

[82] Shih, I. G. Farreras, *History of Mental Illness*, në AA.VV., General Psychology: Required Reading, Chapter 8: Psychological disorders and Therapies (Required), Noba, Diener Education Fund, 2019, fq. 244.

institucione penale të reformuara ku të sëmurët mendorë braktiseshin nga të afërmit ose dënoheshin me ligj dhe përballeshin me një jetë trajtimi çnjerëzor, të gjitha për hir të heqjes së barrës nga familjet e turpëruara dhe parandalimit të çdo shqetësimi të mundshëm në komunitet[83].

Nga fundi i shek. XIX dhe deri në fund të shek. XX, mjekët filluan të praktikojnë forma më humane të kujdesit duke ndërprerë përdorimin e kufizimeve fizike, duke inkurajuar një higjienë të mirë dhe duke përfshirë aktivitete rekreative për pacientët me probleme të shëndetit mendor. Pas vëzhgimit të kushteve çnjerëzore dhe johigjienike me të cilat përballeshin pacientët në "azile", filluan të ndërtoheshin spitale shtetërore për "të sëmurët mendorë" por, pavarësisht këtij fakti, shumica e spitaleve psikiatrike ishin të mbipopulluara, duke e bërë shumë të vështirë për mjekët të përqendroheshin në trajtimin e pacientëve të tyre. Në mesin e shek. XX, zbulimi i një sërë ilaçeve dhe modaliteteve për të trajtuar sëmundjet mendore shënuan një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e trajtimit të këtyre pacientëve[84]. Medikamente psikotrope, me më pak efekte anësore, janë duke u prodhuar vazhdimisht dhe specialistët e shëndetit mendor po zbatojnë qasje terapeutike të bazuara në fakte që janë provuar në mënyrë empirike se janë shumë më efektive në trajtimin e çrregullimeve të shëndetit mendor. Megjithatë, pavarësisht këtyre përmirësimeve në trajtimin e këtyre individëve, mund të themi se për fat të keq, burgosja e kësaj popullate vazhdon të jetë një praktikë e zakonshme.

Sipas studiuesve, asnjë përkufizim nuk mund të mbulojë të gjitha aspektet e të gjitha çrregullimeve mendore[85]: Kështu, sipas Manualit për Diagnostikimin dhe Statistikat e Çrregullimeve Mendore, Botimi i pestë (DSM-5, 2013), çrregullimi mendor konceptohet si një sindromë e karakterizuar nga shqetësime të rëndësishme klinike në njohjen dhe rregullimin e emocioneve ose sjelljen e individit që pasqyron

[83] Shih, J. R. Jones, V. L. Ford, *Mental Illness and Crime: A Misconceived Relationship*, në Revistën "Journal of Psychology and Behavioral Science", Vol. 7, N. 2, December 2019.

[84] Shih, J. Turner, R. Hayëard, K. Angel, B. Fulford, J. Hall, C. Millard, M. Thomson, *The History of Mental Health Services in Modern England: Practitioner Memories and the Direction of Future Research*, në Revistën "Medical History", International Journal for the History of Medicine and Related Sciences, Vol. 59(4), Cambridge University Press, 2015.

[85] Shih, J. Brink, *Crime and Mental Health*, 2015, Elsevier Inc., (PDF) Mental Health: Crime and Mental Health (researchgate.net).

një mosfunksionim në proceset psikologjike, biologjike ose zhvillimore që qëndrojnë në themel të funksionimit mendor. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (ICD-10, 1992), çrregullimi mendor nuk është “një term i saktë”, megjithëse përdoret përgjithësisht ...për të nënkuptuar ekzistencën e një grupi simptomash ose sjelljesh të njohura, klinikisht të shoqëruara, në shumicën e rasteve, me shqetësim dhe me ndërhyrje në funksionet personale.

Sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nenit 3 të Ligjit Nr.44/2012 “*Për shëndetin mendor*” i ndryshuar, *“shëndeti mendor” është aftësia për të menduar dhe mësuar, si dhe aftësia e një individi për të kuptuar e jetuar me emocionet e veta dhe reagimet e të tjerëve*, ndërsa *“çrregullim i shëndetit mendor” është çrregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme*.

Rruajtja e shëndetit mendor dhe trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor paraqesin një rëndësi të madhe për mbrojtjen e jetës së shëndetshme dhe rruajtjen e marrëdhënieve të mira në shoqërinë që jetojmë. Marrëdhënia midis çrregullimeve mendore dhe sjelljeve devijante ka rëndësi të madhe studimi dhe për këtë arsye ka lindur shkenca e psikiatrisë mjeko-ligjore, që trajton, pikërisht, çështjet që lindin si pasojë e marrëdhënies midis psikiatrisë dhe ligjit dhe që ka për objektiv kryesor të nxjerrë në pah gjendjen e shëndetit mendor të personit që kryen sjelljen e jashtëligjshme me anë të raportit psikiatrik. Psikiatri dhe eksperti mjeko-ligjor, nga njëra anë, për shkak të punës që kryejnë, janë në kontakt me çmendurinë, me të keqen, me dhimbjen dhe, nga ana tjetër, ata janë mjekë dhe shkencëtarë që përpiqen të studiojnë se si funksionon truri i njeriut që është baza e çmendurisë, devijancës, krimit dhe dhimbjes[86].

[86] Shih, A. Verde, *Le relazioni della psichiatria forense con la complessità del sapere psichiatrico odierno*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume V, N. 2. 2011.

Çrregullimet mendore dhe kriminaliteti janë dukuri shumë të përhapura, aq sa përbëjnë shqetësime serioze për të gjitha shoqëritë. Ndonjëherë, sëmundja mendore dhe kriminaliteti janë të pranishme në të njëjtën kohë dhe madje mund të ndodhë që njëra të jetë shkaku i drejtpërdrejtë i tjetrit. Megjithatë, në shumicën e rasteve mund të theksohet se ato janë dukuri krejtësisht të pavarura nga njëra-tjetra dhe për këtë arsye është mirë të kujtojmë se mundësia e ushtrimit të dhunës, kryerjes së krimeve dhe abuzimeve të të gjitha llojeve, është një problem shqetësues jo vetëm për personat me çrregullime mendore por edhe për personat e shëndetshëm mendërisht[87].

## 2. Studime mbi çrregullimet mendore dhe sjelljen kriminale

Sipas Lombrozos, i cili ishte ndër të parët që mori në studim lidhjen ndërmjet çrregullimeve mendore dhe kriminalitetit, ekziston një kategori e kriminelëve të trajtuar prej tij që është kategoria e kriminelit epileptik, të sëmuri mendor, të çmendurit apo me shëndet mendor të dobët dhe që janë të gjithë ata kriminelë që veprojnë pa ndonjë motiv, të shtyrë nga budallallëku ose nga fakti i të qenit i çmendur.

Sëmundjet e rënda mendore shoqërohen me karakteristika të rëndësishme psikopatologjike, si çrregullim mendor, zemërim, agresivitet, ndryshime të sjelljes që mund të marrin karakteristikat e sjelljes së dhunshme. Shumë shpesh ndodh që një person, i cili ka një episod akut psikopatik, ose një episod eksitimi maniakal, bëhet i dhunshëm dhe tepër agresiv nga frika se mos kërcënohet ose dëmtohet nga dikush ose sepse nuk është në gjendje të frenojë dhe kontrollojë një impuls të papërmbajtshëm ose një rritje të agresivitetit dhe zemërimit. Studiuesit janë të ndarë në dy grupe përsa i përket shpjegimit të nocionit të "agresivitetit" që është në thmel të sjelljes së dhunshme: nga njëra anë janë ata të cilët mbështesin mendimin se agresiviteti është i lindur, për shkak se është me origjinë instinktive dhe kongjenitale; nga ana tjetër, janë ata të cilët pohojnë natyrën relacionale dhe reaktive

[87] Shih, O. Greco, R. Maniglio, *Malattia mentale e criminalità*, në Revistën "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume I, N. 1, anno 2007.

të agresivitetit, të lidhura me përvoja të veçanta, të jetuara gjatë fazave të zhvillimit të jetës[88].

Gjatë një studimi mbi sjelljen e dhunshme të personave me probleme psikiatrike në dy rajone të Italisë[89], u morën në ekzaminim rreth 1582 pacientë, kryesisht të rritur (48.4% janë midis 30 dhe 49 vjeç), të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis meshkujve (49%) dhe femrave (51%). Sjelljet e dhunshme shfaqen në historinë klinike të mbi një të tretës (36.3%) të pacientëve. Sjelljet e dhunshme, më së shumti, përfshijnë dhunën e drejtuar nga jashtë kundër të tjerëve (76.7%). Sjelljet e dhunshme drejtuar ndaj vetes ndodh në 9.2% dhe sjelljet e dhunshme drejtuar ndaj sendeve në 14.1%. Meshkujt janë qartësisht mbizotërues në mesin e pacientëve me sjellje të dhunshme (65.74%). Ndër sjelljet e dhunshme të drejtuara ndaj njerëzve, bie në sy prevalenca e dhunës verbale dhe kërcënimeve (53.6%) që pasohet nga keqtrajtimi dhe rrahja (39.8%), dëmtimet nga rrahjet (14.5%), nga sendet jo prerëse (2.9%), nga armët e zjarrit (0.7%), nga armët me tehe (0.7%), tentativa për vrasje (0.9%) dhe vrasja (0.7%). Duhet theksuar se te pacientët që kryejnë akte të dhunshme ndaj njerëzve ka një tendencë të theksuar drejt rasteve të përsëritura (të përsëritura 42,8%, të shpeshta 17,1%) dhe se pothuajse në gjysmën e tyre (47,1%) ka shenja të intensifikimit të sjelljes së dhunshme. Për sa i përket sjelljeve të dhunshme të drejtuara ndaj vetvetes, ato janë kryesisht tentativa për vetëvrasje (70.9%) ose vetëvrasje të dështuara (7.5%). Episodet e vetëdëmtimit janë kryesisht të shkaktuara ndaj vetvetes (64.2%), mbi gjysma e të cilave janë të paparashikueshme (të rastësishme 26.1%; të menjëhershme 27.6%). Në 34.3% të rasteve, megjithatë, ato përshkruhen si “progressive”. Sjellja e dhunshme vetëm ndaj sendeve paraqitet sporadike (59.6%) dhe e paparashikueshme (e menjëhershme 38.5%; të rastësishme 19.2%).

---

[88] C. Barbieri, A. Luzzago, *Il comportamento aggressivo in psichiatria: un approccio ermeneutico come chiave di prevenzione del rischio e di valutazione della responsabilità professionale*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume IV, N. 1, 2010.

[89] Shih, R. Catanesi, F. Carabellese, D. Guarino, *Analisi del comportamento violento in una popolazione di pazienti psichiatrici in Puglia e Basilicata*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume I, N. 1, anno 2007.

Sipas mendimit tonë, të gjitha qëniet njerëzore fillojnë një jetë si krijesa të karakterizuara nga instinktet, të cilat më pas janë të destinuara t'i modifikojnë për një përshtatje eventuale me një grup të caktuar shoqëror. Për rrjedhojë, edukimi merr një rëndësi të madhe, pasi falë tij fëmija merr, përvetëson dhe ndërton një model automatik të kontrollit të instinkteve parësore. Fenomenet e kriminalitetit dhe të sëmundjeve mendore mendohet se rrjedhin nga paaftësia për të mbajtur një marrëdhënie të qëndrueshme me mjedisin shoqëror dhe mund të konsiderohen të dyja si produkt i konflikteve të pazgjidhura: krimi përfaqëson një rebelim me veprim shkatërrues të drejtuar jashtë, në shoqëri; sëmundja mendore, nga ana tjetër, është një rebelim me një veprim shkatërrues të drejtuar brenda vetvetes. Duket se shumë kriminelë janë të detyruar të përsërisin "keqbërjen" për të ruajtur mendjen e shëndoshë dhe shumë njerëz që i binden ligjit "çmenden" për të shmangur një krim. Edhe pse mund të kuptohet se nga pikëpamja sociale, sëmundja mendore "mbron" grupin në kurriz të vetë individit, një person me çrregullime mendore që kryen një krim i nënshtrohet një gabimi të dyfishtë përshtatjeje. Dështimi për të kontrolluar ndërveprimet shoqërore karakterizohet nga simptoma që tregojnë përpjekje për t'u rilidhur me realitetin, të cilat mund të shprehen në simbole verbale, modele motorike dhe gjuhën e trupit.

Sipas një orientimi doktrinar, pyetjet e ekspertit ndaj të intervistuarit që dyshohet se vuan nga çrregullime mendore duhet të orientohen në konstatimin e këtyre aspekteve: nëse subjekti vuan apo ka vuajtur nga sëmundje mendore; nëse po, duhet të konstatohet nëse krimi i kryer duhet të konsiderohet si shprehje simptomatike e dobësisë së lartpërmendur[90]. Ndërsa, sipas disa studiuesve të tjerë, sëmundja mendore dhe kriminaliteti duhet të shihen si modele të sjelljes karakteristike të të njëjtit person dhe, për këtë arsye, kriminaliteti përcaktohet dhe varet së tepërmi nga çrregullimet mendore[91]. Lidhja midis sëmundjes mendore dhe kriminalitetit mund të

---

[90] G. Canepa, *Personalità e delinquenza*, Giuffrè, Milano, 1974, në I. Merzagora Betsos, *Opache follie, impulsi resistibili, furori non sempre morbosi e il ritorno della perizia criminologica*, "Rassegna italiana di criminologia", Anno 1, Nr. 1, 2007.

[91] Rreth mesit të shekullit të njëzetë, ekzistonte një mendim i zakonshëm se sëmundja mendore dhe krimi ruanin një farë lidhjeje farefisnore në drejtim të regresionit dhe tërheqjes nga realiteti, duke e zëvendësuar realitetin me fantazi. Në të dyja rastet, shkëputja nga realiteti i kapërcen normat e grupit, është rezistente ndaj korrigjimeve

studiohet duke u bazuar në idenë e arsyeshmërisë, që demonstrohet përmes respektimit të ligjit, qëllimeve të pranueshme të jetës dhe sjelljes së përshtatshme, cilësi që shpesh mungojnë tek të sëmurët mendorë si dhe tek ata që shfaqin sjellje kriminale. Për pasojë, nëse të dy grupet mund të konsiderohen të paarsyeshme, atëhere duhet të ketë një lidhje midis të dyve. Sipas kësaj ideje, burgimi është një metodë e domosdoshme ndëshkimi për ata që vuajnë nga sëmundje mendore, pasi sjellja e tyre nuk kontrollohet lehtë me mjete të tjera.

Shumica e studimeve të bëra nxirrnin si përfundim se probabiliteti më i madh për të kryer krime dhe sidomos krime të dhunshme (vrasje) ishte tek personat me çrregullime të rënda mendore sesa tek pjesa e popullsisë pa probleme të shëndetit mendor. Disa studiues kanë ekzaminuar lidhjen midis kryerjes së vrasjes, pranisë së çrregullimeve mendore dhe abuzimit me substancat, në një popullsi prej 435 autorësh të vrasjeve. Nga të dhënat e përfituara nga ky studim, rezultoi se 38 prej vrasësve, ose 8.7%, ishin diagnostikuar me një çrregullim mendor (skizofreni) dhe kishin 13 herë më shumë gjasa të kryenin vrasje në krahasim me pjesën tjetër të vrasësve të përfshirë në studim[92].

Në një studim të kryer në Stamboll, në të cilin u shqyrtuan 85 raste të krimit të vrasjes së fëmijës nga prindi (48% e autorëve ishin burra dhe 52% ishin gra), të kryera midis viteve 1995 dhe 2000, u arrit në përfundimin se 41 autorë rezultuan të ishin të papërgjegjshëm dhe 44 autorë (24 burra dhe 20 gra) të ishin të përgjegjshëm. Nga ata 41 prindërit që rezultuan të papërgjegjshëm, 25 u diagnostikuan me skizofreni, 9 me depresion të rëndë, 4 me të meta mendore dhe 3 me dobësi fizike[93].

---

dhe tenton të kthehet në një "mënyrë të jetuari". Shih, T. A. Tully, *The Relationship between Mental Illness and Criminality: A Review*, Academy of Criminal Justice Sciences (ACJS), Volume XLII, Issue 5, 2017.

[92] D. J. Bennett, J. R. P. Ogloff, P. E. Mullen, S. D. M. Thomas, C. Wallace, T. Short, *Schizophrenia disorders, substance abuse and prior offending in a sequential series of 435 homicides*, në Revistën "Acta Psychiatrica Scandinavica", Volume124, Issue3, 2011, fq. 226-233. Studime të tjera theksojnë si një faktor rreziku për dhunën, jo te gjitha llojet e sëmundjeve mendore por vetëm disa lloje të veçanta çrregullimesh duke e vënë më shumë theksin tek problemet psikotike. Një studim i bëre në Los Angeles tregoi një lidhje të fortë midis sëmundjes mendore dhe dhunës: personat me skizofreni kishin një probabilitet 4 herë më të lartë për të kryer krime sesa popullata e përgjithshme, ndërsa personat që abuzonin me substanca kishin një probabilitet deri në 10 herë më të lartë. Shih, J. W. Swanson, C. E. Holzer, V. K. Ganju, R. T. Jono, Violence and Psychiatric Disorder in the Community: Evidence From the Epidemiologic Catchment Area Surveys, në Revistën "Psychiatric Services", A Journal of the American Psychiatric Association, Volume 41, Issue 7, 1990, fq. 761-770.

[93] Shkaqet që mund të shtyjnë prindërit për të vrarë fëmijën e tyre rezultuan të ishin të ndryshme: dhembshuria, sjellja psikotike impulsive, abuzimi fizik kronik, hakmarrja ndaj gruas, largimi i fëmijës së padëshiruar,

Sipas studimeve të kryera, rezulton se ekzistenca e çrregullimeve mendore tek të burgosurit ka një ndikim më të madh në kryerjen e sjelljeve të jashtëligjshme në krahasim me ekzistencën e këtyre çrregullimeve tek personat që janë në gjendje të lirë[94]. Për pasojë, mund të themi se burgosja e personave si pasojë e kryerjes së një vepre penale ka një ndikim tepër të madh në lindjen e problemeve të shëndetit mendor apo edhe në përkeqësimin e gjendjes psikike në rastet kur ata vuajnë nga këto shqetësime. Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues (KPT) në Standardet e tij të rishikuara në 2006 thekson bashkëpunimin e nevojshëm midis mjekëve dhe administratës së burgut në identifikimin në kohë të shqetësimeve të të burgosurve dhe mbi të gjitha në zgjedhjen e duhur që duhet bërë në trajtimin e atyre që vuajnë nga çrregullime psikiatrike: KPT përcakton në mënyrë të qartë që mjeku i burgut të bashkëpunojë me personelin e burgut për të reduktuar poshtërimin, urrejtjen ndaj vetvetes dhe urrejtjen përkundrejt të burgosurve të tjerë, për t'u dhënë atyre ndjenjën e përgjegjësisë dhe përgatitjen e tyre për riintegrim. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është kontrolli në momentin e hyrjes në institucion dhe, informimi i vazhdueshëm brenda institucionit apo ndërmjet institucioneve (në rast transferimi) dhe trajnimi i stafit që duhet të jetë në gjendje të njohë treguesit e mundshëm të problemeve shëndetësore dhe në mënyrë të veçantë problemet psikiatrike[95].

Sipas të dhënave të studimeve të kryera, deri në dhjetor 2022, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Itali numëronin rreth 56.196 të burgosur, që tejkalon kapacitetin ideal prej 51.328 të burgosur. Shkalla e prezencës është e barabartë me 91 të burgosur për 100,000 banorë, më e ulët se norma prej 140 për

---

aksidentalisht gjatë abuzimit seksual ose sadist. Në rastet kur prindërit nuk kanë një patologji psikiatrike, problemet ekonomike dhe kushtet jo të përshtatshme mjedisore mund të përbëjnë shkak kryesor për kryerjen e vrasjes. Rezultatet e këtij studimi treguan se prindërit që kryen vrasjen e fëmijëve të tyre vinin nga një mjedis i pafavorshëm socio-ekonomik. Një fakt shumë domethënës është se, ndërkohë që shkalla e papunësisë në Turqi në vitin 2001 ishte 8% dhe shkalla e analfabetizmit 14%, normat në grupin e personave objekt studimi ishin përkatësisht 45% të papunë dhe 48% analfabet. Për më tepër, sipas këtij studimi, nënat ishin përgjegjëse për 70% të vrasjeve të fëmijëve nën moshën një vjeç. Shih, M. Karakus, H. Ince, N. Ince, N. Arican, S. Sozen, *Filicide Cases in Turkey, 1995–2000,* në Revistën “Croatian Medical Journal”, 44(5):592-595,2003.

94 Shih, L. Ferrannini, G. Nuvoli, *Cura, custodia e riabilitazione. Il trattamento del detenuto con problematiche psichiche,* në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume XVII, N. 2, 2023.

95 R. Palmisano, *La gestione del detenuto con disagio psichico e il progetto Me.d.i.c.s.*, në Revistën “Rassegna penitenziaria e criminologica”, Nr.3, 2015.

100,000 të burgosur të regjistruar në mesataren botërore. Vlen të theksohet prania e lartë e të burgosurve të kombësive të tjera, 35% në nivel kombëtar por që në disa institucione arrin në mbi 60% të të burgosurve. Studimi evidenton ekzistencën e një numri të konsiderueshëm të të burgosurve me probleme të theksuara të çrregullimeve mendore. Hulumtimi i kryer ka zbuluar një prevalencë gjithnjë në rritje gjatë viteve, duke filluar nga 38.4% në 2014 dhe duke arritur, në sondazhin e fundit të 2021, një përqindje prej 49.2%: Subjekte me varësi ndaj substancave narkotike 21.8%; Të burgosur me çrregullime të shëndetit mendor 10.8%; Të burgosur me çrregullime të personalitetit 3.9%; Të burgosur që kanë çrregullime të lidhura me alkoolin 3.1%; Të burgosur që kanë çrregullime emocionale psikotike 4.7%; Të burgosur me patologji depresive jo psikotike 3.1%. Për më tepër, është rritur ndjeshëm numri i vetëvrasjeve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në vitin 2022 ka arritur në 84 raste, një shifër e pa regjistruar më parë: prek mesatarisht një prezencë prej 56,000 personash të burgosur, për një normë prej 14.3 vetëvrasje për 10,000 persona të burgosur, dukshëm më e lartë se ajo e popullsisë së lirë. Shumë nga episodet e vetëvrasjeve vijnë si pasojë e brishtësisë personale dhe sociale të të burgosurve, dhe jo nga patologjitë e shëndetit mendor. Megjithatë, kontrolli për përdorimin e drogës dhe kontrolli psikiatrik kërkohet gjithnjë e më shumë nga organet e menaxhimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, jo vetëm për arsye të parandalimit të sjelljeve të jashtëligjshme brenda në institucion por edhe për qëllime mbrojtjeje në lidhje me çdo përgjegjësi kontrolli[96].

Kohët e fundit, ka filluar të parashikohet përdorimi i Neuroshkencës si një mjet për të kuptuar sjelljen njerëzore në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë sjelljen kriminale. Një nga temat më të studiuara nga neuroshkenca ka të bëjë me përcaktimin e motivit të kryerjes së veprës penale, që është shkaku i atyre sjelljeve të caktuara që përfshijnë vlerësimin e realitetit në një mënyrë pozitive ose negative. Sipas këtyre teorive të reja, duhet të besojmë se veprimi kriminal është mënyra për

[96] Shih, L. Castelletti, J. Santambrogio, F. Scarpa, A. Giancontieri, A. Santarone, G. M. Galeazzi, L. De Fazio, *I luoghi della cura in psichiatria forense in italia: aspetti terapeutici e criticità in un sistema in evoluzione*, në Revistën “Rassegna Italiana di Criminologia”, Volume XVII, N. 2, 2023.

të arritur kënaqësinë e lidhur drejtpërdrejt me një gjendje të brendshme që duhet përmbushur. Përparimi teknologjik bën të mundur hetimin e trurit të njeriut në integritetin e tij absolut, pa asnjë ndërhyrje në funksionet normale të trurit duke përdorur teknologjinë për të identifikuar zonat e trurit dhe lidhjet neuronale që besohen të jenë baza e sjelljeve dhe disponimeve të caktuara si shprehja e agresivitetit, aftësia për të marrë vendime, për t'u sjellë në mënyrë të ligjshme, për t'iu përgjigjur stimujve të caktuar, emocionet, depresioni. Pyetja që shtrohet lidhet me faktin nëse përdorimi i teknikave të reja imazherike mund të pranohet pa vënë në dyshim, edhe një herë, ekzistencën e lirisë për të vepruar[97], e cila ishte një arritje shkencore dhe kulturore pas pretendimeve të Lombrosos.

Studimet e mësipërme nxjerrin në pah nevojën e madhe për rruajtjen e shëndetit mendor dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, qofshin ata persona që kanë kryer një vepër penale apo persona që nuk janë përfshirë në ngjarje kriminale.

## 3. Klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor

Nga pikëpamja kriminologjike, ekziston problemi i përcaktimit të përgjegjësisë penale për personat me probleme të shëndetit mendor që kryejnë një krim. Në lidhje me këtë pikë ekzistojnë tre orientime dhe përkatësisht[98]: Metoda psikopatologjike, i konsideron individët që kanë kryer një krim të padënueshëm por vetëm nëse vuajnë nga sëmundje të caktuara të treguara në Kodin Penal. Në lidhje me këtë hipotezë, është e mjaftueshme që personi i cili ka kryer një vepër penale të diagnostikohet me një nga këto sëmundje me qëllim që të mos ndëshkohet; Metoda normative, e konsideron të padënueshëm atë person i cili në momentin e kryerjes së veprës penale

[97] Të jesh i lirë për të vepruar nuk do të thotë që vendimi që marrim nuk varet nga asgjë. Në realitet kjo varet nga gjendja fiziko-kimike në të cilën ndodhet truri në atë moment të caktuar. Vendimet janë pasojë e një sërë reaksionesh fiziko-kimike të cilat moment pas momenti vazhdojnë drejt një drejtimi specifik nën kontrollin e ndërveprimit ndërmjet stimujve të jashtëm dhe të brendshëm që arrijnë në tru dhe vetive të tij. Këto veti varen nga gjenet tona dhe nga ndikimet që mjedisi ushtron vazhdimisht mbi ne. Rrjedha e vazhdueshme e mendimeve ka si substrat aktivitetin e grupeve të neuroneve dhe në çdo moment ka një modul që dominon mbi të tjerët. Prandaj truri (jo mendja), me vullnetin e tij të lirë, zgjedh modulin që është dominues për momentin. Shih, M. Strata, *Neuroscienza e diritto: un colloquio necessario*, në Revistën "Diritto penale e uomo", 2014.
[98] Shih, L. Sammicheli, G. Donzella, *I rapporti tra imputabilità e infermità mentale*, në Revistën "Rassegna penitenziaria e criminologica", Nr.3, 2004.

ishte i paaftë për të kuptuar veprimin e tij pavarësisht nga ekzistenca e një sëmundjeje mendore; Metoda psikopatologjike-normative, që merr në konsideratë fillimisht nëse personi vuan nga ndonjë sëmundje mendore dhe më pas bëhet vlerësimi nëse kjo sëmundje ndikon në aftësinë e tij për të kuptuar dhe dëshiruar kryerjen e krimit. Ky sistem është më i përdoruri në shumë kode evropiane. Për shembull, në Itali, Kodi Penal mbështetet mbi një "sistem ndëshkues të dyfishtë" me të cilin hartuesit e tij u përpoqën të pajtonin parimet e shkollës klasike të së drejtës penale me ato të shkollës pozitive: nga njëra anë ideja e një njeriu të lirë dhe të përgjegjshëm për t'u dënuar me një dënim ndëshkues, dhe nga ana tjeter, një njeri i rrezikshëm, i kushtëzuar nga një mori faktorësh (social, mjedisor, patologjik), që duhet të kontrollohet nëpërmjet masave specifike të sigurisë.

Pavarësisht se ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me klasifikimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, ne jemi të mendimit, referuar edhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, se personat me çrregullime të shëndetit mendor duhet t'i grupojmë sipas disa kategorive.

Persona me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët nuk kanë kryer vepra penale. Në këtë rast këta individë, në bazë të Ligjit Nr. 44/2012 "*Për shëndetin mendor*" i ndryshuar, kanë të drejtë të marrin disa shërbime shëndetësore, përmes të cilave ofrohet kujdes për shëndetin mendor: Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor; Shërbimet komunitare të shëndetit mendor; Shërbimet ambulatore të specializuara; Shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër[99].

---

[99] Ky lloj shërbimi rregullohet nga nenet 19 deri 27 i Ligjit nr. 44/2012 "*Për shëndetin mendor*" i ndryshuar, që përbëhet nga: *Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor*. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është shërbimi që ofrohet nga mjekët e familjes dhe personeli infermieror, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor bazohet në paketën bazë të shërbimit të kujdesit parësor dhe në sistemin e referimit, ku përfshihet edhe detyrimi i zbulimit, referimit dhe ndjekjes së pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor; *Shërbimet komunitare të shëndetit mendor* ofrojnë veprimtaritë parandaluese, kuruese dhe rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Shërbimet komunitare të shëndetit mendor ofrohen nga një ekip multidisiplinar dhe kanë si qëllim: a) ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike; b) integrimin social, rehabilitimin psikosocial dhe riaftësimin social e professional; *Shërbimet ambulatore të specializuara* janë shërbime që ofrohen nga mjekë të specializuar në disiplinën mjekësore psikiatri, personel infermieror dhe personel mbështetës i kualifikuar, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe privat; *Shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër* janë shërbime të specializuara brenda spitalit të përgjithshëm ose në spitale të specializuara, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin spitalor.

Persona me çrregullime të shëndetit mendor që në momentin e kryerjes së veprës penale kanë qenë të papërgjegjshëm. Sipas paragrafit të parë të nenit 17 të Kodit Penal, *nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale*. Mbi bazën e kësaj dispozite arrijmë në konkluzionin se këta persona nuk dënohen, pra e thënë ndryshe nuk kanë përgjegjësi penale. Gjithsesi bëhet fjalë për persona që kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore, jo vetëm në aspektin e kurimit të sëmundjes që ata mbartin por edhe në kuadër të parandalimit me qëllim mos-kryerjen e veprave të tjera penale në të ardhmen.

Persona me çrregullime të shëndetit mendor që në momentin e kryerjes së veprës penale kanë qenë të përgjegjshëm. Sipas paragrafit të dytë të nenit 17 të Kodit Penal, *personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit*. Në këtë rast kemi të bëjmë me persona të burgosur por që në momentin e kryerjes së veprës penale kanë pasur çrregullime të shëndetit mendor që kanë ulur aftësinë e të kuptuarit të veprimeve të tyre. Edhe këta persona kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore në kuadër të vuajtjes së dënimit për veprën penale të kryer.

Persona që janë duke vuajtur dënimin dhe gjatë vuajtjes së dënimit preken nga çrregullime të shëndetit mendor. Të tillë persona kanë nevojë për trajtim mjekësor në kuadër të të drejtës për përkujdesje shëndetësore të parashikuar nga Ligji Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

## 4. Institucionet për personat me çrregullime të shëndetit mendor

Për secilën nga kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor të përmendur më sipër, ligji parashikon institucione të posaçme ku do të bëhet trajtimi i tyre mjekësor. Kjo për vetë faktin se kemi të bëjmë me persona që kanë statuse të ndryshme pavarësisht se kanë të përbashkët nevojën për përkujdesje shëndetësore për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor.

Përsa i përket personave me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët nuk kanë kryer vepra penale ata kurohen në spitale psikiatrike ku marrin të gjitha shërbimet shëndetësore të përcaktuara në ligj. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një kategori personash që kanë risk tepër të lartë për t'u përfshirë në kriminalitet, kjo edhe për arsyen se shumica e studimeve evidentojnë një lidhje tepër të ngushtë ndërmjet çrregullimeve mendore dhe kriminalitetit[100]. Për këtë arsye, është detyrë e autoriteteve përgjegjëse shëndetësore që të monitorojnë pa ndërprerje gjendjen e tyre shëndetësore dhe kur është rasti të vendosin edhe për shtrimin e tyre në spital psikiatrik.

Kategoria e dytë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale por në momentin e kryerjes kanë qenë të papërgjegjshëm, do t'i nënshtrohen përcaktimeve të bëra nga neni 46 i Kodit Penal. Ndaj këtyre personave do të zbatohen masat mjekësore. Sipas këtij neni, masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale. Masat mjekësore janë: a) mjekimi i detyruar ambulator; b) mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor. Vendimi gjyqësor për masat mjekësore është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj. Sipas nenit 56 të Ligjit Nr.79/2020 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*", për personin e papërgjegjshëm që ka kryer një

[100] Sipas një studimi, është vlerësuar se personat me sëmundje të rënda mendore kanë 1.5 herë më shumë gjasa të burgosen sesa të shtrohen në spital për trajtimin e çrregullimit të tyre psikiatrik, duke e bërë fushën e shëndetit mendor një shqetësim të dukshëm për zyrtarët e drejtësisë penale. Shih, T. Al-Rousan, L. Rubenstein, B. Sieleni, H. Deol, R. B. Wallace, *Inside the nation's largest mental health institution: a prevalence study in a state prison system*, BMC Public Health, Research Article, 2017, file:///C:/Users/35569/Downloads/s12889-017-4257-0.pdf.

vepër penale, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet sipas vendimit të gjykatës në institucionin mjekësor të specializuar të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucionin mjekësor i personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale kryhet: nga institucioni mjekësor që e ka në trajtim; nga institucioni mjekësor me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim; nga Policia e Shtetit në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht. Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë. Kur gjatë ekzekutimit të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të specializuar.

Sipas nenit 28 të Ligjit Nr.44/2012 “*Për shëndetin mendor*” i ndryshuar, institucionet mjekësore të posaçme janë institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përshkruara më sipër, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar.

Sipas paragrafit 2 të nenit 15 të Ligjit Nr.81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimit të shërbimeve.

Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë.

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme arrijmë në konkluzionin se kjo kategori e personave me çregullime të shëndetit mendor nuk vendosen, as në spitale psikiatrike për të sëmurët mendorë që nuk kanë kryer vepra penale, as në institucione të posaçme në të cilat vendosen të dënuar me çrregullime të shëndetit mendor. Këta persona vendosen në institucion mjekësor të specializuar, të përshtatshëm për kurimin e sëmundjes nga e cila ata vuajnë. Në qoftë se një person i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, ndaj të cilit është dhënë masa mjeksore mjekim i detyruar në një institucion mjeksor, do të vendosej në një institucion te ekzekutimit të vendimeve penale atëhere do të kishim shkelje të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas këtij neni, çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve taksative të parashikuara qartë nga kjo Konventë. Për këtë arsye, të vendosësh në institucion të ekzekutimit të vendimeve penale një person me masë mjeksore është privim i padrejtë i lirisë personale.

Kategoria e tretë e personave, të cilët në momentin e kryerjes së veprës penale kanë pasur çrregullime të shëndetit mendor që kanë ulur aftësinë e të kuptuarit të veprimeve të tyre, do të vendosen në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*". Këta persona nuk përjashtohen nga përgjegjësia penale dhe për këtë arsye ndaj tyre do të vazhdojë proçedimi penal, në përfundim të të cilit do të jepet edhe masa e dënimit. Në rastin kur këta persona duhen arrestuar, gjykata bazuar në nenin 239 të Kodit të Proçedurës Penale, në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për të parandaluar rrezikun e ikjes. Në përfundim të gjykimit të çështjes, nëse rezulton se i dënuari vazhdon të vuajë nga çrregullime të shëndetit mendor, gjyqtari duhet të urdhërojë, më bazë të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të*

*paraburgosurve*", vendosjen në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore të tyre dhe të veprës penale që kanë kryer.

Kategoria e katërt e personave me çrregullime të shëndetit mendor, ashtu sikurse e kemi përmendur më sipër, ka të bëjë me ata persona që janë duke vuajtur dënimin dhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit preken nga çrregullime të shëndetit mendor. Kështu për shembull, çfarë do të ndodhë me një të dënuar që është duke vuajtur dënimin dhe gjatë kësaj kohe fillon të vuajë nga çrregullime të shëndetit mendor. Në bazë të paragrafit 2 të nenit 42 të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. I burgosuri që gjendet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që ka çrregullime të shëndetit mendor gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit.

## 5. Trajtimi i personave të burgosur me probleme të shëndetit mendor

Të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë në radhë të parë të drejtat dhe mënyrën e trajtimit të të burgosurve, të parashikuar në Ligjin Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*": nga ana tjetër, sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 44/2012 "*Për shëndetin mendor*", të dënuarit dhe te paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë këtyre institucioneve ose në Qendrën Spitalore të Burgjeve. Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e

personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, ofron, sipas nevojave, të gjithë asistencën e nevojshme për diagnostikimin, kurimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor. Në këtë kuadër është shumë e rëndësishme ofrimi i një përkujdesje shëndetësore të posaçme, efikase dhe efiçiente, pasi në rast të kundër trajtimi i këtyre të dënuarve mund të shndërrohet në trajtim çnjerëzor apo degradues duke rënë në kontrast edhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: dhe nëse gjendja e keqe e trajtimit do të vazhdonte dhe për rrjedhojë do të kishim edhe cenim të të drejtës së jetës, kjo mund të përbënte njëkohësisht edhe shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndër të burgosurit ka një incidencë më të lartë të simptomave psikiatrike në krahasim me popullsinë në përgjithësi. Si rrjedhim, shërbimit të kujdesit shëndetësor në çdo burg duhet t'i atashohet një mjek i kualifikuar në psikiatri dhe disa nga infermierët e punësuar aty duhet të jenë të trajnuar në këtë fushë. Plotësimi me personel mjekësor dhe infermierik si edhe planimetria e burgjeve duhet të mundësojnë kryerjen rregullisht të programeve të terapisë profesionale, psikoterapeutike dhe farmakologjike.

Sipas paragrafit 3 të nenit 42 të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", trajtimi shëndetësor i të burgosurve përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontrollet për: sëmundjet seksualisht të transmetueshme; sëmundjet e lindura të gjakut; kujdesin shëndetësor mendor; çrregullimet posttraumatike; rrezikun e vetëvrasjes ose të vetëdëmtimit; historinë e shëndetit riprodhues; praninë e varësisë të drogës; abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës, që mund të ketë pësuar përpara pranimit në institucion.

Të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit në fuqi, dhe përfitojnë, pa pagesë, të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji. Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e

shëndetit të të burgosurve. Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit, në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë. Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë: parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve; furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore në rastet e emergjencës shëndetësore ato kur nuk mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor; profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse; sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të paraburgosurve dhe të dënuarve.

E thënë me fjalë më të thjeshta, Shteti ka detyrimin e garantimit të të drejtës për përkujdesje shëndetësore dhe për këtë arsye duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të mos ngarkohet me përgjegjësi në rast të ndërlikimit të situatave. Nëse do të kishim dëmtim të shëndetit të të dënuarve apo të paraburgosurve, apo çfarë është më e keqe vdekja e tyre si pasojë e komplikacioneve me shëndetin, Shteti ka detyrimin pozitiv të vërtetojë se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim kurimin e shëndetit të të dënuarve por vdekja ka ardhur si pasojë e shkaqeve që nuk lidhen me këto masa. Në këtë kuadër duhet parë edhe shfaqja e çrregullimeve të shëndetit mendor, që nuk janë gjë tjetër përveçse nevojë për përkujdesje shëndetësore. Për rrjedhojë, fillimisht personit në nevojë i duhet dhënë ndihma e duhur brenda në institucion, dhe vetëm në rast se kjo ndihmë nuk mund të sigurohet në kushtet e institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit transferohen në Qëndrën Spitalore të Burgjeve dhe, kur është e nevojshme, ata transferohen në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë dhe në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi, në varësi të saj. Mund të ndodhë që këta persona të kenë nevojë që të transferohen në një IEVP të ndryshëm nga IEVP ku ndodhen për shkak se në institucionin ku do të shkojnë ofrohet më mirë shërbimi i përkujdesjes shëndetësore për arsye të çrregullimeve mendore. Në këtë rast, një transferim i tillë mund të bëhet bazuar në dispozitat e nenit 78 të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

# 6. Përdorimi i substancave narkotike dhe çrregullimet mendore

Në ditët e sotme, substancat narkotike janë shndërruar në pjesë integrale të jetës së përditshme të shumë njerëzve, qofshin ato substanca të përdorura për qëllime të ligjshme mjekësore, qofshin të përdorura për qëllime rekreative (për të ndryshuar ose përmirësuar gjendjen shpirtërore, në kuadër të ceremonive fetare, për të arritur ndriçimin shpirtëror, për të përmirësuar performancën)[101].

Dopamina, një neurotransmetues i përfshirë në aspektet themelore të funksionimit të trurit, është një element kyç në abuzimin me drogën dhe varësinë. Është e pranishme në rajonet e trurit që kontrollojnë lëvizjen, emocionet, mendimet, motivimin dhe ndjesitë e kënaqësisë: kur hamë diçka të këndshme ose dëgjojmë muzikën tonë të preferuar, dopamina sinjalizon se diçka e rëndësishme po ndodh që duhet mbajtur mend, duke na shtyrë të përsërisim sjelljen e këndshme. Substancat narkotike mund të shkaktojnë një çlirim të dopaminës aq të fuqishme sa që nuk mund të krahasohet me atë të asnjë prej kënaqësive natyrore të përmendura më sipër. Nëse dikush përdor substanca narkotike, do të mbajë mend dhe do të përpiqet të ripërjetojë kënaqësinë që ka ndjerë pas marrjes së tyre, megjithëse, me kalimin e kohës, do të bëhet gjithnjë e më e vështirë për të rikrijuar nivelin fillestar të kënaqësisë. Gjithashtu, është e mundur që, në mënyrë të ngadaltë të jetë bërë gjithnjë e më pak i ndjeshëm ndaj kënaqësisë që gjenerojnë stimujt e jetës së përditshme[102].

---

[101] Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), varësia ndaj drogës është si një sëmundje kronike dhe e përsëritur që e shtyn individin, në mënyrë të detyruar, të marrë substanca në doza në rritje ose konstante për të patur efekte të dobishme subjektive me kohëzgjatje të përkohshme, vazhdimësia e të cilave është e lidhur pazgjidhshmërisht me marrjen e vazhdueshme e substancës.

[102] Shih, G. Calamai, *Uso e abuso di sostanze: Capire e affrontare le dipendenze da alcol e droghe*, Ericson, Roma, 2018, fq. 7. Karakteristikat e mësipërme janë për stimuluesit e sistemit nervor qendror, të cilët përfshijnë substanca me nxjerrje natyrale (kokaina) dhe substanca sintetike (amfetamina). Këto stimulues ushtrojnë funksionin e tyre duke rritur disponueshmërinë e dopaminës në hapësirën sinaptike përmes mekanizmave të ndryshëm: ku amfetamina rrit lirimin e dopaminës ndërsa kokaina redukton rimarrjen e saj. Substanca të tjera mund të përmendim opiatet që ndahen në: molekula me origjinë natyrale (morfina), gjysëm-sintetike (heroina), sintetike (metadoni), antagoniste (naloksoni). Këto substanca ndikojnë reduktimin e dhimbjes, ndalimin e marrjeve mend apo të vjellave, të kollës dhe sekrecioneve gastrike. Depresivët, alkoli apo edhe halucinogjenët janë substance të tjera ndaj të cilave organizmi njerëzor krijon varësi. Çrregullimet e lidhura me përdorimin e këtyre substancave mund të lindin kur substancat që aktivizojnë drejtpërdrejt rrugët e kënaqësisë në tru përdoren për shkak të ndjenjave të mirëqenies që ato shkaktojnë. Këto ndjesi ndryshojnë në varësi të substances.

Një pyetje e zakonshme që mund të bëhet në këtë rast lidhet me faktin nëse këto substanca ndikojnë apo jo në shëndetin mendor të përdoruesit: sipas studiuesve është vënë re një lidhje e ngushtë ndërmjet përdorimit të drogës dhe lindjes së problemeve të shëndetit mendor[103]. Sipas një mendimi përdorimi i substancave narkotike rrit agresivitetin dhe impulsivitetin tek individët e predispozuar biologjikisht për tu përfshirë në kriminalitet, ndërsa sipas një mendimi tjetër disa individë mund të bëhen të dhunshëm dhe të rrezikshëm vetëm nën efektin e substancave psikoaktive si alkoli, droga apo edhe depresivët[104].

Po në rast se një përdorues i lëndëve narkotike kryhen një vepër penale a do të ketë përgjegjësi penale duke parë ndikimin që ka droga në shëndetin mendor: edhe në këtë rast përgjigjja është e lidhur me aftësinë e subjektit për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta. Në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë rregullohet më së mirë ndëshkimi i veprave penale të kryera nën efektin e alkolit apo edhe të lëndëve narkotike. Fillimisht mund të themi se nëse nga përdorimi i alkolit apo drogës, subjektit që ka kryer vepër penale, i është prishur tërësisht ekuilibri i tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale, atëherë mund të themi se ky person është i papërgjegjshëm dhe përjashtohet nga ndjekja penale. Në të gjitha rastet e tjera, për të përcaktuar nëse kemi të bëjmë me persona që do të mbajnë apo jo përgjegjësi penale na vjen në ndihmë neni 18 i Kodit Penal. Kështu në paragrafin e parë të këtij neni trajtohet rasti i dehjes së zakonshme dhe sipas legjislatorit tonë, nuk përjashtohet nga përgjegjësia personi që ka kryer veprën penale në gjendje të dehur. Me fjalë të tjera, nëse një person që pi alkool gjithë ditën dhe rri gjithë kohës në gjendje të dehur, në rast se do të kryejë një vepër penale, do të mbajë përgjegjësi penale njësoj sikur të ishte esëll, pra në gjendje jot ë dehur. Në rastin tjetër të

[103] G. Edwards, A. Arif, R. Hodgson, *Nomenclature and classification of drug- and alcohol-related problems: a WHO Memorandum,* Bullettin of the World Health Organization, 1981. Sipas këtyre studiuesve ekzistojnë tre lloje të ndryshme lidhjesh që mund të ndodhin midis çrregullimeve mendore dhe përdorimit të substancave: çrregullimet mendore shkaktojnë abuzimin e substancave; çrregullimet mendore vijnë nga përdorimi i substancave; midis çrregullimeve mendore dhe përdorimit të substancave ekziston një lidhje shkakësore.

[104] M. Pacini, I. Maremmani, P. De Pasquali, *Uso di sostanze negli assassini seriali italiani: correlazione con le caratteristiche del comportamento omicida*, në Revistën "Rassegna Italiana di Criminologia", Volume III, N. 2, 2009.

parashikuar nga paragrafi i dytë i këtij neni, legjislatori ka vendosur se kur dehja është shkaktuar në rrethana të rastit dhe ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor, kjo rrethanë mbahet parasysh për zbutjen e dënimit ndaj tij: për shembull, një person që shkon në dasmë dhe pi alkool pastaj merr armën dhe qëllon në ajër do të mbajë përgjegjësi penale por një dehje e tillë (dehje e rastit) do të ndikojë që gjyqtari të ulë masën e dënimit ose edhe të vendosë një masë më të butë dënimi në varësi edhe të llojit të veprës penale të kryer dhe rrezikshmërisë së autorit të veprës penale. Ndërsa kur dehja është bërë me paramendim për të kryer veprën penale, kjo rrethanë mbahet parasysh për rëndimin e dënimit. Ky është rasti kur personi ka pak guxim dhe pi me qëllim që të përfundojë kryerjen e sjelljes kriminale për të cilën e ka vendosur që do ta kryejë.

Sipas legjislatorit tonë, të gjitha rastet e mësipërme, të parashikuara për përdorimin e alkolit zbatohen edhe ndaj përdoruesve të lëndëve narkotike apo stimulantëve të tjerë. Sipas paragrafit 7 të nenit 42 të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", të burgosurit që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, të substancave psikotrope, alkoolit ose shfaqin shenja të stresit u nënshtrohen të njëjtave programe shëndetësore dhe sociale që zbatohen jashtë institucionit. Në interpetim të kësaj dispozite, arrijmë në konkluzionin se nëse të burgosurit që janë përdorues të lëndëve narkotike kanë edhe probleme të shëndetit mendor atëherë do të duhet të përfitojnë trajtimin e të burgosurve me çrregullime mendore të trajtuar më sipër por edhe duhet të trajtohen edhe për varësinë e drogës apo të alkoolit që mund të ketë shkaktuar këto probleme të shëndetit mendor.

# KREU V

## TEORITË SOCIOLOGJIKE TË KRIMINALITETIT

**PËRMBAJTJA**: 1. Klasifikimi i teorive me bazë sociologjike. – 2. Teoria e ç’organizimit social. – 3. Teoria e zonave kriminale. – 4. Teoria e anomisë. – 5. Teoria e neutralizimit. – 6. Teoria e etiketimit.

### 1. Klasifikimi i teorive me bazë sociologjike

Sipas mendimit tonë, teoria e Enrico Ferrit shënon pikënisjen e zhvillimit të teorive me bazë sociologjike, të cilat, me kalimin e kohës janë kthyer në degën kryesore të kriminologjisë[105]. Zhvillimin më të madh këto teori e kanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me plot bindje mund të themi se pjesa më e madhe e literaturës në kriminologjinë amerikane rrjedh nga botimet e sociologëve[106]. Kontributi i sociologjisë mbetet i rëndësishëm pasi ndihmoi në një zhvillim të ri të studimit të fenomenit kriminal. Objekt i analizave tani nuk është më krimineli dhe sjellja e tij por shoqëria dhe kriminaliteti edhe pse me kalimin e kohës u vu re një gërshetim i analizave kriminologjike, duke prekur të dyja drejtimet njëkohësisht. Sipas këtij orientimi, sjellja kriminale nuk është gjë tjetër veçse një sjellje sociale, duke shmangur mendimin se sjellja kriminale është rezultat i shumës mes nivelit bio-psikologjik (sfera individuale) me nivelin social – mjedisor[107].

Teoritë e para sociologjike ose e thënë ndryshe teoritë tradicionale, për të identifikuar personin devijant, që shkel rregullat në shoqëri, bazohen tek kontrolli që

[105] E. Ferri, *Criminal Sociology*, The American Institute of Criminal Law and Criminology, Little, Brown, and Company, Boston, 1917.
[106] M. B. Clinard, *Sociologists and American Criminology*, në Revistën “Journal of Criminal Law and Criminology”, Vol. 41, Nr. 5, 1951.
[107] Sociologjia studion shkaqet e kryerjes së veprave penale dhe të mjeteve të mbrojtjes nga kriminaliteti. Pa mohuar se kjo shkencë bazohet në të drejtën, duhet pranuar se ajo nuk është thjesht juridike, pasi degëzohet dhe zgjerohet në një fushë të ndryshme nga ajo e marrëdhënieve juridike. Shih, N. Colajanni, *La sociologia criminale*, Volume primo, Filippo Tropea Editore, Catania, 1989.

ushtron shoqëria në respektimin e këtyre rregullave dhe synojnë të shpjegojnë arsyen se përse njerëzit devijojnë, të kuptojnë kushtet dhe rrethanat që ndihmojnë në thyerjen e rregullave në shoqëri. Nga ana tjetër, teoritë moderne për të identifikuar personin që shkel rregullat në shoqëri bazohen tek vetë personi devijant dhe tek mënyra se si reagon shoqëria ndaj devijimit, si ndodh procesi i etiketimit, si reagojnë devijantët ndaj etiketimit dhe kush etiketohet nga reagimi shoqëror.

Nisur nga ky arsyetim, mund të bëjmë një ndarje të teorive me bazë sociologjike në teori objektiviste dhe teori subjektiviste. Kështu mund të themi se teoritë objektiviste e përkufizojnë devijimin si shkelje të normës shoqërore[108]. Devijimi në këtë kuptim është një e dhënë objektive, që do të thotë se studiuesi mund ta identifikojë një akt si devijant përmes krahasimit midis vetë aktit dhe kodit normativ të zbatueshëm në një shoqëri të caktuar. Këto teori shpjegojnë devijimin si rezultat i kushtëzimit të faktorëve strukturorë, kulturorë dhe proceseve ndërvepruese brenda të cilave individët mbajnë një status devijues. Studiuesit i quajnë teoritë objektiviste edhe me emërtimin "teoritë e dakordësisë", sipas të cilave, rregullat mbi të cilat bazohet organizimi i jetesës në shoqëri gëzojnë dakordësinë e pjesës më të madhe të anëtarëve të shoqërisë dhe devijimi nga këto rregulla përbën një përjashtim. Ideologjia e këtyre teorive ka të bëjë me denoncimin e fakteve kriminogjene të fshehura mbrapa diskriminimit shoqëror por mjeti për ti ndrequr këto probleme është kryerja e reformave dhe jo revolucioni. Ndër teoritë e dakordësisë përmendim: teoria e ç'organizimit social; teoria e zonave kriminale ose ekologjike; teoria e anomisë; teoria e lidhjeve të diferencuara; teoria e identifikimit të diferencuar; teoria e konflikteve kulturore; teoria e nenkulturave; teoria e neutralizimit

[108] Sociologjia e së drejtës fokusohet në themelet e urdhrave juridikë, modelet e ndryshimit ligjor dhe rolin e ligjit në jetën shoqërore. Përkufizimet e sjelljes si kriminale ndryshojnë shumë në kohë dhe vende të ndryshme. Për shkak se ligjet përcaktojnë se çfarë është kriminale ose që i nënshtrohet ndëshkimit, studimi i procesit të krijimit të ligjit dhe i efektit të ligjit mbi sjelljet njerëzore është me interes të veçantë për sociologët. Ligji ndryshon vazhdimisht pasi ndikohet nga kontekstet shoqërore. Ai është njëkohësisht mundësues dhe kufizues, duke "shpërndarë" të drejta dhe detyrime. Ndryshimi i ligjeve, në shumë shoqëri, është i lidhur me ndryshime në çështje të tilla si statusi i gruas, të miturve dhe tërinjve, pakicave kombëtare dhe racore, të varfërve dhe të jetimëve. Të kuptuarit se si dhe pse ndodhin ndryshime të tilla janë sfida kryesore për sociologët e ligjit. Shih, J. F. Short, Jr., *Crime: Sociological Aspects*, në Revistën "International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences", Elsevier Science Ltd., 2001.

Koncepti subjektivist, nga ana tjetër, e përcakton devijimin si një akt që identifikohet nga pjesëtarët e shoqërisë dhe që është jo në përputhje me rregullat shoqërore. Pra, në këtë konceptim është reagimi social ai që përcakton nëse një akt është devijant apo jo. Teori të tilla njihen nga studiuesit edhe me emërtimin teoritë e konfliktit[109], sipas të cilave, rregullat mbi të cilat bazohet organizimi i jetesës në shoqëri janë miratuar nga një klasë dominante minoritare dhe nuk shprehin nevojat e zakonshme të pjesës më të madhe të shoqërisë. Kriminaliteti nuk mund të eliminohet pa ndryshuar në mënyrë rrënjësore strukturën ekonomiko – sociale dhe pa përdorur zgjidhjen e revolucionit që do të shpinte në eliminimin e konfliktit të klasave dhe të padrejtësive dhe që do të zgjidhte edhe problemin e kriminalitetit. Ndër teoritë e konfliktit përmendim: teoria e etiketimit; kriminologjia radikale; kriminologjia kritike.

## 2. Teoria e ç'organizimit social

Bërthama e kësaj teorie qëndron në prishjen e "unitetit të grupit" që vjen si pasojë e ndryshimeve dhe paqëndrueshmërisë të provokuara nga industrializimi dhe nga fenomenet e lidhura me të (urbanizmi, kriza e strukturës së vjetër patriarkale, kriza e familjes), të cilët janë përgjegjësit kryesore të shpërbërjes së shumë institucioneve (familja, shkolla, kulti fetar, miqësia, shoqëria) që janë historikisht përgjegjëse për vendosjen e marrëdhënieve të organizuara dhe bashkëpunuese ndërmjet grupeve brenda komunitetit. Si pasojë e kësaj shpërbërje institucionale u prishën edhe shumë ekuilibra mbi të cilat bazoheshin rregullat e mëparshme dhe

[109] Për të kuptuar kriminologjinë e konfliktit është e nevojshme të bëhet dallimi midis perspektivave të konsensusit dhe konfliktit për kontratën shoqërore. Perspektiva e konsensusit argumenton se shoqëria është e organizuar për të përfaqësuar interesat e shumicës së anëtarëve të saj dhe se ajo merr vendime dhe krijon politika që bazohen në vullnetin e njerëzve dhe janë të dizenjuara për të çuar përpara të mirën e përbashkët. Edhe pse perspektiva e konsensusit pranon praninë e grupeve konkurruese në çdo shoqëri, përkrahësit e kësaj perspektive besojnë se shteti ndërmjetëson ndërmjet grupeve konkurruese të interesit dhe se shoqëria pasqyron normat dhe interesat e shumicës së anëtarëve. Perspektiva e konfliktit argumenton se funksioni i shtetit nuk është të ndërmjetësojë midis grupeve të interesit konfliktualë të pashmangshëm, por të përfaqësojë interesat dhe të pasqyrojë vlerat e grupit ose grupeve që kanë fuqi të mjaftueshme për të kontrolluar shtetin. Shih, P. Black, *Conflict Theories of Crime*, në Revistën "The Encyclopedia of Criminology and Criminal Justice", First Edition. Edited by Jay S. Albanese, 2013.

etika sociale. Sipas këtij orientimi, individi që jeton në një strukturë të paqëndrueshme dhe në ndryshim të shpejtë dhe të vazhdueshëm e humbet mundësinë të veprojë mbi bazën e parametrave të vjetër, duke u bërë njësoj si shoqëria në të cilën jeton, i ç'organizuar në sjelljen e tij, dhe për rrjedhojë përgjegjës për sjellje të parregullta[110].

Sipas William I. Thomas dhe Florian Znaniecki, të Universitetit të Çikagos, ç'organizimi social që vjen si pasojë e takimit të kulturave dhe stileve të jetës të ndryshme është i aftë për të nxitur dhe shumëfishuar tensione dhe konflikte kulturore, pamundësi orientimi dhe margjinalizim duke sjellë si pasojë devijim të rregullave shoqërore[111]. Në bazë të kësaj teorie, problemi shfaqet, jo vetëm sepse për shkak të ndryshimeve shoqërore shumë norma nuk ushtrojnë më funksionin e tyre por edhe kur prishet uniteti i shoqërisë për shkak se modelet e vjetër të sjelljes nuk janë më të përshtatshëm për shoqërinë e re që është formuar[112]. Sipas një studimi të bërë midis llojeve të komuniteteve në Çikago ka rezultuar se në zonat me përqindje të ulët të kriminalitetit ka më shumë uniformitet, qëndrueshmëri, universalitet të vlerave dhe qëndrimeve për çështje të rëndësishme si kujdesi ndaj fëmijëve apo zbatimi i ligjit, ndërsa në zonat me përqindje të lartë të kriminalitetit janë zhvilluar sisteme të vlerave morale konkurruese dhe konfliktuale. Konflikti i normave dhe i rregullave që veprojnë në një shoqëri është përgjegjës për ç'organizimin e shoqërisë duke sjellë si pasojë edhe rritjen e kriminalitetit.

Bazuar në sa më sipër, ne jemi të mendimit se konflikti i normave vihet re më së shumti kur: socializimi mungon ose është me probleme (mospërshtatja në shoqëri e grupeve të ndryshme, psh. emigrantët), dhe në këtë rast ekziston mundësia e përplasjes sidomos me ato norma që mbrojnë kryesisht të drejtat e klasave të larta; ndëshkimet ndaj disa krimeve janë të papërshtatshme dhe si rrjedhoje ekziston

---

110 J. R. Porter, J. Cappellan, S. Chintakrindi, *Social Disorganization Theory*, në Revistën "The Encyclopedia of Crime and Punishment", 2015.

111 Shih, G. Sinatti, *The Polish Peasant Revisited Thomas and Znaniecki's Classic in the Light of Contemporary Transnational Migration Theory*, në Revistën "Sociologica", Italian journal of sociology online, N. 2, 2008.

112 Shih, G. M. Rhineberger, *Social Disorganization, Disorder, Social Cohesion, Informal Controls, and Crime: A Reformulation and Test of Systemic Social Disorganization Theory*, A Dissertation Submitted to the Faculty of The Graduate College in partial fulfillment of the requirements for the Degree of Doctor of Philosophy, Department of Sociology, Western Michigan University, Kalamazoo, Michigan, December 2003.

pamjaftueshmëri në frikësimim ndaj këtyre ndëshkimeve që gjenden në disa norma; ekzistenca e një aparati gjyqësor ose policor jo-efiçient ose i korruptuar, që edhe pse përballë ekzistencës së ndëshkimeve të ashpra, neutralizon efikasitetin e tyre pasi ligjet nuk zbatohen.

Sipas një mendimi doktrinar, teoria e çorganizimit social ka përjetuar një rilindje vitet e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për shkak të deindustrializimit në rritje të qyteteve qendrore, rritjes së lëvizshmërisë së klasës së mesme, izolimit në rritje të të varfërve, rritjes së popullsisë emigrante në shumicën e qyteteve amerikane, rigjallërimit të rrjeteve sociale, përzierjes së komunitetit, nënkulturave të lagjeve dhe kontrollit social. Shfaqja e të gjitha këtyre dukurive ka bërë që rëndësia e teorisë është ndoshta edhe më e fortë sot sesa kur u propozua për herë të parë shumë dekada më parë. Fatkeqësisht, pak studime kanë shqyrtuar efektet e mundshme të këtyre zhvillimeve. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e punës së çorganizimit social është fokusuar në zonat urbane pa marrë parasysh zbatueshmërinë e teorisë në zonat jourbane[113].

## 3. Teoria e zonave kriminale

Shkolla e Çikagos[114] është shkolla e parë kriminologjike që përdori termin “zona kriminale” për të treguar ato lagje të qytetit nga të cilat zhvillohet dhe përhapet kriminaliteti. Sipas përkrahësve të kësaj teorie, në çdo qendër urbane ka zona me karakteristika të veçanta mjedisore, në të cilat synojnë të përqendrohen individë që kryejnë një jetesë jo sipas rregullave, për shkak se gjejnë një mjedis mbrojtës dhe

---

[113] C. E. Kubrin, R. Weitzer, *New Directions in Social Disorganization Theory,* në Revistën “Journal of Research in Crime and Delinquency”, 2023.

[114] Aspekti më i rëndësishëm, për të cilin kjo shkollë ka kontribuar më shumë ndër vite është përpjekja e bërë për të bashkuar teorinë dhe kërkimin duke i siguruar sociologjisë së Çikagos një pozitë dominuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Që nga fillimet e saj, Shkolla e Çikagos ka ndjekur dy prioritete: së pari, institucionalizimin e sociologjisë si një disiplinë shkencore dhe autonome për të arritur në zhvillime konceptuale novatore; së dyti, interpretim të realitetit dhe, mbi të gjitha, të “problemeve të reja sociale” që kanë lindur pas proceseve të industrializimit, urbanizimit dhe emigrimit që kanë ndryshuar ndjeshëm metropolet e mëdha të Amerikës së Veriut - dhe për rrjedhojë edhe qytetin e Çikagos - shpesh duke rezultuar në situatat e vështirësisë dhe margjinalitetit social. Shih, I. Acocella, *La scuola di Chicago: tra innovazione e tradizionalismo,* në Revistën “Quaderni di Sociologia”, N. 53, 2010, Neuroscienze e scienze sociali.

lejues të kryerjes së sjelljeve kriminale. Kështu, sipas një studimi të bërë në Nish (Serbi), rezultoi se krimi është i përqendruar në zonat qendrore të qytetit, në vende të populluara me njerëz (qendra tregtare, qendra biznesi, tregje të hapura, stacione autobusi, parqe, dyqane, kazino). Në përgjithësi, shkalla e krimit në zonat qendrore të qytetit është më e lartë se shkalla e krimit në zonat urbane dhe periferike. Rezultatet e studimit tregojnë gjithashtu se shpërndarja e krimit ndryshon me kalimin e kohës dhe se përqendrimi i krimit përhapet nga zonat qendrore të qytetit në zonat urbane dhe periferike, ku krimi është në rritje[115].

Pavarësisht përsa arsyetuar më sipër, mund të ndodh që zonat me përhapje më të madhe të kriminalitetit të mos reflektojnë të njëjtën gjendje për ndonjë vepër penale të veçantë dhe kjo për shkak se zonat kriminale nuk mund të përcaktohen vetëm nga pozicioni gjeografik ose e thënë ndryshe nga vendndodhja e zonës por edhe nga përbërja, homogjene apo heterogjene, e popullsisë që banon në atë zonë[116]. Kështu, për shembull, mbi bazën e një studimi të bërë në qytetin e Sacramentos (SHBA), në lidhje me krimet që kryen për shkak të paragjykimit[117] rezultoi se lagjet homogjene ose pothuajse homogjene të njerëzve me ngjyrë të bardhë që përjetojnë një fluks prurjesh njerëzish jo me ngjyrë të bardhë kanë shkallën më të lartë të krimeve të

[115] D. Stanković, *Ecology of crime in urban and suburban area: Spatial patterns of crime in the city of Niš (Serbia)*, në Revistën "FACTA UNIVERSITATIS", Series: Law and Politics, Vol. 18, N. 1, 2020, fq. 37-52.

[116] Shih, V. Hysi, *Kriminologjia*, Kristalina-KH, Tiranë, 2010, fq. 115-116. Shkak i krimit janë kushtet "patologjike të zonave ose grupeve të veçanta". Zonat urbane janë më të prirura për të pasur një nivel krimi më të lartë se zonat rurale. Brenda zonave urbane ka zona "të nxehta" të krimit.

[117] Një krim që kryhet për shkak të paragjykimit përkufizohet nga FBI si një vepër penale e kryer kundër një personi ose kundër pronës dhe që është e motivuar, tërësisht ose pjesërisht, nga paragjykimi i autorit të veprës penale për shkak të racës, fesë, paaftësisë, grupit të origjinës etike/kombëtare ose orientimit seksual. Shembull: ndërsa ishte duke ngarë makinën, një mashkull i bardhë i preu rrugën një makine të drejtuar nga një mashkull hispanik. Si përgjigje ndaj kësaj manovre të gabuar, mashkulli hispanik ndoqi makinën e drejtuar nga mashkulli i bardhë dhe kur ky i fundit ndaloi, mashkulli hispanik doli nga makina e tij dhe iu afrua makinës që drejtohej nga mashkulli i bardhë duke bërtitur "*…nuk duhet të ngatërrohesh me meksikanët…*" dhe më pas ai vazhdoi të sulmonte mashkullin e bardhë. Shembull: Teksa luante në një lagje në periferi të qytetit, një fëmijë i vogël i bardhë rrëzoi aksidentalisht kutinë e gazit të një fëmije afrikano-amerikan duke derdhur përmbajtjen e saj. Nëna e fëmijës së bardhë iu afrua nënës së fëmijës afrikano-amerikan për të shpjeguar ngjarjen dhe për të kërkuar falje për fatkeqësinë. Gruaja afrikano-amerikane i bërtiti gruas së bardhë "*…nxirre by… tënde të bardhë që ta godas me gjithë forcën…*". Gruaja afrikano-amerikane më pas vazhdoi të sulmonte gruan e bardhë. Oficerët e policisë raportuan se gruaja afrikano-amerikane kishte një histori të "shkaktimit të telasheve" në lagje. Shih, J. J. Nolan, J. McDevitt, S. Cronin, A. Farrell, *Learning to See Hate Crimes: A Framework for Understanding and Clarifying Ambiguities in Bias Crime Classification*, në Revistën "Criminal Justice Studies", Vol. 17, N. 1, March 2004, fq. 91–105.

paragjykimit: Nga ana tjetër, lagjet me një përzierje grupesh etnike priren të kenë nivele më të ulëta të krimeve të paragjykimit[118].

Sipas shumicës së studiuesve, mjedisi në të cilin individi jeton përbën faktorin më të rëndësishëm të shfaqjes së sjelljeve kriminale, të paktën për atë që njihet si kriminalitet i zakonshëm. Ndër përfaqësuesit e kësaj shkolle (Shkolla e Çikagos) që mbrojnë këtë teori përmendim: Robert E. Park, Ernest W. Burgess, Roderick D. McKenzie, Clifford R. Shaw, Henry D. McKay. Sipas këtij mendimi kriminologjik, zonat kriminale janë zona me ç'organizim të lartë shoqëror dhe një lëvizje të madhe të banorëve; janë vende tranzit, nga ku dëshërojnë të kalojnë ajo pjesë e popullsisë që është në kërkim të stabilitetit dhe mundësive për ngritjen shoqërore. Mjedise të tilla e lehtësojnë së tepërmi zhvillimin, mësimin dhe transmetimin e sjelljeve kriminale. Ernest Burgess, në mbështetje të këtij mendimi, kreu një studim duke përcaktuar "zonat" e ndryshme të Çikagos mbi bazën e pesë rrathëve koncentrikë që mbulonin të gjithë qytetin. Në qendër të kësaj plan-vendosje kishte një zonë biznesi me banka dhe zyra. Jashtë saj ndodheshin zona të ndryshme rezidenciale dhe ajo që u quajt "zona e tranzicionit" ndodhej pak përtej zonës qendrore të biznesit. Pas kësaj vinte zona e shtëpive të punëtorëve, më pas zona e banimit dhe në fund zona e udhëtarëve. Zona e tranzicionit ishte zona ku ndodhnin më së shumti krime dhe kishte shumë probleme të tjera sociale. Clifford Shaw dhe Henry McKay, dy studiues të lidhur ngushtë me Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Çikagos, zhvilluan qasjen e Burgess për të shqyrtuar modelet e krimit të të miturve në Çikago. Në "zonën e tranzicionit" banesat ishin zakonisht të shkatërruara dhe banorët, në të shumtën e rasteve, ishin emigrantë të rinj dhe pjesa tjetër individë që nuk kishin mjetet e nevojshme për të jetuar diku tjetër në qytet. Ata zbuluan se në këtë zonë, me një popullsi kalimtare që nuk ishte në gjendje të hidhte rrënjë, mbizotërronin ato vlera dhe ato norma që i orientonin individët drejt sjelljeve kriminale. Në mungesë të kontrolleve të forta nga familja dhe komuniteti, të miturit mund të përfshiheshin lehtësisht në aktivitete kriminale. Gjithashtu, ata treguan se

[118] R. Grattet, *The Urban Ecology of Bias Crime: A Study of Disorganized and Defended Neighborhoods*, në Revistën "Social Problems", Volume 56, Issue 1, 1 February 2009, fq. 132–150.

shkalla e krimit ishte më e lartë në “lagjet e varfëra”, pavarësisht se kush jetonte në ato zona, dhe përdorën këto gjetje për të argumentuar se ishte natyra e lagjeve, dhe jo individët apo grupet e veçanta që jetonin në to, ajo që përcaktonte nivelin e përfshirjes në kriminalitet[119].

## 4. Teoria e anomisë

Sipas një mendimi doktrinar, “anomia” nuk është “shpikje” e sociologjisë por është një term që ka ekzistuar historikisht në mishërime të ndryshme që datojnë që nga Greqia e lashtë. Etimologjikisht, koncepti rrjedh nga greqishtja “*anomia*”, që përmban termin rrënjësor “*nomos*”, dhe fjalë për fjalë do të thotë mungesë ligji ose, në mënyrë më të zgjeruar do të thotë çrregullim ose parregullsi. Siç u prezantua për herë të parë në antikitetin grek, termi jo vetëm që i referohet një gjendjeje faktike të punëve që tregon mungesën e rregullit, por gjithashtu mbart me vete një gjykim etik për padëshirueshmërinë e asaj gjendje[120]. Sipas një mendimi tjetër, “anomia” nuk është vetëm një “epidemi” që sjell shkatërrim të trupit dhe vuajtje të tmerrshme të shkaktuara nga përhapja e infeksionit por është edhe kaos që pason dobësimin e shtetit, shpërbërjen e autoriteteve, strukturave shoqërore dhe mentaliteteve[121].

Sipas Émile Durkheim, “njeriu është një qenie që nuk ka moral” pavarësisht se jeton në një shoqëri që bazohet mbi rregulla të caktuara të moralit dhe kjo për faktin se kur ai është në një grup të caktuar shoqëror zbaton disa rregulla të caktuara të moralit dhe kur ndryshon grup shoqëror zbaton rregulla të tjera. Bashkimi i individëve në grupe shoqërore ose e thënë ndryshe “solidariteti shoqëror” midis individëve të një grupi është dy llojesh: “solidaritet mekanik”, sipas të cilit theksi

[119] AA.VV., *Theories of Crime*, Edited by I. Marsh, 1st Edition, Routledge, London, 2006, Chapter 4: Sociological Explanations for Criminal Behaviour.

[120] Filozofët grekë përcaktuan edhe kualifikimin e një personi si “anomik”, duke iu referuar, pikë së pari, një mungese të karakterit personal siç është ndjeshmëria njerëzore, në radhë të dytë mospërfilljes së normave fetare duke e vënë theksin tek mungesa e mëshirës dhe në fund mosrespektimi i normave të traditës zakonore që ndikonte në krijimin e njeriut të padrejtë. Shih, M. Deflem, *Anomie: History of the Concept*, në Revistën “International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences”, 2nd edition, Volume 1, 2015.

[121] S. Serpa, C. M. Ferreira, *Anomie in the sociological perspective of Émile Durkheim*, në Revistën “Sociology International Journal”, Volume 2, Issue 6, 2018, fq. 689–691.

vihet mbi parimin e ngjashmërisë dhe, ky lloj solidariteti, përveçse bashkon individët në shoqëri, nxit kohezionin e brendshëm dhe ndërgjegjësimin e fortë kolektiv, ushtron trysni të fuqishme mbi individët nëpërmjet mbizotërimit të zbatimit të ligjeve represive; "solidariteti organik", që do të thotë ndarje e punës dhe specializim i funksioneve. Ajo që i bashkon individët është ndërvarësia e funksioneve sociale dhe për këtë arsye ndërgjegjësimi kolektiv është i dobët. Qëllimi i zbatimit të ligjit, më shumë se të ndëshkojë ata që kryejnë një krim, është të rivendosë rendin që është prishur[122]. Durkheim është i mendimit se shkaqet sociale që kanë çuar në ndarjen e punës në shoqëri burojnë nga një kombinim faktorësh që kanë për bazë rritjen e numrit të popullsisë dhe ndërvarësinë më të madhe të individëve në hapësirën sociale. Morali që i korrespondon shoqërisë së re që është krijuar ka pësuar regres duke lënë një hapësirë boshe, ende të paqartë në ndërgjegjen tonë. Besimi i njerëzve është tronditur, tradita ka humbur dominimin e saj, gjykimi individual është emancipuar dhe është shkëputur nga gjykimi kolektiv dhe për këtë arsye shoqëria e re që u krijua papritur nuk mundi të organizohej plotësisht por mbi të gjitha nuk u organizua në atë mënyrë që do të kënaqte nevojën për drejtësi që kërkohet me ngulm nga të gjithë individët[123].

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se për Durkheimin, anomia përfaqëson mungesën e normave që synojnë rregullimin e sjelljes shoqërore të individëve ose të bashkësive të ndryshme ku individët marrin pjesë. Në këtë kuptim, i përhapur në sociologjinë bashkëkohore, termi përcakton një gjendje objektive të mungesës normative, të konstatueshme në mënyrë empirike nga vëzhgues të shumtë, dhe jo gjendjen subjektive të atyre që janë të ekspozuar ndaj anomisë, ose atyre që nuk i perceptojnë ose pranojnë normat që madje ekzistojnë në bashkësinë ku bën pjesë. Etapat nëpër të cilat kalon procesi i socializimit synojnë të drejtojnë individin drejt respektimit të rregullave në shoqëri ose e thënë ndryshe në krijimin e një stili jetese të bazuar mbi rregulla dhe norma. Sipas Émile Durkheim, anomia shfaqet si

[122] S. Segre, *A Durkheimian Theory of Social Movements*, në Revistën "International Journal of Social Science Studies", Vol. 4, N. 10, 2016.
[123] E. Durkheim, *The Division of Labor In Society* (Translated by George Simpson), Free Press, New York, 1960.

pasojë e prezencës në shoqëri të normave të paqarta, jo-koherente dhe kontradiktore. Në një mjedis në të cilin marrëdhëniet ndërpersonale janë të strukturuara mbi bazën e rregullave të produktivitetit dhe në mungesë të solidaritetit njerëzor, njeriu kupton kontrastin që ekziston ndërmjet përkatësisë natyrale të grupit shoqëror dhe nevojës për t'u përfshirë në role produktive dhe në dinamikat e tyre. Nga shtytje të tilla kontradiktore do të prodhohet një jetesë në kaos (anomi)[124].

Mbi pazën e parimeve të anomisë, Durkheim është munduar të shpjegojë edhe shkaqet që i shtyjnë njerëzit të kryejnë vetëvrasje. Sipas tij, shtimi i numrit të vetëvrasjeve është i lidhur ngushtë me zhvillimin e shpejtë të shoqërisë që ka sjellë si pasojë ndryshimin e strukturës shoqërore dhe, për më tepër, rritjen e egoizmit brenda natyrës njerëzore[125]. Integrimi i grupeve fetare, familjare dhe politike të cilave i përket një individ, sjell si pasojë rritjen e imunitetit të tij ndaj vetëvrasjes dhe kjo për shkak se kur shoqëria është e integruar fort, ajo mban individët nën kontrollin e saj ... dhe kështu i ndalon ata të disponojnë me dashje veten e tyre. Egoizmi dhe anomia burojnë nga prania e pamjaftueshme e shoqërisë tek individët por sfera e mungesës së saj nuk është e njëjtë në të dyja rastet: në vetëvrasjen egoiste ajo është e mangët në veprimtarinë e vërtetë kolektive ndërsa anomia rezulton nga rregullimi i munguar i veprimtarisë së njeriut brenda shoqërisë ku ai jeton. Egoizmi dhe anomia kanë një ngjashmëri të veçantë ndërmjet tyre dhe se është pothuajse e pashmangshme që egoisti të ketë një prirje ndaj kaosit dhe kjo për faktin se, duke qenë i shkëputur nga shoqëria, nuk ka ndikim të mjaftueshëm mbi të dhe për ta rregulluar atë.

Sipas Robert K. Merton, proceset e socializimit kanë për objektiv përshtatjen e individit në shoqëri duke e ndihmuar të zhvillojë një stil jetese të rregulluar sipas

---

[124] S. R. Marks, *Durkheim's Theory of Anomie*, në Revistën "American Journal of Sociology", Vol. 80, N. 2, 1974, fq. 329-363, Published by: The University of Chicago Press.

[125] Viktimat e vetëvrasjes janë në një numër të vogël dhe secila prej tyre e kryen veprën e saj veç e veç, pa e ditur se të tjerët po bëjnë të njëjtën gjë dhe, megjithatë, për sa kohë që shoqëria mbetet e pandryshuar, numri i vetëvrasjeve mbetet i njëjtë. Prandaj, të gjitha këto manifestime individuale, sado të pavarura nga njëra-tjetra të duken, me siguri duhet të rezultojnë nga një shkak i vetëm ose nga një grup i vetëm shkaqesh, që dominojnë individët. Kështu për shembull, le të supozojmë se çdo vit ka përafërsisht të njëjtin numër martesash të pakënaqura, falimentime, ambicie të zhgënjyera, raste varfërie dhe për këtë arsye një numër i caktuar individësh do të arsyetojnë përgjithësisht në të njëjtën mënyrë kur përballen me të njëjtat rrethana. Shih, É. Durkheim, *Suicide: A study in sociology*, Translated by John A. Spaulding, George Simpson, edited with an introduction by George Simpson, published in the Taylor & Francis e-Library, 2005.

normave shoqërore. Anomia lind si pasojë e përpjesëtimit të zhdrejtë midis objektivave kulturore dhe mjeteve të ligjshme për arritjen e tyre[126]. Nisur nga ky këndvështrim, Mertoni identifikon edhe modelet e mundshme të sjelljes individuale[127]: Individi pranon përdorimin e mjeteve të ligjshme që do të përdorë për arritjen e objektivave duke u përshtatur në shoqëri; Individi refuzon mjetet e ligjshme por jo objektivat dhe mjetet e paligjshme për ti arritur; Individi dështon në arritjen e objektivave duke braktisur garën, i mungon frymëzimi dhe nuk ka dëshirë të luftojë; Individi heq dorë dhe kjo është përgjigjja devijante e individit që braktis ndeshjen duke refuzuar objektivat dhe mjetet (vetëvritet, pi alkol ose drogë); Individi rebelohet, grupe revolucionarësh që duan të ndryshojnë shoqërinë, refuzojnë objektivat dhe mjetet e paracaktuar duke përqafuar objektiva të reja dhe duke miratuar strategji që synojnë ndjekjen e tyre.

## 5. Teoria e neutralizimit

Teoria e neutralizimit kërkon të shpjegojë paradoksin e devijantëve që shkelin normat në të cilat ata besojnë duke vënë në dukje faktin se ata kanë pak ose aspak faj. Këta devijantë mbrojnë vlerësimin që ata i bëjnë situatës dhe neutralizojnë vetëfajësimin duke përdorur arsyetime për të bindur veten se është e pranueshme që në situatën e tyre aktuale të përfshihen në sjellje që tradicionalisht konsiderohet imorale. Normat e shkelura nuk denoncohen tërësisht por vendosen për një moment në kllapa në mënyrë që një shkelës të ndihet i lirë për t'i shkelur ato[128].

Sipas Gresham Sykes dhe David Matza, pjesa më e madhe e aktivitetit kriminal është e lidhur me mundësinë për të justifikuar aktin e jashtëligjshëm, që

[126] Sipas Mertonit, kultura e një shoqërie pasqyron një nivel të caktuar të konsensusit dhe ndarjes së vlerave, ndërsa tendencat anomatike krijohen nga shpërndarja e pabarabartë e mjeteve për të arritur qëllimet e theksuara kulturalisht. Shih, S. Marwah, M. Deflem, *Revisiting Merton: Continuities in the theory of anomie and opportunity structure*, në "Sociological Theory and Criminological Research: Views from Europe and the United States Sociology of Crime, Law and Deviance", Volume 7, Edited by Mathieu Deflems, fq. 57–76.
[127] R. K. Merton, *Social Structure and Anomie*, në Revistën "American Sociological Review", Vol. 3, N. 5, 1938, Published by: American Sociological Association, fq. 672-682.
[128] M. Kaptein, M. Van Helvoort, *A model of neutralization techniques*, në Revistën "Deviant Behavior", Vol. 40, N. 10, Taylor & Francis Group, 2019, fq. 1260-1285.

konsiderohet i vlefshëm nga keqbërësi por jo nga sistemi juridik dhe normat shoqërore. Paaftësia për të dominuar situatat dhe mjedisin, pasiviteti, domosdoshmëria për të shkarkuar përgjegjësitë nga vetja, shënojnë fillimin e procesit psikologjik që e shpie individin të neutralizojë konfliktin që lind si pasojë e shkeljes së normës shoqërore. Në këtë mënyrë, individi kërkon të justifikojë sjelljen e tij të jashtëligjshme duke e larguar nga vetja përgjegjësinë e kësaj sjellje[129].

Ndër teknikat e neutralizimit që justifikojnë kryerjen e sjelljes kriminale mund të përmendim: Mohimin e përgjegjësisë personale, sipas së cilës shkelësi jep të kuptojë se është i sëmurë ose se është i paaftë për të kontrolluar sjelljen e tij në situata të caktuara ose pohon se veprimet e tij janë për shkak të forcave jashtë kontrollit personal si për shembull prindërit që nuk i duan, shokët e këqij ose jetesa në një lagje e varfër[130]; Minimizimin e dëmit të shkaktuar, rrezikshmëria e sjelljes vlerësohet duke patur parasysh masën e dëmit të vuajtur nga viktima; Fajësimi i viktimës, shkelësi mendon se është viktima ajo që me sjelljen e saj e ka merituar dëmin e pësuar; Fajësimi i gjyqtarëve, gjyqtarët nuk janë të paanshëm dhe hetuesit janë të korruptuar; Përkrahje e detyrimit të besnikërisë, besnikëria ndaj vlerave të grupit është më e fortë dhe më mbizotëruese në krahasim me lidhjet dhe detyrimet ndaj shoqërisë.

## 6. Teoria e etiketimit

Nëpërmjet teorisë së etiketimit studiuesit mundohen ti japin përgjigje pyetjes se përse njerëzit sillen në një mënyrë të caktuar kur shoqëria refuzon një individ, ose e thënë me fjalë të tjera kur shoqëria i vendos individit një etiketim[131].

Etiketimi i sjelljeve devijante dhe në veçanti etiketimi i sjelljeve kriminale janë të lidhura me “stigmën”[132], që do të thotë se sjellja sipas kulturës së përgjithshme

[129] G. Sykes, D. Matza, *Techniques of neutralization: A theory of delinquency*, në Revistën “American Sociological Review”, Vol. 22, N. 6, 1957, Published by: American Sociological Association, fq. 664-670.
[130] E. E. LaBeff, *Criminological theories and techniques of neutralization*, në Revistën “Creative Sociology”, Vol. 11, N. 1, 1983, fq. 29-34.
[131] A. Jovanoski, A. Rustemi, *Theory of Labeling: Contemporary Concepts of the Sociological Understanding of Deviance*, në Revistën “International Journal of Scientific & Engineering Research”, Vol. 12, N. 7, 2021.

është përzier me imazhe ose stereotipe specifike që janë negative dhe që përbëjnë etiketim devijues[133]. Stereotipet negative të "personazheve" kriminalë manifestohen në jetën e përditshme dhe kulturën kryesore nëpërmjet mënyrave të ndryshme, përmes filmave, librave, medias masive dhe madje edhe në diskutimet e përditshme, të cilat i portretizojnë kriminelët si të lindur të pamoralshëm, dinakë dhe thelbësisht të ndryshëm nga njerëzit e tjerë. Shembuj të tillë na kujtojnë se mësimi i stereotipeve kriminale është pjesë e socializimit të fëmijërisë. Individët e etiketuar si delikuentë priren të lihen mënjanë si thelbësisht të ndryshëm nga të tjerët dhe ata priren të lidhen me stereotipe të tipareve ose karakteristikave të padëshiruara[134].

Fillimi i procedimit penal dhe gjykimi i një të mituri për një vepër penale mund të krijojë ose të rrisë "reputacionin" e tij si kriminel në komunitetin ku i mituri jeton, veçanërisht në mesin e adoleshentëve të tjerë në shkollë apo edhe midis prindërve në komunitet. Në momentin që një akt devijimi bëhet publik dhe përcaktohet si imoral, në të vërtetë, theksohet karakteri imoral i vepruesit të atij akti. Për aq sa informacioni rreth ndëshkimit penal përhapet në të gjithë komunitetin, të tjerët do të priren ta përcaktojnë të miturin si një devijant kriminal[135].

Sipas një doktrine, përkufizimi i stigmës është i lidhur me praninë dhe konvergjencën e katër komponentëve të ndërlidhur: Së pari, njerëzit shikojnë dhe etiketojnë dallimet njerëzore; Së dyti, anëtarët e grupit kulturor dominues i lidhin personat e etiketuar me disa atribute të padëshirueshme; Së treti, grupet ose individët e etiketuar negativisht vendosen në kategori të dallueshme dhe të ndara nga ata që nuk janë stigmatizuar; Së katërti, si rezultat i tre komponentëve të parë, individët e

---

[132] Grekët e lashtë, të cilët kanë qenë të fortë në mjetet vizuale, e krijuan termin stigmë për t'iu referuar shenjave trupore të krijuara për të ekspozuar diçka të pazakontë dhe të keqe në lidhje me statusin moral të imazhit të krijuar. Shenjat vendoseshin në trup dhe reklamonin se bartësi ishte një skllav, një kriminel ose një tradhtar ose e thënë ndryshe, një person i njollosur që duhej shmangur dhe veçanërisht në vende publike. Në ditët e sotme ky term përdoret gjerësisht sipas kuptimit origjinal por, më shumë se për dëshmitë trupore përdoret për të treguar turpin apo "njollën në biografi" të personit. Shih, E. Goffman, *Stigma: Notes on the Management of Spoiled Identity*, Penguin Classics (Penguin Random House, UK), 2022.

[133] M. Clair, *Stigma*, në "Core Concepts in Sociology", 1st edition, edited by J. Michael Ryan, Wiley Blackwell, 2018.

[134] J. G. Bernburg, *Labeling theory*, në "Marvin D. Krohn, Alan Lizotte & Gina Penly Hall (eds), Handbook on Crime and Deviance", Springer Science + Business Media, 2009.

[135] J. G. Bernburg, M. D. Krohn, C. J. Rivera, *Official Labeling, Criminal Embeddedness, and Subsequent Delinquency: A Longitudinal Test of Labeling Theory*, në Revistën "Journal of Research in Crime and Delinquency" Vol. 43, N. 1, 2006, fq. 67-88.

etiketuar përjetojnë humbje të statusit. Procesi i vendosjes së stigmës, dhe rrjedhimisht menaxhimi, varet nga shkalla e aksesit të personit në pushtetin social, ekonomik dhe politik[136].

Sipas Howard S. Becker, kushdo që me sjelljen e tij thyen normat e krijuara nga grupi shoqëror dominues fiton statusin e *outsider*. Shkelësi është një individ të cilit etiketimi i është zbatuar me sukses: sjellja devijante është një sjellje që personat etiketojnë si të tillë[137].

Sipas studiuesve, klasa dominuese ushqen një perceptim të individit kriminel, të bazuar në sjelljet devijante të individëve që u përkasin shtresave më të ulta të shoqërisë, duke shpresuar të mbajnë të fshehura sjelljet e tyre devijante[138].

Edwin M. Lemert i ndan sjelljet devijante në devijancë primare dhe sekondare. Devijanca primare: shkelësi nuk është i tillë për shkak të sjelljes së tij por për shkak se shoqëria etiketon si të tillë këdo që ndërmerr veprime të caktuara, të ndaluara nga vetë shoqëria. Më pas mund të ndodhë që disa individë, sjelljet e të cilëve janë përcaktuar nga shoqëria si devijante, reagojnë mbi bazën e këtij etiketimi duke përsëritur sjellje të tilla. Në këtë rast, që përkon me devijancën sekondare, bëhet fjalë për konsolidimin e sjelljes devijante. Për rrjedhojë, në këtë rast shfaqen dyshime të arsyeshme në lidhje me funksionin riedukues të dënimit[139]. Fazat e kalimit nga devijanca primare tek devijanca sekondare janë: Devijanca primare; Ndëshkime shoqërore; Tjetër devijancë primare; Ndëshkime më të ashpra; Tjeter devijancë primare, mbas së cilës mund të fillojë të krijohet një ndjenjë armiqësie përkundrejt atij që jep dënimet; Toleranca ndaj sjelljeve të shkelësit hyn në krizë, fillon procesi i etiketimit të individit nga shoqëria; Reagim ndaj etiketimit dhe ndëshkimit shoqëror nëpërmjet përforcimit të sjelljes divijante; Pranim nga individi i etiketuar të statusit të tij të ri social si shkelës dhe përshtatja me të.

---

[136] A. M. Kusoë, *Stigma*, në “The Wiley Blackwell: Encyclopedia of Race, Ethnicity, and Nationalism”, John Wiley & Sons, Ltd, 2015.
[137] H. S. Becker, *Outsider: Studies in the sociology of deviance*, Free Press, New York, 1963.
[138] M. Zanetti, *Pregiudizio ed etichettamento: il ruolo dell’insegnante nello sviluppo di comportamenti devianti*, në Revistën “Formazione & insegnamento”, European Journal of Research on Education and Teaching, XVI-2-2018.
[139] B. Giovannoli, *L’importanza dei processi di stigmatizzazione nella formazione dell’identità criminale*, në Revistën “The Lab’s Quarterly: Il Trimestrale del Laboratorio”, Laboratorio di Ricerca Sociale, Dipartimento di Scienze Politiche, Università di Pisa, N. 3, 2015.

# KREU VI

## TEORIA EKONOMIKE E SJELLJES KRIMINALE

**Përmbajtja:** 1. Shpjegimi i sjelljes kriminale në bazë të teorisë ekonomike. – 2. Aktivitetet e jashtëligjshme dhe ndikimi i tyre në ekonomi. – 3. Efektet ekonomike të aktiviteteve të jashtëligjshme kriminale. – 4. Motivet që e vështirësojnë luftën kundër kriminalitetit.

### 1. Shpjegimi i sjelljes kriminale në bazë të teorisë ekonomike

Lidhja mes ekonomisë dhe kriminalitetit mund të studiohet nga disa këndvështrime, ndër të cilët mund të përmendim analizën e përfundimeve që dalin nga shpjegimi i sjelljes kriminale në bazë të teorisë ekonomike dhe analizën e pasojave të aktivitetit kriminal mbi sistemin ekonomik të një vendi[140].

Teoria ekonomike e sjelljes kriminale është formuluar nga fituesi i çmimit Nobël për ekonominë Gary Becker, sipas të cilit kriminelët janë qënie racionale që shtyhen për të vepruar mbi bazën e maksimizimit të mirëqënies së tyre[141]. E thënë ndryshe, çdo subjekt, i cili ka të drejtën e zgjedhjes në lidhje me kryerjen e një sërë sjelljesh,

[140] Për sa i përket këndvështrimit të dytë është e nevojshme të bëhet një ndarje e mëtejshme mes aktivitetit kriminal që ka efekt shpërndarës (i heq të mirat materiale disave për t'ua dhënë disa të tjerëve, për shembull: vjedhja, vjedhja e pasurisë me anë të dhunës, korrupsioni etj.) dhe aktivitetit kriminal që ka të bëjë me prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e të mirave dhe shërbimeve (për shembull: prostitucioni, kontrabanda, tregtimi i lëndëve narkotike etj.). Shih, S. Kurti, *Ekonomia dhe kriminaliteti*, Shtëpia botuese "Agimi", Tiranë, 2018.

[141] Teoria ekonomike e sjelljes kriminale e ekonomistit Gary Becker e vitit 1968 shërbeu si pikënisje për studime të mëtejshme të ekonomistëve të tjerë të cilët me punën e tyre "pushtuan" shkencën e kriminologjisë, duke përdorur modelin e tyre gjithëpërfshirës të sjelljes racionale individuale. Mbështetur në mendimin se preferencat individuale janë të qëndrueshme, modeli mund të përdoret për të parashikuar se si ndryshimet në probabilitetin dhe ashpërsinë e ndëshkimeve dhe në faktorë të ndryshëm socio-ekonomikë mund të ndikojnë në nivelin e kriminalitetit. Pavarësisht se individët që shkelin ligje të caktuara janë të ndryshëm nga ata që respektojnë të njëjtat ligje, të parët, ashtu si edhe të dytët, i përgjigjen stimujve (d.m.th., sanksioneve dhe kushteve ekonomike). Në të vërtetë, studime të shumta empirike konfirmojnë parashikimet e teorisë ekonomike. Shih, *The Economics of Crime and Punishment*, në https://masonlec.org/site/rte_uploads/files/JEP/Readings/Butler%20Economic%20Analysis%20for%20Lawyers%203rd%20ed/CH%20VII%20Crime.pdf.

bën zgjedhjen e tij të preferuar që do ti sjellë përfitime më të mëdha[142]. Teoritë e krimit të bazuara në modelin racional u propozuan qysh në shekullin e tetëmbëdhjetë nga studiuesit iluministë si Bentham dhe Beccaria. Sipas Bentham, përfitimi nga aktiviteti kriminal është forca që e shtyn njeriun drejt përfshirjes në kriminalitet, ndërsa dhimbja e dënimit është forca e përdorur për ta frenuar atë. Nëse përfitimi është më i madh, krimi do të kryhet dhe nëse dhimbja është më e madhe, krimi nuk do të kryhet[143]. Normalisht, ashtu si të gjitha teoritë e tjera që shpjegojnë kriminalitetin edhe kjo teori ka të metat e saj. E meta më e madhe është se në shpjegimin e zgjedhjes së sjelljes më frytdhënëse nuk mbahen parasysh elementë dhe motive të cilët nuk mund të shpjegohen nga analiza e teorisë ekonomike. Nëse sjelljet kriminale do ti ndanim në sjellje që bazohen mbi "pasione" dhe sjellje që bazohen mbi "interesa" mund të themi se teoria ekonomike merr në konsideratë vetëm pasojat që vijnë nga kryerja e sjelljeve të llojit të dytë. Si rrjedhim, kjo teori nuk mund të shpjegojë krime si vrasjet, dhunën në familje, marrëdhëniet seksuale etj. Gjithsesi edhe duke e mbështetur arsyetimin tonë vetëm në lidhje me faktorin "interes" mund të shkojmë larg dhe të kuptojmë më së miri natyrën e aktiviteteve kriminale.

Sipas Becker, për të zbatuar instrumentat ekonomik në studimin e sjelljes kriminale, mund të përdorim teorinë e zgjedhjes në kushtet e pasigurisë ose e thënë ndryshe teorinë e rrezikut[144]. Për këtë marrim në konsideratë një shembull të thjeshtë: Vendimin e një shoqërie tregtare për të deklaruar ose jo fitimin dhe për pasojë për të paguar ose jo tatimin mbi fitimin. Të mos deklarosh fitimin si pasojë e zhvillimit të aktivitetit ekonomik përbën një sjellje të jashtëligjshme që bën pjesë më së miri në përkufizimin e "sjelljes kriminale"[145]. Sjellja alternative e kësaj sjelljeje

[142] G. Rodano, *La teoria economica del comportamento criminale*, në Economia e criminalità, XXI Secolo, 2009.

[143] E. Eide, P. H. Rubin, J. M. Shepherd, *Economics of Crime*, në Revistën "Foundations and Trends in Microeconomics", Vol. 2, N. 3, Harvard University Press, Boston, 2006.

[144] A. Jacob, *Economic Theories of Crime and Delinquency*, në Revistën "Journal of Human Behavior in the Social Environment", 21, Taylor & Francis Group, 2011, fq. 270–283.

[145] Aktivitete kriminale do të konsiderohen jo vetëm ato aktivitete që kanë të bëjnë me prodhimin e të mirave dhe shërbimeve për të cilat ligji ndalon shitjen, shpërndarjen ose posedimin, por edhe ato aktivitete të cilat edhe pse janë të ligjshme realizohen nga subjekte të paautorizuar. Ndërsa si sjellje kriminale do të etiketohen të gjitha ato

përkon me rastin kur subjekti vendos të deklarojë fitimin dhe të paguajë tatimin mbi fitimin duke përballuar në këtë mënyrë një shpenzim të sigurt. Nëse subjekti do të provonte të bënte evazion fiskal, rrezikon të ndëshkohet nëse do të zbulohet nga inspektorët që kontrollojnë zhvillimin e aktivitetit tregtar të bizneseve. Për këtë arsye rezultati i zgjedhjes për të bërë evazion fiskal është i pasigurt dhe varet nga frekuenca e kontrolleve që bëhen nga inspektorët tatimorë. Nese subjekti është racional dhe neutral përkarshi rrezikut, zgjedhja e tij do të varet nga konfrontimi i këtyre dy alternativave: si rrjedhim nëse kostoja e të bërit evazion fiskal është më e vogël se kostoja (e sigurt) e alternativës për të paguar tatimin mbi fitimin, subjekti racional do të bëjë një zgjedhje "kriminale" duke kryer sjelljen e jashtëligjshme.

Në shembullin e mësipërm llogaritja është shumë e thjeshtë dhe varet nga tre numra: Tatimi mbi fitimin (X); Shuma e gjobës që duhet paguar ose masa e dëminit që parashikon ligji (Y); Probabiliteti që të realizohet kontrolli nga inspektorët e tatimeve (Z). Kostoja e "zgjedhjes jo kriminale", pagesa e tatami mbi fitimin, është pikërisht X. Ndërsa kostoja që pritet nga kryerja e sjelljes së jashtëligjshme (K) është një mesatare mes 0 (nëse subjekti arrin ti shpëtojë kontrolleve) dhe Y (nëse realizohet kontrolli). Si rrjedhim mesatarja përbëhet nga dy probabilitete dhe pikërisht kemi $K= 0 \times (1-Z) + Y \times Z= YZ$. Ky arsyetim na lejon të identifikojmë rastet në të cilat është më racionale të sillesh si "kriminel" dhe kjo përfshin të gjitha rastet kur $YZ < X$. Si rrjedhim mund të themi se në bazë të parimit të racionalitetit, kryerja e sjelljes kriminale është: në përpjesëtim të zhdrejtë me masën e gjobës që duhet paguar (masa e dënimit që parashikon ligji) dhe me numrin e kontrolleve të realizuara nga inspektorët tatimorë dhe; në përpjesëtim të drejtë me koston e "sjelljes jo kriminale", dmth, nëse numri i kontrolleve është i vogël dhe sasia e gjobës është e vogël, ndërsa tatimi mbi fitimin që duhet paguar është i madh atëherë kjo do të favorizonte kryerjen e sjelljes së jashtëligjshme.

Sipas themeluesit të kësaj teorie Gary Becker, disa persona bëhen "kriminel" jo për faktin se qëllimet dhe motivet që i shtyjnë ata për të vepruar janë të ndryshme

---

sjellje dhe aktivitete që janë të ndaluara nga ligji dhe si të tilla, nëse zbulohen, do të ndëshkohen mbi bazën e sanksioneve të parashikuara. Shih, S. Kurti, *Ekonomia dhe kriminaliteti*, Botimet "Agimi", Tiranë, 2018.

nga ato të njerëzve të tjerë, por për faktin se ndryshojnë kostot dhe përfitimet materiale që ata mund të kenë gjatë kryerjes së veprimeve të caktuara që ata ndërmarrin[146]. Ky përfundim vlen jo vetëm në rastin e parashikuar më sipër por edhe në të gjitha ato raste kur një subjekt gjendet përballë alternativës për të respektuar ose jo ligjin: kështu për shembull të ngasësh makinën në gjendje të dehur apo jo; të korruptosh një funksionar publik apo jo; të merresh me prodhim ose shpërndarje lëndësh narkotike ose me kontabandë apo jo; të kryesh apo jo një vjedhje ose një vjedhje me dhunë.

Rëndësia më e madhe e kësaj teorie qëndron në faktin se ajo shërben si udhërrëfyese për hartimin e një politike penale efikase në luftën kundër kriminalitetit. E thënë ndryshe është e mundur të ndikosh kryerjen e sjelljeve kriminale në qoftëse nëpërmjet politikave të caktuara arrihet të ndikohen kostot dhe përfitimet që janë në themel të këtyre sjelljeve: kështu për t'ju rikthyer shembullit të mësipërm, është e mundur të ndikohen sjelljet e jashtëligjshme ose duke zbatuar një dënim më të ashpër (duke rritur shumën e gjobës) ose duke rritur probabilitetin që evazori fiskal të kapet dhe të ndëshkohet duke krijuar një situatë ku është më e leverdisshme pagimi i tatimit mbi fitimin.

Kjo teori shpjegon një karakteristik tjetër të sjelljes kriminale, rastin kur një subjekt i caktuar vendos të shpërndajë burimet e tij qoftë në kryerjen e sjelljeve të ligjshme qoftë në kryerjen e sjelljeve të jashtëligjshme[147]. Kështu p.sh. në rastin e evazionit fiskal ka subjekte që deklarojnë gjithë të ardhurat e tyre dhe ka të tjerë që nuk deklarojnë asgjë, por nga ana tjetër ekziston një gamë e gjerë subjektesh që deklarojnë vetëm një pjesë të të ardhurave të tyre. Këta të fundit sillen në këtë mënyrë pasi kanë vendosur që të shpërndajnë burimet e të ardhurave të tyre në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme duke shpërndarë dhe zvogëluar në këtë mënyrë rezikun e portofolit që ata disponojnë. Edhe në këtë rast këta subjekte kryejnë një zgjedhje racionale që mban parasysh të gjitha ndëshkimet që do të ndërmerren në

[146] Shih, G. Backer, *Crime and Punishment: An Economic Approach*, në Gary S. Becker and William M. Landes, Essays in the Economics of Crime and Punishment, NBER: National Bureau of Economic Research, 1974.

[147] Për më shumë rreth këtij argumenti shih, S. Giacomelli, G. Rodano, *Denaro sporco: Economie criminali, politiche di contrasto e ruolo dell'informazione,* Roma, 2001, fq. 37.

rastet e zbulimit të shkeljeve të ndryshme, përfshi këtu edhe rastin e kryerjes së evazionit fiskal. Përsa argumentuar më sipër, mund të themi se sa më i vogël të jetë ndëshkimi ose sa më i vogël të jetë probabiliteti i zbulimit të evazionit aq më i madh do të jetë evazioni.

Sipas përkrahësve të kësaj teorie, subjekti kriminal nuk është një qënie devijante i prekur nga probleme psikike ose probleme të tjera por është një njeri normal që zgjedh ti dedikohet tërësisht ose pjesërisht një aktiviteti të caktuar të jashtëligjshëm të diktuar nga përllogaritja e përfitimeve dhe humbjeve që do të ketë si pasojë e kryerjes së këtij aktiviteti. Duke nisur nga ky fakt të gjithë ne jemi potencialisht të prirur për të kryer në raste të caktuara sjellje kriminale: për shembull të gjithëve na ka rënë rasti të parkojmë atje ku nuk lejohet ose të hyjmë në kundravajtje, ose të mos deklarojmë ndonjë element sado të vogël të të ardhurave që disponojmë.

Ashtu siç e pamë pak më lart llogaritja e përfitimeve varet nga dy variabla: Y (shuma e gjobës që duhet paguar) dhe Z (probabiliteti që të realizohet kontrolli i biletave). Mbi këto dy variabla do të mbështeten edhe zgjedhjet e autoriteteve përgjegjës në luftën kundër kriminalitetit. Si rrjedhim nëse vlerat e Y dhe Z do të ishin të tilla që ti drejtonin njerëzit drejt respektimit të rregullave në shoqëri atëhere do të kishim më shumë aktivitete të ligjshme dhe fare pak apo aspak aktivitete të jashtëligjshme të cilat nuk do të merreshin më në konsideratë dhe do të konsideroheshin si aktivitete jo të rëndësishme nga ana sociale.

Një tjetër autor që mundohet të shpjegojë arsyet e kryerjes së veprave penale bazuar në teorinë ekonomike të sjelljes kriminale është edhe Isaac Ehrlich, sipas të cilit zgjedhja e një individi për t'iu përkushtuar kryerjes së veprimtarisë së ligjshme ose të paligjshme nuk është “e prerë me thikë”, në kuptimin që kushdo jo vetëm që mund ti dedikohet kryerjes së njerës apo tjetrës por edhe mund ti kombinojë duke përcaktuar kohën e nevojshme për ti dedikuar secilës prej tyre me objektivin e maksimizimit të dobishmërisë individuale[148]. Sipas këtij këndvështrimi, edhe krimi i vrasjes është sjellje “racionale”, në kuptimin që vrasësit e mundshëm reagojnë ndaj

[148] I. Ehrlich, *Crime, punishment, and the market for offenses*, në Revistën “Journal of Economic Perspectives”, Volume 10, N. 1, Published by American Economic Association, 1996, fq. 43-67.

fitimeve dhe humbjeve të mundshme që lidhen me kryerjen e veprimtarisë së tyre kriminale. Sjellja kriminale që shpie në kryerjen e vrasjes trajtohet si maksimizimi i dobisë personale nga individë që i nënshtrohen kufizimeve të caktuara. Ajo shpjegohet në të njëjtën mënyrë si sjelljet e tjera ekonomike, duke llogaritur, për shembull, orët e punës së ofruar dhe pagat e dëshiruara nga individët apo edhe çmimet e ofruara për mallrat në treg[149]. Bazuar në këtë teori, Ehrlich ishte por dënimit me vdekje duke argumentuar se çdo ekzekutim i vrasësve për krime të rënda mund të shpëtojë jetën e shtatë ose tetë viktimave të mundshme[150].

Në ndryshim nga Becker, rendimentet e të dyja tipeve të aktiviteteve nuk janë të fiksuara në mënyrë ekzogjene por janë të lidhura me kohën që subjekti u dedikon secilës prej tyre. Dobishmëria (D) varet nga Mirëqënia (M) (mirëqënia = pasuria që zotëron + fitimet nga aktivitete të ligjshme + fitimet nga aktivitete të paligjshme) dhe Koha e lirë: (K) D = D (M, K). Sipas këtij autori, subjekti duhet të bëjë zgjedhjen e duhur ndërmjet kohës që duhet ti dedikohet veprimtarisë së ligjshme, fitimi i së cilës është i sigurt dhe kohës që duhet ti dedikohet veprimtarisë së jashtëligjshme, fitimi i së cilës nuk është i sigurt. Për këtë arsye, me qëllim rritjen e dobishmërisë së tij, subjekti duhet të ndërtojë një portofol të përshtatshëm ndërmjet kohës në dispozicion për aktivitete të ligjshme dhe kohës në dispozicion për aktivitete të jashtëligjshme. Subjekti racional do të zgjedhë nivelin e kohës së lirë për t'iu dedikuar krimeve dhe pjesën e mbetur ti dedikohet veprimtarisë së ligjshme, që i jep mundësinë për të maksimizuar dobishmërinë[151].

---

149 R. M. McGahey, *Dr. Ehrlich's Magic Bullet: Economic Theory, Econometrics, and the Death Penalty*, në Revistën "Crime & Delinquency", Volume 26, Issue 4, 1980, fq. 485-502.

150 Studimet e Ehrlich u përmendën në vitin 1976 në diskutimet përpara Gjykatës së Lartë, ku u shpjegua se, gjatë disa dekadave të fundit, çdo ekzekutim i kryer në fakt pengoi një numër të konsiderueshëm vrasjesh. J. Fagan, *Death and Deterrence Redux: Science, Law and Causal Reasoning on Capital Punishment*, në Revistën "Ohio State Journal of Criminal Law", Vol. 4: 255, 2006.

151 I. Ehrlich, *Participation in illegitimate activities: A theoretical and empirical investigation*, në Revistën "Journal of Political Economy", Vol. 81, N. 3, fq. 521-565, May-June 1973.

## 2. Aktivitetet kriminale dhe ndikimi i tyre në ekonomi

Sipas Ehrlich, qasja ekonomike ndaj sjelljes kriminale mund të përmblidhet në pohimin e mëposhtëm: *Njerëzit u përgjigjen stimujve. Shkelësit, gjithashtu, janë njerëz dhe për këtë arsye edhe shkelësit i përgjigjen stimujve*. Në lidhje me krimin, Ehrlich është i mendimit se krimi shkakton dëme materiale dhe emocionale, si për viktimat e krimit ashtu edhe për shoqërinë në tërësi duke prishur, në këtë mënyrë, themelet mbi të cilat mbështetet shoqëria dhe shpërndarjen efikase të burimeve. Kjo është e vërtetë edhe në rastin e vjedhjeve "të vogla" që përfshijnë vetëm një rishpërndarje të vogël të pasurisë nga viktima te autori. Vjedhja përfshin një humbje neto sociale për shkak të faktit se hajdutët shpenzojnë kohën dhe energjinë e tyre për të realizuar një rishpërndarje të pasurisë në vend që të krijojnë pasuri të re. Për më tepër, individët dhe shoqëria shpenzojnë burime të konsiderueshme për mbrojtjen e pronës, shmangien e humbjeve emocionale, si dhe shmangien e dëmtimit të shëndetit apo humbjen e mundshme të jetës që përbëjnë një tjetër pengesë të rëndësishme për ekonominë dhe kërkimin e lumturisë[152]. Parë në këtë këndvështrim, vjedhja apo krimet e tjera më të rënda sjellin një kosto të konsiderueshme sociale dhe shoqëria ka një nxitje të fortë për t'i rezistuar kriminalitetit në forma nga më të ndryshmet. Kështu shpenzimet që do të bëjnë personat e dëmtuar mund të jenë: vendosja e hekurave në dritare; vendosja e sistemeve të alarmit; punësimi i rojave e kështu me radhë. Këto shpenzime kanë për qëllim të dekurajojnë kriminelët që të kryejnë aktivitete të jashtëligjshme në të ardhmen. Masat mbrojtëse mund të kenë disa efekte: Efekti i mbrojtjes private, kur masa e ndërmarrë ul probabilitetin e të qënit viktimë e një vepre penale (vendosja e hekurave në dritare); Efekti i mbrojtjes publike, kur masa e ndërmarrë ndikon jo vetëm në sigurinë e personit të dëmtuar nga

[152] Ekzistenca e aktiviteteve kriminale prodhon kosto jo vetëm përkundrejt viktimës që duhet të përballet me pasojat por edhe përkundrejt gjithë shoqërisë: ndikojnë në mënyrën e përdorimit të të ardhurave, dmth nëse këto aktivitete nuk do të ekzistonin të ardhura të caktuara të shtetasve do të investoheshin në sektorë më fitimprurës por për arsye të mbrojtjes nga këto aktivitete të jashtëligjshme këto të ardhura duhet të investohen për marrjen e masave të caktuara parandaluese. Nëse një hajdut thyen një xham me qëllim që të hyjë në një apartament për të vjedhur, një pjesë e të ardhurave të individit të dëmtuar por edhe të shtetasve të tjerë do të investohen në marrjen e masave të caktuara për të parandaluar kryerjen e këtij krimi në të ardhmen. Shih, I. Ehrlich, *New Directions in the Economic Analysis of Crime and Law Enforcement*, në "Conference of the Asian Law and Economics Society", Seoul, June 21, 2009.

vepra penale por edhe përkundrejt pjesës tjetër të popullsisë (ndriçimi i një rruge); Efekti i rishpërndarjes së aktivitetit kriminal, kur masa e ndërmarrë zhvendos zgjedhjet kriminale drejt objektivave të tjerë të jashtëligjshmë (vendosja e antifurtit në makinë në mënyrë që të shihet nga kushdo)[153].

Më shumë komplekse dhe më delikate është vlerësimi i efekteve ekonomike që sjell evazioni fiskal. Sipas vlerësimeve të specialistëve, në Shqipëri, pothuajse çdo vit, një pjesë e mirë e prodhimit të brendshëm bruto nuk deklarohet duke i'u shmangur detyrimit fiskal[154]. Sipas opinionit mbizotërues në shoqëri, ky lloj aksioni i jashtëligjshëm favorizon atë që e ka vepruar por nuk dëmton asnjë person tjetër. Për këtë arsye masat mbrojtëse të privatëve ndaj këtij fenomeni janë pothuajse zero. Gjithsesi, sjellja e jashtëligjshme e evazorit fiskal ndikon në rritjen e presionit fiskal mbi taksapaguesit e ndershëm. Parë nga ky këndvështrim edhe evazioni fiskal do të radhitet ndër ato vepra penale me efekt shpërndarës duke qënë se mund të dëmtojë sipas pjesës përkatëse të gjithë taksapaguesit. Si rrjedhim, lufta kundër kësaj sjellje të jashtëligjshme duhet të jetë detyrim i të gjithëve pavarësisht se i vetmi mjet parandalues është vetëm aksioni publik.

Pasojat kriminale të aktiviteteve kriminale që kanë të bëjnë me prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e të mirave dhe shërbimeve, me përjashtim të disa rasteve, nuk prekin interesat e privatëve dhe për këtë arsye nuk nuk mund të dallojmë, në përgjithësi, forma të mbrojtjes kundër këtyre aktiviteteve të organizuara nga ana e privatëve. Kështu për shembull, puna në të zezë është pjesë e ekonomisë së jashtëligjshme. Në vendin tonë një pjesë e mirë e bizneseve e favorizojnë këtë mënyrë të të vepruari e cila paraqet një formë të konkurrencës së pandershme

[153] Efektet e mësipërme vënë në pah zgjedhjet e bëra nga privatët për realizimin e objektivave të tyre, duke mos mbajtur parasysh efektet (pozitive apo negative) që mund të kenë aksionet e tyre mbi subjektet e tjerë. Në shumë raste interesat e privatëve bien në kontrast me interesin publik për këtë arsye është e domosdoshme që të ndërmerren politika të ndërhyrjes publike me qëllim luftimin e kriminalitetit duke ndikuar në mënyrë uniforme tek të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Shih, S. Kurti, *Ekonomia dhe kriminalitetit*, Botimet "Agimi", Tiranë, 2018, fq. 39.

[154] Shih, S. Kurti, *Pasojat ekonomike të veprave penale në shoqëritë tregtare*, në Konferencën Shkencore Kombëtare "Krimet finanziare, pastrimi i parave dhe siguria kombëtare", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Shkurt 2021, fq. 117.

përkundrejt bizneseve të ligjshme dhe të rregullta[155]. Megjithatë, format e mbrojtjes të privatëve kundër këtyre aktiviteteve janë të pakta dhe kryesisht janë në trajtën e presioneve që u bëhen autoriteteve publike me qëllim që të ndërhyjnë për të ndëshkuar bizneset e parregullta. Si rrjedhim, pakësimi i punës në të zezë është më tepër pasojë e kontrolleve të ushtruara nga organet shtetërore në bizneset e jashtëligjshme. Analizë e ngjashme mund të bëhet për aktivitete të tjera ekonomike të jashtëligjshme, siç mund të jetë ndërtimi i shtëpive publike për ushtrim prostitucioni apo shit-blerja e narkotikëve.

## 3. Efektet ekonomike të aktiviteteve të jashtëligjshme kriminale

Përllogaritja e xhiros së bizneseve me aktivitete të jashtëligjshme është e vështirë për mungesën e sinjalizuesve univokë mbi sasitë e prodhuara, çmimet, faktorët që ndërhyjnë në treg dhe rolin që luan dhuna si kriter rregullues i këtij tregu[156]. Informacionet që vihen në dispozicion nga burime zyrtare janë të kufizuara duke përfshirë vetëm disa krime të veçanta dhe disa aspekte të regjistruara nga këto veprimtari specifike të jashtëligjshme. Ka rrezik që të fryhet xhiroja e biznesit duke llogaritur dy ose më shumë herë fazat e proçesit prodhues deri në shkëmbimin përfundimtar. Tjetër problem lidhet me mos arritjen e identifikimit të të ardhurave të prodhuara nga biznese me aktivitete të ligjshme por që drejtohen nga persona me preçedentë penalë. Aspekt tjetër, i vështirë për t’u parashikuar lidhet me nivelin e korrupsionit i cili frenon marrjen e të dhënave të sakta përsa i përket të ardhurave të prodhuara nga aktiviteti kriminal. Për këtë arsye, sipas ekonomistëve[157], është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i efekteve ekonomike të aktiviteteve kriminale

[155] Shih, S. Kurti, E. Kaleshi, *E drejta e pagës së punëmarrësit dhe mbrojtja nga evazioni fiskal*, në Revistën “Reforma” – Revistë Rajonale e Shkencave Shoqërore, N. 4, Gjilan, 2016, fq. 61-67.
[156] Hapësira që zënë aktivitetet e jashtëligjshme në ekonominë e një vendi është e konsiderueshme. Përsa i përket Shqipërisë nuk kemi statistika zyrtare në lidhje me këtë aspekt por po të bëjmë një krahasim me Italinë shohim që pesha e ekonomisë kriminale llogaritet diku tek 2% e Prodhimit të Brendshëm Bruto por kësaj shume duhet ti shtohen të ardhurat e siguruara nga infiltrimi i ekonomisë së jashtëligjshme në ekonominë e ligjshme. Shih, S. Mocetti, L. Rizzica, *La criminalità organizzata in Italia: un’analisi economica*, në Revistën “Questioni di Economia e Finanza” (Occasional Papers), N. 661, Banca d’Italia, 2021.
[157] A. Bechi, G. M. Rey, *L’economia criminale*, Laterza, Roma, 1994, fq. 3-14.

duke u bazuar në dy drejtime kryesore: sipas drejtimit të parë kanë rëndësi niveli i aktiviteteve dhe kërkesa e përbashkët, ndërsa sipas drejtimit të dytë merr rëndësi koefiçienti i rritjes ekonomike dhe faktorët përcaktues të tij.

Sipas mendimit tonë, mënyra më e thjeshtë, për ta bërë problemin më të kuptueshëm është që të konsiderojmë aktivitetet ekonomike kriminale si një sistem i veçantë ekonomik që hyn në marrëdhënie me sistemin tjetër, atë të aktiviteteve ekonomike të ligjshme. E thënë ndryshe, sektori i ekonomisë së ligjshme është i barazvlefshëm me një sistem ekonomik që kryen marrëdhënie ekonomike me një tjetër sistem ekonomik jashtë kufijve shtetërorë dhe që në rastin konkret përfaqësohet nga sektori i ekonomisë kriminale. Parë në këtë këndvështrim mund të themi se blerja e mallrave dhe shërbimeve të ekonomisë kriminale nga ana e individëve me të ardhura të ligjshme mund të konsiderohet si shpenzim për "mallra importi"; nga ana tjetër, blerja e mallrave dhe shërbimeve të ekonomisë së ligjshme nga ana e individëve me të ardhura të jashtëligjshme mund të konsiderohet si shitje për arsye eksporti. Duke e studiuar problemin nga këto këndvështrime, mund të përdorim në rastin konkret rezultatet e teorisë makroekonomike të ekonomive të hapura ndaj shkëmbimeve me jashtë.

Efektet e ndryshimit të shpenzimeve të programuara për blerjen e disa produkteve të caktuara janë më pak të ndjeshme në tregjet e hapura sesa në tregjet e mbyllura. Në rastin tonë, një pjesë e kërkesës fillestare për të blerë mallra dhe produkte të caktuara humbet për t'u orientuar drejt kërkesës për produkte të jashtëligjshme. Nga ana tjetër, mund të themi se një rritje e të ardhurave dhe aktivitetit të ekonomisë së jashtëligjshme përkthehet në një rritje të shpenzimeve që personat e përfshirë në këtë aktivitet do të përballojnë për të blerë mallra dhe shërbime të ekonomisë së ligjshme. Në këtë mënyrë mund të arrijmë në konkluzionin, se në prani të disa kushteve, del në pah ekzistenca e një *feedback*-u të rëndësishëm midis ekonomisë së jashtëligjshme dhe ekonomisë së ligjshme; rritja ekonomike e një sektori ndikon përmes një mekanizmi të shumëfishtë në ekonominë e sektorit tjetër. Gjithsesi, ky lloj rezultati mund të ndryshojë në qoftë se do të mbahet parasysh fakti se të dy këta sektorë konkurrojnë për të njëjtën shumë të ardhurash, të pandryshueshme, që do të

shpenzohet për të përfituar mallra dhe shërbime të caktuara. Kjo ipotezë është më reale në rastin e shpenzimeve publike të cilat, më së shumti, mund të përfitohen nga sektori kriminal: për shembull, tenderat që mund të fitohen nga organizatat kriminale[158]. Ekzistenca e një lidhjeje të ngushtë mes aktiviteteve kriminale dhe kërkesës për mallra dhe shërbime të ekonomisë së ligjshme, dhe anasjelltas, mund të na ndihmojë që të shpjegojmë faktin se përse për disa aktivitete të caktuara ekonomike që administrohen nga organizatat kriminale nuk kërkohet ndërhyrja e shtetit dhe eliminimi i tyre: kjo për faktin se shkatërrimi i këtyre organizatave kriminale dhe për rrjedhojë e aktivitetit ekonomik që ato zhvillojnë do të sjellë si pasojë një dëmtim të ekonomisë së ligjshme dhe kërkesës për mallra dhe shërbime të kësaj ekonomie. Natyrisht që në këtë rast mos-ndërhyrja e shtetit lidhet edhe me ekzistencën e një niveli të caktuar të korrupsionit.

Sipas studiuesve, lidhja pozitive që mund të ekzistojë midis ekonomisë së ligjshme dhe ekonomisë së jashtëligjshme nuk është e qëndrueshme me kalimin e kohës për shkak se efektet ekonomike që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktiviteteve kriminale janë përgjithësisht negative: aktivitetet kriminale ndikojnë negativisht në rritjen e përgjithshme të ekonomisë[159].

Ekonomistët kanë zhvilluar disa mekanizma që provojnë këto rezultate. Këto mekanizma janë të lidhura me një karakteristikë të përbashkët të pothuajse të gjitha aktiviteteve të jashtëligjshme, pasi pothuajse të gjitha aktivitetet e jashtëligjshme janë aktivitete *rent seeking*[160]. Nocioni *rent seeking* përshkruan ato situata në të cilat

---

[158] Aktivitetet e jashtëligjshme të krimit të organizuar prodhojnë efektet e tyre edhe mbi konsumin e ligjshëm. Kështu për shembull, shitja e drogës do sjell që një pjesë e kërkesës për mallra të ligjshme të bjerë për shkak se ato para që më parë ishin përcaktuar për të blerë produkte konsumi do të ndjekin një rrugë tjetër. Për pasojë mund të themi se pakësimi i kërkesës për mallra konsumi tkurr të ardhurat e ligjshme që do të përfitohen nga shoqëritë tregtare që shesin pikërisht këto mallra. Kjo gjë do të vërehet sidomos në ato raste kur organizzata kriminale një pjesë të të ardhurave që do të përfitojë nga zhvillimi i aktiviteteve të jashtëligjshme do t'i përdorë për të rritur kërkesën për mallra të jashtëligjshëm, një pjesë tjetër e këtyre të ardhurave do të kursehen me qëllim që të përdoren në momente të vështira ose që do të përdoren në raste investimesh dhe një pjesë tjetër do të përdoren për të blerë mallra të huaj duke zvogëluar prodhimin e brendshëm. Shih, S. Kurti, *Pasojat ekonomike të veprave penale në shoqëritë tregtare*, në Konferencën Shkencore Kombëtare "Krimet financiare, pastrimi i parave dhe siguria kombëtare", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Shkurt 2021, fq. 121.

[159] G. Minutoli, *Crisi di impresa ed economia criminale: Misure di prevenzione patrimoniale e soluzioni concordate*, IPSOA – Wolters Kluwer Italia s.r.l., Milano, 2011, fq. 4.

[160] Nocioni i *rent seeking* u bë i njohur për shkencat ekonomike nga Gordon Tullock, i cili ka qenë gjithashtu një ndër studiuesit e parë që ka studiuar lidhjen që ekziston ndërmjet ekonomisë dhe kriminalitetit. Shih, G. Tullock,

një person, një organizatë ose një ndërmarrje kërkojnë të marrin një të ardhur jo nëpërmjet aktivitetit normal të prodhimit dhe shitjes por nëpërmjet manipulimit të sistemit ekonomik dhe atij ligjor. Ky nocion është përdorur fillimisht për të shpjeguar krijimin e monopoleve dhe aktivitetin ekonomik të tyre të dëmshëm por më vonë është përdorur për të shpjeguar një numër shumë të gjerë aktivitetesh të ndryshme njëra nga tjetra. Si përfundim mund të themi se, nocioni *rent seeking* përshkruan dhe shpjegon të gjitha sjelljet, veprime apo mos-veprime, që kanë si qëllim përvetësimin, me mënyra të ligjshme por edhe të paligjshme, të pjesëve të pasurisë të prodhuara nga të tjerët[161]. Për aktivitetet, të cilat i quajtëm "aktivitete me efekt shpërndarës" (vjedhja, shtrëngimi me anë të dhunës për dhënien e pasurisë, mashtrimi etj.) ky fakt është më se i natyrshëm por një gjë e tillë mund të thuhet edhe për "aktivitetet me efekt prodhues" (kontrabanda, trafiku i drogës etj.). Në fakt, tregjet në të cilat zhvillohen aktivitetet prodhuese kriminale janë padyshim shumë larg rregullave të konkurrencës. Gjithashtu, edhe organizimi i aktiviteteve prodhuese kriminale nuk është aspak i ngjashëm me organizimin e aktiviteteve nga ana e ndërmarrjeve të ligjshme që zbatojnë rregullat e konkurrencës. Kështu për shembull, për mënyrën e organizimit të aktiviteteve të jashtëligjshme është shumë e rëndësishme përdorimi i dhunës, qoftë si mjet për t'u futur në atë treg apo për të siguruar pjesën takuese në atë treg, qoftë si mjet për të vendosur rregull përbrenda organizatës kriminale[162].

Për të kompletuar arsyetimin tonë, është shumë e rëndësishme të shpjegojmë se si përvetësimi, i ligjshëm apo i paligjshëm, i pjesëve të pasurisë të prodhuara nga të tjerët (*rent seeking*) e kufizon së tepërmi nivelin e rritjes ekonomike. Për këtë qëllim mund të themi se niveli i rritjes ekonomike është i lidhur pozitivisht me zhvillimin

---

*Rent seeking*, in *The new Palgrave. A dictionary of economics*, 1987, 4° vol., fq. 147-149; G. Tullock, *The welfare costs of tariffs, monopolies, and theft*, Western economic journal, 1967, fq. 224-232.

[161] Në lidhje me këtë argument, një pjesë e doktrinës është e mendimit se aktiviteti kriminal i krimit të organizuar ka ndikim negativ në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë, qoftë në aspektin makro-ekonomik qoftë në aspektin mikro-ekonomik. Shih, M. Ferrara, R. Mavilia, *Tendenze evolutive della criminalità organizzata ed effetti distorsivi sull'economia legale di mercato*, në Librin "Vincere la ndrangheta. Metodologie di contrasto", Aracne Editrice, Ariccia-Roma, 2011, fq. 205-216.

[162] Në lidhje me karakteristikat e ndërmarrjeve të jashtëligjshme kriminale janë të vlefshme edhe sot punimet e Thomas C. Schelling që ka marrë çmimin Nobel për ekonominë. Shih, Th. C. Schelling, *Economics and the criminal enterprise*, The public interest, 1967, fq. 61-78; Th. C. Schelling, *What is the business of organized crime?* Journal of public law, 1971, fq. 71-84.

teknologjik (me fluksin dhe shpërndarjen e inovacionit), që nga ana tjetër është i lidhur ngushtësisht me numrin e ndërmarrjeve dhe me shkallën e konkurrencës nëpër tregje të ndryshme[163]. Duke qënë se, aktivitetet (*rent seeking*) që synojnë përvetësimin, e ligjshëm apo të paligjshëm, të pjesëve të pasurisë të prodhuara nga të tjerët, kërkojnë të zhdukin konkurrencën nga tregjet duke ulur mundësinë e zhvillimit teknologjik, mund të arrijmë në përfundimin se ekziston një lidhje negative ndërmjet aktiviteteve të jashtëligjshme kriminale dhe rritjes së përgjithshme ekonomike[164]. Nga studimet e ndryshme rezulton se fluksi i zhvillimeve inovative varet nga numri i subjekteve të pajisur me talent që zgjedhin të bëhen sipërmarrës. Në qoftë se këta sipërmarrës do ta vënë talentin e tyre në funksion të zhvillimit të aktiviteteve *rent seeking*, duke qënë të prirur drejt përfitimeve më të mëdha, atëhere shumë më të vogla do të jenë gjetjet inovative dhe për rrjedhojë shumë e vogël do të jetë rritja ekonomike.

Në përfundim të kësaj analize të efekteve ekonomike që vijnë si pasojë e aktiviteteve të jashtëligjshme kriminale mund të themi me plotë bindje se lufta kundër krimit ekonomik është e një rëndësie të veçantë pasi edhe përfitimet sociale apo edhe ekonomike që arrihen janë të mëdha: nga njëra anë synohet të parandalohen dëmet që mund t'u shkaktohen viktimave (edhe pse disa vepra penale janë pa viktima), dhe nga ana tjetër synohet të parandalohen dëmet që mund ti shkaktohen ekonomisë në përgjithësi.

## 4. Motivet që e vështirësojnë luftën kundër kriminalitetit

Teoria e mësipërme mund të ndihmojë së tepërmi në hartimin e politikave efikase për të luftuar sjelljet kriminale, megjithatë, kjo gjë nuk ka ndodhur dhe vetvetiu

[163] Ky fakt është pikasur si pasojë e zhvillimit të teorisë së rritjes endogjene të trajtuar nga Paul M. Romer. Shih, P. M. Romer, *Increasing returns and the long-run growth*, "Journal of political economy", 1986, fq. 1002-1037.
[164] Shih, Kevin M. Murphy, Andrei Shleifer e Robert W. Vishny, *The allocation of talent. Implications for growth*, Quarterly journal of economics, 1991, 106, 2, fq. 503-530; *Why is rent-seeking so costly to growth*? *American* economic review, 1993, 83,2, fq. 409-414.

shtrohet pyetja se cilat janë motivet që e vështirësojnë luftën kundër kriminalitetit. Sipas përkrahësve të kësaj teorie ekzistojnë disa motive dhe konkretisht[165]:

Aktivitetet që ndërmerren për të luftuar kriminalitetin janë të kushtueshme dhe burimet në posedim të autoriteteve kompetente janë të pakta. Kështu për tu kthyer edhe një herë tek shembulli i mësipërm mund të themi se për të kapur të gjithë ata persona që nuk paguajnë biletën duhet të shtojmë numrin e kontrollorëve, por ata kushtojnë. Teoria ekonomike na lejon ta sqarojmë këtë fakt duke përdorur teorinë e dobisë marginale sipas së cilës “çdo njësi shtesë e blerë do të risë dobinë marginale nëse përfitimet që do të ketë nga blerja e kësaj njësie shtesë do të jenë më të mëdha se kostot që duhet të përballohen; duke qenë se përfitimet priren gjithmonë drejt rënies dhe kostot gjithmonë drejt rritjes, ky veprim do të arrijë dimensionin e vet optimal kur përfitimet nga njësia shtesë do të jenë të barabarta me koston e asaj njësie shtesë”. Këto përfundime mund të përdoren edhe në rastin e luftës kundër kriminalitetit: kështu p.sh. çdo qindarkë e shpenzuar për të rritur luftën kundër kriminalitetit (të punësosh më shumë policë dhe magjistratë; të shpenzosh për t’u pajisur me mjete më tepër efikas për të zhvilluar hetimet paraprake; të ndërtosh më shumë burgje ose të risësh personelin e shërbimit të provës) do të prodhojë padyshim një përfitim shtesë më të madh; por nga ana tjetër duhet të mbajmë parasysh se me rritjen e shpenzimeve përfitimet shtesë priren të ulen derisa të vijë një moment kur nuk të leverdis më që të rriten shpenzimet.

Politikat që ndiqen për të luftuar kriminalitetin janë rezultat i vendimeve të një sërë autoritetesh publike dhe si rrjedhim pika e mbërritjes e një zinxhiri të gjatë të përbërë nga disa subjekte vendimarrëse që ndërveprojnë njëri me tjetrin: zgjedhësit; parlamenti; qeveria; zyrat kompetente; subjektet përgjegjës për realizimin në jetën e përditshme të aktiviteteve të parashikuara gjatë hartimit të këtyre politikave. Secili nga këto subjekte ndjek objekivat e veta që shpesh mund të jenë në kontrast me objektivat e subjekteve të tjerë. Një degë e ekonomisë e quajtur “teoria e lojrave” është në gjendje të analizojë të tilla situata ku zgjedhja është rezultat i një baskëveprimi si ai i përshkruar më sipër. Edhe nëse secili nga subjektet e përfshirë

[165] Shih, S. Kurti, *Ekonomia dhe kriminalitetit*, Botimet “Agimi”, Tiranë, 2018, fq. 23.

në lojë do të angazhohet në realizimin e zgjedhjeve racionale, kjo nuk do të thotë që vendimi përfundimtar (rezultati i lojës) të jetë gjithmonë efiçient. Në një rast të tillë përkrahësit e kësaj teorie e quajnë këtë përfundim “falimentim të kordinimit”. Kështu për shembull, të mendojmë që zgjedhësit duke u nisur nga informacionet që disponojnë kanë arritur në konkluzionin se gjendja e kriminalitetit në vend është në shifra alarmante. Nga ana tjetër ky perceptim i gabuar i situatës nga ana e zgjedhësve bie në kontrast me gjendjen reale të kriminalitetit të pasqyruar në statistikat zyrtare. Në këtë rast parlamenti dhe qeveria, në përputhje me objektivat e tyre, do të kërkojnë t’u përgjigjen shqetësimeve të zgjedhësve duke fryrë së tepërmi shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të luftës kundër kriminalitetit përtej atyre që do të ishin të nevojshme për një situatë të tillë. Një tjetër shembull lidhet me rolin që ka një subjekt i caktuar në ekzekutimin e politikave të hartuara për të luftuar kriminalitetin i cili do të kërkojë më së shumti rritjen dhe në disa raste fryrjen e buxhetit për realizimin e këtij qëllimi; të tilla janë agjencitë kundër trafikut të drogës, forcat e policisë apo organet e gjyqësorit dhe të prokurorisë. Hartimi i politikave efiçiente të luftës kundër kriminalitetit është i lidhur edhe me grupe të caktuara interesi siç janë ndërmarjet që duhet të prodhojnë pajisjet dhe shërbimet që do të përdoren për realizimin e këtyre politikave. Si përfundim mund të themi se bashkëveprimi i të gjitha këtyre mekanizmave përgjatë proçesit të vendimmarrjes publike ka si efekt kryesor mosruajtjen e ekuilibrit mes përfitimeve dhe shpenzimeve.

Ndonjëherë gjatë realizimit të politikave që ndiqen për të luftuar kriminalitetin autoritetet e ndryshme të ngarkuara për të çuar përpara këtë luftë mund të hasin në presionin e vazhdueshëm të subjekteve të interesuara që këto politika të mos realizohen. Presione të tilla nëse nga njëra anë shndërrohen në pengesë për luftimin e kriminalitetit nga ana tjetër përbëjnë në vetvete një aktivitet të jashtëligjshëm dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale të korrupsionit.

# KREU VII

## TEORITË NË LIDHJE ME DËNIMIN DHE NDIKIMI I TYRE NE NIVELIN E KRIMINALITETIT

**Përmbajtja:** 1. Domosdoshmëria e ekzistencës së dënimit penal. – 2. Teoria e "riparimit" të dëmit. – 3. Dënimi dhe teoria e parandalimit të përgjithshëm. – 4. Teoria e parandalimit të posaçëm. – 5. Riedukimi dhe recidivizmi.

### 1. Domosdoshmëria e ekzistencës së dënimit penal

Sipas Durkheim, dënimi nënkupton përfaqësimin e drejtpërdrejtë të rendit moral të shoqërisë dhe përbën një shembull se si përfaqësohet dhe mbahet ky rend. Nisur nga ky përkufizim, ai pohon se ndëshkimi përfaqëson reagimin e një shoqërie të nxitur nga ndjenja irracionale dhe emocionale për shkak të shkeljes së rendit moral dhe për këtë arsye kërkon që ta rivendosë atë rend[166].

Ashtu sikurse e kemi përmendur dhe analizuar më sipër, teoritë kriminologjike na ndihmojnë për të kuptuar shkaqet e përfshirjes në sjellje të jashtëligjshme apo antishoqërore. Duke njohur shkaqet e këtyre sjelljeve ne jemi në gjendje të ndërtojmë strategji të dobishme të parandalimit qoftë në aspektin e parandalimit të përgjithshëm qoftë në aspektin e parandalimit të posaçëm. Në kuadër të parandalimit të kriminalitetit një rol të rëndësishëm luajnë edhe normat penale, ekzistenca e të cilave influencon në një farë mase zgjedhjen e çdo individi për të kryer ose jo sjellje kriminale. Pjesa më e rëndësishme e normës penale që influencon sjelljen kriminale është dënimi[167]. Megjithatë, vendimi për të kryer ose jo një vepër penale influencohet më shumë nga siguria në zbatimin e dënimit dhe ashpërsia e tij. Që të

---

[166] Shih, C. A. Ávila Aparicio, *Teoría de la pena,* në Revistën "Revista Diversidad Científica", Vol. 1, N. 1, 2021.

[167] Për më shumë në lidhje me kuptimin e dënimit penal, shih, Y. Pjetërnikaj, *Arkitektura juridike e dënimit penal: Parimi i ligjshmërisë dhe drejtësia në individualizim si destinacion i reformës në drejtësi*, West Print, Tiranë, 2022, fq. 22-29.

dy këto variabla aktivizojnë një nivel të lartë të vetë-kontrollit tek individi duke nxitur tek ai frenimin për kryerjen e sjelljes kriminale.

Fjala dënim e ka prejardhjen nga latinishtja: *poena*, që i referohet ndëshkimit apo vuajtjes që do të pësojë një person për shkak të veprimit të tij të jashtëligjshëm[168]. Në funksion të shpjegimit të zhvillimit historik të dënimit penal, studiuesit kanë bërë edhe dallimin ndërmjet ndëshkimit penal dhe tipologjive të tjera të ndëshkimit (civil apo administrativ)[169]. Kështu në të drejtën civile, ndëshkimi i humbësit ka për qëllim ose që të rivendosë situatën e ligjshme mes palëve duke eliminuar veprimet e jashtëligjshme ose të rivendosë në masën e duhur pasurinë e personit të dëmtuar nga veprimet e jashtëligjshme të humbësit[170]. Në këtë pikë duhet të bëjmë edhe një dallim ndërmjet dënimit me gjobë dhe dëmshpërblimit në fushën civile: Në të drejtën penale, dënimi me gjobë ka për qëllim të ndëshkojë me "vuajtje dhe siklete" që vijnë si pasojë e pagimit të parave, ndërsa në të drejtën civile, pagimi i një shume parash ka për qëllim ri-integrimin e pasurisë së personit të dëmtuar nga veprimet e jashtëligjshme që vijnë si pasojë e mos-respektimit të kontratës apo edhe si pasojë e veprimeve extra-kontaktuale. Në rastin e dënimit penal mund të flitet për dënim heterogjen për shkak se bëhet fjalë për shuma parash të cilat nuk kanë lidhje me dëmshpërblimin që duhet të përfitojë një person që ka qënë viktimë e një vepre penale. Ndërsa në rastin tjetër, kemi të bëjmë me dënim homogjen pasi pagesa e shumave të parave është e lidhur me interesat që do të duheshin të mbroheshin nëpërmjet kryerjes së sjelljes së ligjshme. Pak më shumë e ndërlikuar është edhe bërja e një dallimi ndërmjet ndëshkimit penal dhe ndëshkimit administrativ. Ky i fundit jepet nga organi i administratës publike gjatë ushtrimit të një pushteti administrativ dhe ka për qëllim realizimin e interesit publik të mbrojtur nga normat

[168] Shih, Enciclopedia Treccani: https://www.treccani.it/vocabolario/pena/.
[169] Shih, S. Kurti, Kriminologji & Penologji: Cikël leksionesh, Wisdom, Tiranë, 2022, fq. 91.
[170] Në legjislcionin penal, interesi i ligjshëm mbrohet nëse parashikohet në mënyrë të shprehur nga një dispozitë konkrete e ligjit dhe ku personi i dëmtuar është vetë titullari i të drejtës së cënuar. Ndërsa, në përgjegjësine civile jashtëkontraktore, interesi i ligjshëm mbrohet në çdo rast, nëse cënohet si pasojë e çfarëdo lloj veprimi a mosveprimi që vërtetohet se është i paligjshëm dhe i kryer me faj nga autori i tyre, ku personi i dëmtuar nuk është, në kuptimin material, domosdoshmërisht dhe drejtëpërdrejt sibjekti pasiv i sjelljes së paligjshme të shkaktuesit të dëmit. Shih, F. Ballauri, J. Ballauri, *Shpërblimi i dëmit për viktimat e veprës penale në këndvështrimin e legjislacionit penal shqiptar*, në Konferencën Shkencore Kombëtare "Çështje të teorisë dhe praktikës mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2019, fq. 151.

ligjore të shkelura[171]. Ndëshkimet administrative, si rregull, jepen nëpërmjet masave administrative të ligjshme dhe të ekzekutueshme, të tilla që mbrojtja e subjektit mbi të cilin rëndojnë këto masa bëhet në një moment të dytë dhe vetëm pasi të jetë marrë një masë e tillë ndëshkimore[172]. Pavarësisht nga sa parashtruar më sipër, në ndryshim nga "të drejtat" e tjera, e drejta penale ka "qëllime unike" që nuk mund të ndahen me asnjë "të drejtë" tjetër të sistemit të drejtësisë dhe që na mundësojnë të flasim për "të mirën" e sistemit të drejtësisë penale që mbështetet mbi zbatimin e dënimit[173].

Në përgjithësi mund të themi se, ajo që e dallon ndëshkimin penal nga llojet e tjera të dënimit lidhet me vuajtjet më të mëdha që shkakton zbatimi i këtij lloji të dënimit në krahasim me llojet e tjera: mund të përmendim këtu dënimin me burgim i cili nënkupton privimin e lirisë personale të të dënuarit dhe vendosjen e tij në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Domosdoshmëria e ekzistencës së dënimit penal ka qënë prej kohësh çështje e debatit ndërmjet studiuesve të ndryshëm, ndër të cilët ka patur edhe mendime ekstreme në favor të mos-zbatimit të dënimeve penale duke u përqendruar më së shumti në gjetjen e masave efikase në parandalimin e kriminalitetit[174]. Pavarësisht ekzistencës së këtyre rrymave doktrinare, ne jemi të mendimit se dënimi penal është një domosdoshmëri në shoqëritë e sotme, të cilat do të ktheheshin në vende të mbizotërimit të rremujës dhe kaosit në qoftë se nuk do të ekzistonte frika ndaj ndëshkimit penal. Detyrë e juristëve penalistë të çdo shteti është të gjejnë llojet më të përshtatshme të dënimeve me qëllim frikësimin e individëve duke i orientuar ata drejt zbatimit të ligjshmërisë.

---

[171] Shih, D. Sorace, *Diritto delle amministrazioni pubbliche: Una introduzione,* Seconda edizione, Il Mulino Editore, Bologna, 2002, fq. 23-31.

[172] Shih, A. Travi, *Lezioni di giustizia amministrativa,* Sesta edizione, Giappichelli Editore, Torino, 2005, fq. 51-62.

[173] E. R. Belfiore, *Teleologismo sanzionatorio,* Contributo pubblicato nel volume *Studi in onore di Carlo Enrico Paliero,* a cura di C. Piergallini, G. Mannozzi, C. Sotis, C. Perini, M. Scoletta, F. Consulich, Milano, 2022.

[174] Shih, Y. Pjetërnikaj, *Diskrecioni legjislativ në zgjedhjen e mbështetjes në sanksion penal, ose në dekriminalizim, parimi i arsyeshmërisë si derivat i parimit të ligjshmërisë*, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Criminal law between tradition and challenges of actuality", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2017, fq. 519.

## 2. Teoria e "riparimit" të dëmit

Sipas kësaj teorie, e keqja e sjelljes kriminale duhet riparuar dhe "shpërblyer" me të keqen e dënimit. Dënimi në këtë rast ka një funksion shumë të rëndësishëm: shërben për të rivendosur moralisht situatën që ekzistonte përpara kryerjes së krimit. Origjina e kësaj teorie gjendet tek mekanizmi i hakmarrjes private që zbatohej në mesjetën e hershme (shek VI-X). Në këtë periudhë, për zgjidhjen e konflikteve zbatoheshin rregullat e procesit akuzator që njihej me emrin *Actus Trium Personarum* (veprim i njëkohshëm i tre subjekteve) dhe në gjykim merrnin pjesë tre persona: gjyqtari i cili më shumë ishte një arbitër mes palëve sesa një gjyqtar i mirëfilltë dhe palët, akuzuesi dhe i akuzuari[175]. Në të shumtën e rasteve, për përcaktimin e fajësisë apo të pafajësisë, arbitri thërriste në ndihmë "gjykimin e Zotit" duke përdorur ato prova që quheshin prova ordalike. Këto prova kishin të bënin me zhvillimin e një dueli apo të ndonjë gare të dhimbshme dhe të vështirë mes palëve në konflikt. Kush humbiste në duel apo në garë, humbiste edhe gjyqin dhe rezultonte humbës[176]. Dënimi në këtë periudhë paraqitet në formën e riparimit të dëmit, të pajtimit mes palëve, si rezultat i ndërmjetësimit të arbitrit. Palë në proçes nuk ishin i akuzuari dhe akuzuesi, por dy familje, dy klane, dy grupe sociale. Për këtë arsye, edhe në rastin e ordalive nuk ishte e domosdoshme që dueli apo gara të zhvilloheshin ndërmjet akuzuesit dhe të akuzuarit por mund të zhvilloheshin edhe ndërmjet personave që ata mund të zgjidhnin për t'i përfaqësuar. Në këtë moment historik, nuk ekzistonte parimi sipas të cilit dënimi është personal, pasi përgjegjësia

[175] Disa nga rregullat e këtij proçesi janë: proçesi fillon vetëm me inisiative të palëve; arbitri është tepër pasiv, janë palët ato që udhëheqin aktivitetin akuzues; proçesi zhvillohet në diskutim mes palëve; seancat gjyqësore janë publike; i akuzuari gëzon të drejtën për të patur një mbrojtës profesionist; i akuzuari gëzon të drejtën të njihet me akuzën që i bëhet nga akuzuesi qysh në fillim të proçesit; proçesi është transparent, d.m.th. palët duhet të informonin njëra tjetrën për provat që do të përdornin në proçes. Për më shumë rreth rregullave të proçesit akuzator shih, E. Dezza, *Lezioni di storia del processo penale*, Pavia University Press, Pavia, 2013, fq. 12-13.

[176] *Ordalia* ose *Iudicium Dei*, përfaqësonte një procedurë për zgjidhjen e konflikteve në rastet e eksperiencave juridike primitive, që karakterizoheshin nga mungesa e një pushteti të pavarur publik të aftë për të zhvilluar një proçes të drejtë me qëllim zbulimin e të vërtetës. Shembujt e *ordalive* janë të shumtë dhe këtu mund të përmendim: rasti kur akuzuesi dhe i akuzuari duhej të ecnin zbathur mbi prush të ndezur dhe ai që ecte më shumë do të shpallej fitues; rasti tjetër ka të bëjë me futjen e dorës në një tenxhere me ujë të valë për të nxjerrë një gur që është brenda saj dhe gurin ta mbash në dorë për një farë kohe. Fitues do të rezultonte personi që arrinte të përmbushte këtë provë dhe në rast se të dy e kryenin, fitues do të spalle personi dora e të cilit do të shërohej më parë. Për më shumë shih, M. Pifferi, *Ordalia*, në Dizionario Storico dell'Inquisizione, Volumi 2, drejtuar nga A. Prosperi në bashkëpunim me V. Lavenia, J. Tedeschi, Pisa, 2010, fq. 1142.

individuale nuk shihej e ndarë nga përgjegjësia kolektive. Bazë e modelit të përgjegjësisë kolektive ishte hakmarrja private ose e thënë ndryshe për ndëshkimin e humbësit zbatohej Ligji i Talionit[177]. Autori i veprës penale ishte përgjegjës jo kundrejt shoqërisë apo ligjit, por kundrejt familjes së viktimës. Si rrjedhim dënimi do të duhej të konsistonte në: një dënimi fizik, të njëjtë me pasojat e shkaktuara nga veprimi i tij i jashtëligjshëm (jeta për jetën; syri për syrin); pagimi i një shume të caktuar të hollash që përcaktohej mbi bazën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe të cilësive të autorit ose të viktimës. Provat ordalike, edhe pse të vështira dhe në shumicën e rasteve ç'njerëzore nuk mund të quhen torturë pasi nuk përdoreshin për të shtrënguar fizikisht apo psikologjikisht një individ me qëllim që të merrnin prej tij informacion apo për ta ndëshkuar, por qëllimi i tyre ishte të përcaktonte një fitues dhe një humbës duke u mbështetur tek "gjykimi i Zotit", pasi humbës në të gjitha rastet do të rezultonte ai që Perëndia do të linte në baltë dhe nuk do ta ndihmonte që të fitonte. Në mesjetën e afërt (shek XI-XV), kur pushteti për të ndëshkuar kaloi nga privati tek shteti, dënimi nuk përfaqësonte asgjë më shumë sesa përmbushje të nevojave individuale të hakmarrjes. Në këtë mënyrë mund të flasim për veshjen me ligjshmëri të normës zakonore të hakmarrjes.

Bazuar në teorinë e "riparimit" të dënimit, dënimi shërben për t'i dhënë shkelësit atë që meriton dhe nuk është e nevojshme të identifikohet një dobi e veçantë e dënimit për shoqërinë (dënim absolut). Kjo linjë mendimi shprehet në mënyrë elokuente me shprehjen "*punitur quia peccatum est*". Sipas Hegel, krimi është mohimi i ligjit ndërsa dënimi është mohimi i krimit dhe, për këtë arsye, duke qenë mohimi i një mohimi synimi i dënimit është rivendosja e ligjit[178].

Teoria e "riparimit" të dëmit vazhdon të ekzistojë edhe sot duke u mbështetur tek "fuqia" e opinionit publik që dominohet nga një ankth kolektiv i pakontrollueshëm dhe nga një ndjenjë e fortë pasigurie. Ndër llojet e ndryshme të kriminalitetit, krimi

---

[177] *Ius Talionis*: *talis* do të thotë e njëjtë. Për më shumë rreth Ligjit të Talionit shih, F. Botta, *La vendetta come officium pietatis,* në Rivista internazionale di scienze giuridiche e Tradizione Romana, Anno XIV – 2015 – Quaderno N.13, Università degli studi di Sassari. Punim i publikuar në kuadër të konferencës shkencore "*Conferenze Romanistiche Sassaresi, anno 2015 - MMDCCLXXVIII dalla fondazione di Roma*".

[178] M. L. Ferrante, *La pena: struttura ontologica e dimensione teleologica della pena tra ius ecclesiae e diritto penale italiano,* në Revistën "Rivista critica di diritto canonico molticonfessionale", N. 2, 2015, fq. 175-186.

ekonomik përfaqëson më së shumti nevojën për të rivendosur lidhjet e shkatërruara shoqërore dhe riparimin e dëmeve ndaj atyre që vuajnë pasojat e krimit. Sipas doktrinës, në lidhje me ndëshkimin e kriminalitetit ekonomik mbizotëron mendimi se përgjigjja ndaj sjelljeve të jashtëligjshme me natyrë ekonomike duhet të jetë më shumë se zbatimi i dënimit, pasi krimi është më shumë se shkelje e ligjit[179]. Sipas mendimit tonë, ekzistenca e një mendimi të tillë në lidhje me qëllimin e zbatimit të dënimeve nuk ndikon në nivelin e kriminalitetit, ose e thënë ndryshe, nuk bëhet shkak për të nxitur kryerjen e veprave penale por edhe nuk ndihmon në uljen e mundësive për t'u përfshirë në kriminalitet.

## 3. Dënimi dhe teoria e parandalimit të përgjithshëm

Sipas kësaj teorie, dënimi shërben si instrumenti më i përshtatshëm që nëpërmjet ndëshkimit të dobësojë dëshirën për të kryer krime[180]. Kjo teori mbështetet në dy opinione kryesore: Sipas mendimit të parë, ekzistenca e normës penale mjafton për të dekurajuar masat nga kryerja e veprave penale, ndërsa sipas një mendimi të dytë, kriminaliteti mund të frenohet vetëm nga konstatimi i zbatimi të dënimit. Pavarësisht opinioneve të ndryshme, kjo teori ka si objektiv parësor dhe është e lidhur ngushtë me frenimin e dëshirës për t'u përfshirë në kriminalitet.

Sipas një mendimi doktrinar, dënimi frikëson individët e një shoqërie të cilët, me kalimin e kohës i kthejnë në norma zakonore vlerat e shprehura në ligjin penal. Orientimi kulturor i një shoqërie zëvendësohet nga bindja e anëtarëve të asaj shoqërie për të kryer sjellje të caktuara të ndikuar nga frika e dënimit në rastin e kryerjes së sjelljeve të jashtëligjshme që përbëjnë vepra penale[181].

Teoria e parandalimit të përgjithshëm nuk është një teori absolute por është një teori relative dhe "dobiprurëse", e frymëzuar më shumë nga ekonomia sesa nga etika

[179] R. De Paolis, *Della funzione della pena, della giustizia riparativa, della criminalita economica: Una riflessione*, në revistën "dis Crimen", N. 2, 2021, fq. 21-48.
[180] Shih, P. Troncone, *Manuale di diritto penitenziario*, G. Giappichelli Editore, Torino, 2006, fq. 19.
[181] G. Marinucci, E. Dolcini, *Manuale di diritto penale: Parte generale*, Giuffrè Editore, Milano, 2004, fq. 4.

dhe morali[182]. Vuajtja që krimineli do të pësojë nga zbatimi i dënimit shndërrohet në një instrument të rëndësishëm social për arritjen e objektivave konkrete në mbrojtjen e shoqërisë nga kryerja e veprave penale. Frika e ndëshkimit tenton të ndikojë përgatitjet motivuese të një individi potencial për t'u përfshirë në kriminalitet. Qëllimi që ndiqet nëpërmjet kërcënimit, dhënies dhe ekzekutimit të dënimit është ai i parandalimit të kriminalitetit. Nevoja për të shmangur vuajtjet që shkaktohen nga zbatimi i dënimit përbën një arsye tepër të fortë për t'i detyruar individët të heqin dorë nga kryerja e veprave penale. Në prani të një rreziku të lartë për t'u dënuar dhe për të pësuar vuajtje të mëdha të cilat mund të kalojnë edhe avantazhet qe mund të përfitohen nga kryerja e veprës penale, krimineli potencial, si një subjekt që mund të bëjë zgjedhje racionale, do të zgjidhte të zbatojë rregullat dhe të mos përfshihet në kriminalitet. Megjithatë, ky lloj arsyetimi nuk vlen për rastet e veprave penale të kryera në gjaknxehtësi e sipër pasi në të tilla situata individi nuk është në gjendje të bëjë zgjedhje racionale dhe të frikësohet nga zbatimi i dënimit.

Përgjatë studimeve tw shumta janë analizuar efektet parandaluese të sistemit ndëshkues. Në mënyrë të veçantë, nëpërmjet analizave të statistikave zyrtare por edhe të hetimeve për nivelin e viktimizimit, studiuesit janë munduar të krijojnë një lidhje midis nivelit të kriminalitetit dhe rritjes së efektshmërisë së zbatimit të dënimit apo një rritjeje të ashpërsisë së tij: Përsa i përket ashpërsisë së dënimit janë marrë në konsideratë dy kritere: probabiliteti për t'u dënuar me burg; kohëzgjatja mesatare e dënimit dhe të ndëshkimit efektivisht të ekzekutuar. Studimet kriminologjike kanë evidentuar një lidhje më të ngushtë midis frikës për t'u arrestuar apo dënuar dhe efekteve parandaluese të kriminalitetit në krahasim me lidhjen ndërmjet ashpërsimit të dënimit dhe uljes së nivelit të kriminalitetit. Për pasojë me rritjen e rrezikut për t'u ndëshkuar ulet në mënyrë tepër të ndjeshme edhe niveli i kriminalitetit, gjë e cila nuk ndodhte në rastin e rritjes së ashpërsisë së dënimit. Këto studime tregojnë rëndësinë e madhe që ka mirëfunksionimi i sistemit të drejtësisë penale. Sa më efektiv të jetë ky sistem aq më shumë sjellje kriminale do të dënohen,

[182] Funksioni parandalues e konsideron të drejtën të pavarur nga morali dhe nuk përpiqet të huazojë nga ky i fundit një justifikim të pakushtëzuar për të parën. Shih, N. Amato, *Diritto Delitto Carcere*, Giuffrè Editore, Milano, 1987, fq. 56.

aq më shumë do të rritet siguria në dhënien e dënimit, aq më shumë do të frenohen psikologjikisht personat e prirur për t'u përfshirë në kriminalitet, aq më shumë do të ulet niveli i kriminalitetit[183]. Efekti frenues në kryerjen e veprave penale nëpërmjet frikësimit të ndëshkimit varet jo vetëm nga perceptimi individual i rrezikut për t'u dënuar por edhe nga paraqitja e këtij rreziku që zakonisht bëhet nëpërmjet informacionit që ofrojnë mjetet e komunikimit[184].

Sipas mendimit tonw, efektet e parandalimit të përgjithshëm vihen seriozisht në dyshim në rastin e shifrës së errët të krimit (krimet e padenoncuara). Fenomeni i krimeve të padenoncuara është një problem serioz për të gjitha shoqëritë. Arsyet e mosdenoncimit të krimeve lidhen me shumë faktor ku më i rëndësishmi dhe më shqetësuesi është mungesa e besimit tek organet e drejtësisë. Për pasojë, ky fakt shkakton një ulje të nivelit të frikësimit nga zbatimi i dënimit duke ndikuar edhe në rritjen e kriminalitetit.

Efekti frikësues i dënimit mund të bjerë në kontrast me ekzistencën dhe zbatimin e parimeve të drejtësisë restauruese[185]. Duke qenë se niveli i kriminaliteti varet ndjeshëm nga siguria në zbatimin e dënimit, mund të themi se drejtësia restauruese shërben si një pikë këputje për realizimin e efektit frikësues pasi konflikti do të zgjidhet me pajtim mes palëve. Subjekti që planifikon të kryejë një vepër penale, mund të mos frikësohet nga zbatimi i dënimit pasi llogarit që edhe në rast të zbulimit të veprës penale të kryer prej tij do të thërrasë në ndihmë parimet mbi të cilat mbështetet drejtësia restauruese duke i'u shmangur në këtë mënyrë sigurisë së zbatimit të dënimit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me individë kriminalë që vënë në peshore të gjitha mjetet që u lejon ligji, përfshirë këtu edhe rëndësinë e funksionit riedukues të dënimit, me qëllim që të shmangin frikën e dënimit të sigurtë që përbën një barrierë psikologjike të rëndësishme në kryerjen e veprave penale.

---

[183] R. Sette, *Controllo sociale e prevenzione: un approccio criminologico*, CLUEB – Cooperativa Libraria Universitaria Editrice Bologna, Bologna, 2008, fq. 9-15.

[184] C. E. Paliero, *La maschera e il volto: percezione sociale del crimine ed "effetti penali" dei media*, në Revistën "Rivista italiana di diritto e procedura penale", N. 2, 2006, fq. 467 e në vazhdim.

[185] Rreth nocionit të drejtësisë restauruese shih, G. Mannozzi, *Giustizia riparativa*, në Revistën "Enciclopedia del diritto", Annali X, 2017, fq. 465-486.

## 4. Teoria e parandalimit të posaçëm

Sipas kësaj teorie, dënimi transformohet në një trajtim të individualizuar të lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të të dënuarit. Kjo teori synon riedukimin dhe korrigjimin e sjelljeve të keqbërësve me qëllim që ata në të ardhmen të mos përfshihen në kriminalitet[186]. Në ditët e sotme teoria e parandalimit të posaçëm zë një vend kryesor midis të gjitha teorive të tjera që ekzistojnë mbi dënimin. Sipas disa autorëve, zbatimi i dënimit duhet ti kushtojë rëndësi riedukimit dhe rehabilitimit të autorit të veprës penale, dhe vetëm në rast se kjo gjë nuk arrihet atëhere do duhet të përqendrohemi më shumë tek frikësimi ose neutralizimi i këtyre personave me qëllim që ata ta kenë shumë të vështirë ose fare të pamundur kryerjen e veprave të tjera penale[187].

Sipas një mendimi tjetër doktrinal, dënimi duhet të ketë një karakter ndihmës (*ultima ratio*), d.m.th. duhet të përdoret vetëm nëse asnjë metodë tjetër, ndëshkuese ose jo, nuk është në gjendje të sigurojë një mbrojtje po aq efiçente.

Rëndësia e orientimeve të kësaj teorie vihet re edhe në mënyrën e krijimit të legjislacioneve të shumë shteteve, përfshirë edhe vendin tonë. Kështu, sipas nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr.79/2020 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*" thuhet se, *gjatë ekzekutimit të vendimit penal sigurohet: trajtimi human dhe respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të personit të dënuar; pjesëmarrja e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, përmes planifikimit të dënimit, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla*.

Mbi bazën e orientimeve të parandalimit të posaçëm, në legjislacionet e ndryshme janë futur shumë mekanizma të cilët bëjnë të mundur verifikimin e përmbajtjes së tyre. Kështu mund të themi se zgjidhja e konflikteve me marrëveshje

---

[186] M. R. Donnarumma, *La funzione rieducativa della pena e l'ergastolo "ostativo"*, në Revistën "Giurisprudenza Penale Trimestrale", N. 1, 2020, fq. 48 e në vazhdim.

[187] Kjo teori e konsideron dënimin si një mjet të rëndësishëm për të parandaluar autorin e veprës penale që të kryejë krime në të ardhmen. Ky qëllim realizohet nëpërmjet tre mënyrave kryesore: a) nëpërmjet risocializimit, duke ndihmuar të dënuarin që të rifutet përsëri në jetën shoqërore por pa kryer krime në të ardhmen; b) nëpërmjet frikësimit, për personat që nuk mund të risocializohen nëpërmjet ekzekutimit të dënimit; c) nëpërmjet neutralizimit kur i dënuari nuk është i ndjeshëm as nga risocializimi as nga frikësimi dhe për këtë arsye, i vetmi objektiv i dënimit mbetet që ta bëjë personin "të padëmshëm" ose të vështirësojë kryerjen e krimeve nga ana e tij. G. Marinucci, E. Dolcini, *Manuale di diritto penale: Parte generale*, Giuffrè Editore, Milano, 2004, fq. 4.

është shprehje e orientimeve të kësaj teorie[188]. Sipas mendimit tonë, nga këndvështrimi kriminologjik, pranimi i fajit dhe impenjimi i fajtorit për të marrë përsipër mbrojtjen e interesave të viktimës dhe për të ruajtur solidaritetin shoqëror që janë bazë e bashkëjetesës në komunitet, nënkupton ekzistencën e një parandalimi të posaçëm në momentin që qëllimi i tij është të rindërtoje vlerat e cenuara nga kryerja e sjelljes kriminale.

Përpjekja për të arritur riedukimin dhe risocializimin e të dënuarve ka shërbyer si forcë kritike ndaj sistemit ndëshkues duke kërkuar të ndërmjetësojnë midis efekteve negative të dënimit dhe realizimit të efekteve pozitive mbi të dënuarin. Riedukimi dhe risocializimi i të dënuarit përbën një instrument të rëndësishëm të politikës kriminale me qëllim përmirësimin e sistemit të dënimeve duke ndihmuar në këtë mënyrë edhe në parandalimin e kriminalitetit[189].

Pavarësisht se është objekt i kundërshtive të mëdha, riedukimi i të dënuarve ndikon nivelin e kriminalitetit duke ndihmuar në uljen e mundësive për t'u përfshirë në sjellje të jashtëligjshme. Në mesjetë, parandalimi i posaçëm i kriminalitetit synonte të realizonte eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit, ose nëpërmjet eliminimit nga shoqëria (dënimi me vdekje, me burgim të përjetshëm, me dëbim të përjetshëm) ose duke e turpëruar para gjithë shoqërisë. Në ditët e sotme, parandalimi i posaçëm i kriminalitetit është i lidhur ngushtësisht me funksionin riedukues të dënimit. Përmirësimi i trajtimit të të dënuarve duke e përshtatur me arritjen e qëllimit të zbutjes së rrezikshmërisë shoqërore të tyre ndikon pozitivisht në uljen e nivelit të kriminalitetit. Reforma e të ashtuquajturave "ligje të paketës penitenciare", të miratuara edhe nga Shqipëria në vitin 2020, që kanë të bëjnë me organizimin dhe mirë-funksionimin e sistemit penitenciar janë mbështetur pikërisht tek riedukimi dhe risocializimi i të dënuarve. Sipas një orientimi, reforma të këtij lloji kanë çuar në një përmbysje reale të marrëdhënieve tradicionale midis

---

[188] Gjykimi me marrëveshje: nenet 406/d deri 406/f të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

